


Nëntor 2018
Numri: 128
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

ETIKA



**Edhe pse ti
nuk e sheh **Atë**
Ai të sheh ty**



revistaetika



progresibotime

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ

Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shoqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Të gjithë pejgamberët kanë njoftuar për një udhëtim nga kjo botë për në botën e përtejme, këtë e dimë. Ka lindje, ka vdekje. Edhe këtë e dimë. As lindja, as vdekja nuk janë në dorën tonë, këtë e dimë. Fuqia që ka krijuar jetën dhe vdekjen ka njoftuar se kjo botë është një fushë për t'u sprovuar, edhe këtë e dimë. Gjithashtu e dimë se një kamera hyjnore është në xhirim në çdo moment, në formën më të përpiktë dhe me cilësinë më të lartë. Allahu i shikon ato që bëjmë dhe i dëgjon ato që themi, edhe këtë e dimë.

Ne e dimë se pranë nesh gjenden dy engjëj, që vazhdimisht mbajnë shënim dhe i regjistrojnë të mirat e të këqijat tona. Gjithashtu e dimë se i Dërguari i fundit i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, na ka këshilluar “të jetojmë sikur e shohim Allahun”, domethënë, të mos i bëjmë ato gjëra që Allahu Teala nuk dëshiron t'i bëjmë. Ne e dimë se Allahu (xh.sh.), në Librin e tij na ka paralajmëruar duke thënë: “Njeriu le të shohë se çfarë ka përgatitur për nesër!”, sepse na njofton se “nesër do t'i nxirret përpara çdo gjë që ka bërë dhe që nuk ka bërë”. Domethënë, ne e dimë se pas vdekjes do të ketë ringjallje, se do të ngrihet një gjykatë e madhe dhe se aty do të japim llogari për ato që kemi bërë në këtë botë.

Ne e dimë se ka një “kornizë Amentuje” që Kurani Fisnik ia paraqet njeriut herë pas here, në mënyrë që t'i besojë Allahut dhe botës tjetër. Fakti që kjo shprehet me insistim në Kuranin Fisnik tregon se aventura e njeriut mbi sipërfaqen e tokës ka kuptim të plotë vetëm me “ekzistencën e Allahut dhe planin e botës së përtejme”, edhe këtë e dimë. Po ashtu e dimë se kur ta nxjerrim jashtë funksioni besimin ndaj Allahut dhe botës tjetër, automatikisht bëhet i pamundur shpjegimi i ekzistencës së njeriut në sipërfaqen e kësaj toke. Gjithashtu e dimë se njeriu nuk mund të jetojë në këtë botë pa marrëdhënien me Allahun Teala dhe pa e marrë parasysh se me çfarë jete do të përballet në Ahiret. Përsëri e dimë se marrëdhënia jonë me pejgamberët që i ka dërguar Allahu Teala dhe dispozitat që kanë sjellë ata është e ndërthurur me të vërtetën e besimit ndaj Allahut dhe të llogarisë që do të jepet për jetën e kësaj bote.

Të dërguarit dhe i Dërguari i Fundit... Domethënë, Hazreti Muhamedi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të. Shpalljet hyjnore dhe Shpallja e fundit hyjnore. Domethënë, Kurani Fisnik. Le të supozojmë se e thamë shehadetin dhe hymë në rrethin e Islamit. Kjo do të thotë se njeriu e ka kuptuar urtësinë e ekzistencës së tij dhe se i ka dhënë fjalën Krijuesit për të ndërtuar në veten e tij një “pjekuri njerëzore” që Ai e do. Pra, është të shprehurit e vullnetit. Shehadeti është të shprehurit e vullnetit. Ndërsa Amentuja është një strukturë mendore dhe shpirtërore që do të formohet në gjergjefin e personalitetit të ri.

Do të vijë një ditë dhe secilit prej nesh do t'i thuhet: “Lexoje librin tënd!” Libri përbëhet nga dosja që kemi mbushur këtu në tokë. Pamjet, shkrimet dhe të gjitha llojet e xhirimeve. Çfarë thoni për këtë?..

Nëntor 2018

VITI: XII

NUMRI: 128

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

ËEBSITE

ëëë.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Aradian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja

Mos u shit lirë
Nuredin Nazarko

14



Besimtarët janë vëllezër
dhe një umet i vetëm
Dr. Adem Ergyl

8




Edukata e dhurimit
Osman Nuri Topbash

34



16

22



Ekstremizmi
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

- 5 Ndërkohë që kamera hyjnore është në xhirim...
Ahmet Tashgetiren
- 10 Tetë ajetet më të mira për umetin e Muhamedit (a.s.)
Doç. dr. Kerim Bulladë
- 16 Si nuk duhet parë një ekspozitë
Edison Çeraj
- 18 Arratisja e pamundur
Xhafer Durmush
- 20 Përse jemi në këtë gjendje?
Ali Riza Temel
- 25 Çfarë gjuhe të huaj kemi për të mësuar në shkollë?
- 30 Vrasësi e ka dhunën në gjene. Por...
Xhihan Tashtan
- 31 Shtëpia e vogël

56



Një Ajet-Një Hadith 32

Semi dhe Besir 40

Ilir Hoxha

Dashuria për fenë 42

Ferit Piku

Konservatorizmi II 47

Murat M. Aliu

Rëndësia e gjumit 53

Tuba Sokmen

Pas çdo burri të suksesshëm, 54

fshihet një grua e mirë

Kubra Çoban


Çfarë duhet të konsumojmë 58

për të ulur tensionin?

Shëndet

28

Sulejman ibn Surad (r.a.)
Mustafa Erish



Dieta më ideale, të hash pak
Dr. Betyl Nefise Inall

50





NDËRKOHË QË KAMERA HYJNORE ËSHTË NË XHIRIM...

— Ahmet Tashgetiren —

Të gjithë pejgamberët kanë njoftuar për një udhëtim nga kjo botë për në botën e përtejme, këtë e dimë. Ka lindje, ka vdekje. Edhe këtë e dimë. As lindja, as vdekja nuk janë në dorën tonë, këtë e dimë. Fuqia që ka krijuar jetën dhe vdekjen ka njoftuar se kjo botë është një fushë për t'u sprovuar, edhe këtë e dimë. Gjithashtu e dimë se një kamera hyjnore është në xhirim në çdo moment, në formën më të përpiktë dhe me cilësinë më të lartë. Allahu i shikon ato që bëjmë dhe i dëgjon ato që themi, edhe këtë e dimë.

Ne e dimë se pranë nesh gjenden dy engjëj, që vazhdimisht mbajnë shënim dhe i regjistrojnë të mirat e të këqijat tona. Gjithashtu e dimë se i Dërguari i fundit i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, na ka këshilluar “të jetojmë sikur e shohim Allahun”, domethënë, të mos i bëjmë ato gjëra që Allahu Teala nuk dëshiron t'i bëjmë. Ne e dimë se Allahu (xh.sh.), në Librin e tij na ka paralajmëruar duke thënë: “Njeriu le të shohë se çfarë ka përgatitur për nesër!”, sepse na njofton se “nesër do t'i nxirret përpara çdo gjë që ka bërë dhe që nuk ka bërë”. Domethënë, ne e dimë se pas vdekjes do të ketë ringjallje, se do të ngrihet një gjykatë e madhe dhe se aty do të japim llogari për ato që kemi bërë

në këtë botë.

Ne e dimë se ka një “kornizë Amentuje” që Kurani Fisnik ia paraqet njeriut herë pas here, në mënyrë që t'i besojë Allahut dhe botës tjetër. Fakti që kjo shprehet me insistim në Kuranin Fisnik tregon se aventura e njeriut mbi sipërfaqen e tokës ka kuptim të plotë vetëm me “ekzistencën e Allahut dhe planin e botës së përtejme”, edhe këtë e dimë. Po ashtu e dimë se kur ta nxjerrim jashtë funksioni besimin ndaj Allahut dhe botës tjetër, automatikisht bëhet i pamundur shpjegimi i ekzistencës së njeriut në sipërfaqen e kësaj toke. Gjithashtu e dimë se njeriu nuk mund të jetojë në këtë botë pa marrëdhënien me Allahun Teala dhe pa e marrë parasysh se me çfarë jete do të përballet në Ahiret. Përsëri e dimë se marrëdhënia jonë me pejgamberët që i ka dërguar Allahu Teala dhe dispozitat që kanë sjellë ata është e ndërthurur me të vërtetën e besimit ndaj Allahut dhe të llogarisë që do të jepet për jetën e kësaj bote.

Të dërguarit dhe i Dërguari i Fundit... Domethënë, Hazreti Muhamedi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të. Shpalljet hyjnore dhe Shpallja e fundit hyjnore. Domethënë, Kurani Fisnik. Le të supozojmë se e thamë shehadetin dhe hymë në rrethin e Islamit. Kjo do të thotë se njeriu e ka kuptuar urtësinë e ek-

zistencës së tij dhe se i ka dhënë fjalën Krijuesit për të ndërtuar në veten e tij një “pjekuri njerëzore” që Ai e do. Pra, është të shprehurit e vullnetit. Shehadeti është të shprehurit e vullnetit. Ndërsa Amentuja është një strukturë mendore dhe shpirtërore që do të formohet në gjergjefin e personalitetit të ri.

Do të vijë një ditë dhe secilit prej nesh do t’i thuhet: **“Lexoje librin tënd!”** Libri përbëhet nga dosja që kemi mbushur këtu në tokë. Pamjet, shkrimet dhe të gjitha llojet e xhirimeve. Çfarë thoni për këtë?..

Kur kalojmë në semafor me dritë të kuqe, shqetësohemi dhe e pyesim veten: Mos vallë na ka kapur kamera? A e mbartim të njëjtin shqetësim kur e nisim rrugën? A kemi ecur në korsënë e sigurisë në të cilin nuk mund të ecet? A kemi ndaluar në një vend ku nuk lejohet ndalimi? Ah këto xhirimet e kamerave!

Fytyrat do të dalin të bardha ose të nxira... Edhe kjo gjendet në dosjen e Ahiretit... Pastaj ka Xhenet apo zjarr flakëruës... Atje do të dalim në audiencën e Allahut Teala. Kështu që mund edhe të mbytemi në djersët e turpërimit. Nëse do të jemi në këtë gjendje, atje do të ikim nga nëna, babai, fëmijët, bashkëshortja, bashkëshorti, vëllezërit dhe motrat. Pastaj do të kërkojmë për ndonjë vrimë duke thënë: “A ka ndonjë vend ku mund të arratisemi?” Ndër të tjera është edhe dhimbja për të kaluar urën e Siratit. Gjithashtu do të jetë edhe shpresa me emocionin për të hyrë në Xhenet. Allahu na ruajt, nëse atje kapemi në një gjendje që nuk e kemi parë të vërtetën Dynja-Ahret, atëherë do të themi: “Ah sikur të isha dhe!”

Tani është koha që të ndalojmë dhe ta shikojmë edhe një herë veten tonë. Ta mendojmë edhe një herë çdo gjë që do të jetë brenda llogarisë në botën e përtejme. Tani është koha që ta marrim edhe një herë në llogari veten për çdo gjë që e dimë. Hasibu kable en tuhasibu / merreni veten në llogari para se të merreni në llogari nga Zoti (xh.sh.).

Vallë, a do të kemi mundësi t’i mbrojmë në audiencën e Allahut të Lartësuar ato që kemi bërë? Kjo është pyetja bazë. Çdo gjë e kemi bërë të lejuar, të lejuar, të lejuar. Çdo gjë e kemi bërë të lejuar si në planin individual, ashtu edhe në planin shoqëror. A thua do t’i mbrojmë dot këto në audiencën e Atij që i sundon zemrat?

Brenda vetes kemi nxjerrë me mijëra lloje pretekstesh. Po nëse Zoti (xh.sh.), i Cili i di zemrat, gjykon se të gjitha këto pretekste janë “të pabaza, të pakuptimta dhe janë mashtrime që ia kemi bërë vetë vetes sonë apo që na i ka bërë shejtani i mallkuar”?.. Po

nëse Allahu Teala na thotë: “Keni mashtruar veten tuaj. Mekanizmin e mendjes suaj e keni përdorur për interesat vetjake të grupit tuaj.”

Atje është bota e transparencës absolute. Ndërsa këtu po përjetojmë devijime si në jetën individuale, ashtu edhe në planin shoqëror. Rregullat i dimë, por ja që zvarritemi, përpëlitemi dhe përpiqemi shumë në emër të çështjeve vetjake dhe ia dalim mbanë ta shkruajmë në depon e fetarisë sonë “atë që është e përshtatshme për ne”. Mirë, por çfarë mund të themi për planin e botës së përtejme? Mirë, por kur do të veprojmë sipas kritereve hyjnore? Prandaj, asnjëherë nuk duhet ta harrojmë “likauull-llah / takimin me Allahun”! Një ditë do të dalim në audiencën e Allahut Teala. Por nëse sot jeton duke e ditur se në të vërtetë je në audiencën e Allahut (xh.sh.), nesër do ta kesh fytyrën e bardhë kur të dalësh para Zotit të Madhëruar. Ndërsa, nëse sot e harron takimin me Allahun e Lartësuar, domethënë, nëse jeton sikur nuk ke për të vdekur asnjëherë apo sikur asnjëherë nuk ke për të dhënë llogari, një ditë do të vijë koha e llogarisë dhe libri i veprave të tua do të jepet në dorë. Pastaj do të të thuhet: “Lexoje librin tënd!”

Allahu Teala shumë herë thotë në Kuranin Fisnik: “Ju kemi dërguar peygamberë dhe ju kemi paralajmëruar.” I lumtë atij që mund ta dëgjojë këtë paralajmërim! I lumtë atij që mund ta dëgjojë dhe ta organizojë jetën e tij sipas këtij paralajmërimi!

Muhammed Ikbali është një mendimtar mysliman si poeti ynë Mehmet Akif Ersoji. Ai thotë: “Ik nga këta myslimanë dhe strehohu te Islami!” Këtë e thotë sepse i digjet zemra. Edhe Mehmet Akif Ersoji thotë: “Të gjithë myslimanët e vërtetë që i kam parë janë në varre. Nuk e di, por mesa duket Islami i vërtetë është në qiej.” Zjarri që ndjente në zemër e detyronte ta thoshte këtë. Ndërsa ne themi: “Kjo botë ka nevojë për Islamin. Ndërsa Islami ka nevojë për myslimanët.” Elhamdulillah myslimanë ka sa të duash, por nga ana tjetër jemi të detyruar të pyesim se sa e nxjerrin në pah fytyrën e pastër të Islamit myslimanët e sotëm? Në rendin e botës gjendet një realitet i hidhur në të cilin “terrorizmi” përmendet bashkë me organizatat dhe institucionet islame.

Në çdo vend Islam, duke përfshirë këtu edhe vendin tonë, ka shumë njerëz që përpëliten në ato lloj punësh që dispozitat islame i përkufizojnë si mëkat. Ju pyesni: “Si mund t’i bëjnë këto punë këta njerëz që i besojnë Allahut dhe Ditës së Gjykimit?”

A mendojnë këta njerëz vallë se si mund të japin llogari nesër në audiencën e Allahut Teala ndërkohë që kanë bërë punë si “shfrytëzimi i Islamit” dhe



Një ditë do të dalim në audiencën e Allahut Teala. Por nëse sot jeton duke e ditur se në të vërtetë je në audiencën e Allahut (xh.sh.), nesër do ta kesh fytyrën e bardhë kur të dalësh para Zotit të Madhëruar. Ndërsa, nëse sot e harron takimin me Allahun e Lartësuar, domethënë, nëse jeton sikur nuk ke për të vdekur asnjëherë apo sikur asnjëherë nuk ke për të dhënë llogari, një ditë do të vijë koha e llogarisë dhe libri i veprave të tua do të të jepet në dorë. Pastaj do të të thuhet: “Lexoje librin tënd!”

“përfitim nga feja e Allahut”? Mos vallë mendojnë se ajo ditë nuk do të vijë asnjëherë? Ku gjendet besimi këtu? Mos vallë mendojnë se Allahu nuk i sheh? Prandaj, edhe një herë po pyesim: Ku është besimi këtu? Mos vallë mendojnë se do t’ia kalojnë paq për ato që kanë bërë? Mos vallë kanë harruar se atje do të merremi në pyetje edhe për shenjat që bëhen me sy apo vetulla?

Nëse janë të vërteta gjërat për të cilat thamë se “i dimë” në fillim të këtij shkrimi, atëherë, t’i përkasësh një feje a nuk do të thotë që ajo dije të shndërrohet në besim dhe ai besim të praktikohet në jetë? Në çfarë gjendjeje është marrëdhënia jonë me Allahun Teala? Në çfarë gjendjeje është besimi ynë ndaj botës së përtejme? Në çfarë gjendjeje është fetaria jonë?

Disa njerëz mund t’i pyesim: “Sa vend zë Islami në jetën tuaj?” Ata do të thonë se e kanë dijen të kufizuar, apo mund të nxjerrin justifikime të tjera... Edhe nëse nuk japin ndonjë pretekst, ata mund t’i kuptojmë. Këtë situatë duhet të shqyrtojmë nga aspekti i përgjegjësisë që kanë ata që dinë për t’i mësuar ata që nuk dinë.

Po nëse bëhet fjalë për shumë lloje neglizhence

në jetën e atyre që pandehim se dinë? Edhe sahabët, pra, njerëzit që janë rritur e edukuar pranë të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, shpesh herë i thoshin njëri-tjetrit: “Ejani të besojmë një orë! Domethënë, ejani të flasim edhe një herë për gjendjen tonë dhe ta shohim se sa veprojmë sipas besimit”. Ata shqetësoheshim pa masë për faktin nëse kishin apo jo ndonjë shenjë të hipokrizisë... Në të vërtetë, i gjithë shqetësimi i tyre ishte që të punonin sa më shumë për të dalë me fytyrë të bardhë para Allahut Teala.

Atje nuk ka kthim pas. Pra, nuk do të kemi mundësi për t’u kthyer dhe për t’u pastruar. Për këtë arsye, sahabët kanë qenë njerëz që e kanë jetuar Ahiretin që në këtë botë. Ata ishin shumë të kujdesshëm që të mos bënin qoftë edhe ndonjë gabim në jetën familjare sepse mendonin: “Nesër Allahu mund të më kritikojë.”, ngaqë shpallja hyjnore akoma vazhdon të zbriste. Shikimi dhe dëgjimi i Allahut Teala ishte shumë i rëndësishëm në jetën e atyre. Ata kanë jetuar deri në frymën e fundit ndërmjet Havfit / Frikës dhe Rexhasë / Shpresës.

Besimi se jeta e kësaj bote është një sprovë, çdo moment ia shton ndjeshmërinë zemrës. Predikimi i parë i Islamit është realizuar brenda kornizës “besim ndaj Allahut dhe Ahiretit”.

Krijuesi e fton njeriun që të mendojë përsëri rreth temës kryesore. Këtë e bën nëpërmjet të Dërguarit të fundit të Tij... “O njeri! Ti je krijuar nga asgjëja dhe nuk je i përhershëm. Çdo gjë përveç Atij është e përkohshme. Një ditë do të japësh llogari për ato që ke bërë. Do të japësh llogari për padrejtësinë që ke bërë. Do të japësh llogari për zullumin që ke bërë.”

Ky paralajmërim i ka ardhur kësaj bote në të cilën “njeriu ua ka kaluar hienave në agresivitet.” Nëse një njeri nuk ka dhëmbë, atëherë atë e hanë të afërmit e tij. Ky paralajmërim vazhdon të jetë i vlefshëm për të gjitha kohët.

Prej nesh si besimtar kërkohet që shpallja hyjnore të na lëkundë dhe të na e shkundë pluhurin ndërkohe që po e vrasim njëri-tjetrin fizikisht e shpirtërisht dhe po ia hamë mishin, madje këtë po e bëjmë pa ndërjerë aspak neveri. Çfarë të themi tjetër?!

Ejani dhe t’u hedhim një sy zemrave tona dhe të shohim nëse jetojmë apo jo sikur e shohim Allahun dhe nëse gjërat që i kemi dërguar për të nesërmen i kemi bërë apo jo me besimin se absolutisht do të japim llogari për to. Këtë le ta bëjmë para se të biem në ato gjendje kur nuk do të kemi mundësi as të pendo kemi!..



Besimtarët janë vëllezër dhe një umet i vetëm

— Dr. Adem Ergyl —

Emri i shoqërisë që formohet prej njerëzve që janë të kënaqur nga Allahu si Zot, nga Islami si fe, nga Muhamed Mustafai (a.s.), si pejgamber, nga Kurani Fisnik si libër i Allahut Teala dhe të cilët e shijojnë besimin e tyre në këtë mënyrë është Umeti i Muhamedit. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: **“Vërtet, ky umeti juaj (që formohet rreth Islamit, fesë së vërtetë) është një umet i vetëm. Ndërsa Unë jam Zoti juaj. Andaj më adhuroni vetëm Mua!”** (Enbija, 92)

Ky umet është umeti më i mirë i nxjerrë në pah nga Allahu Teala për të gjithë njerëzimin. Ky umet është i ngarkuar me detyrën e “Emri bi’l-ma’ruf ve nehji ani’l-munker-it”, domethënë, për të urdhëruar për gjërat që mendja e shëndoshë dhe sheriati i pranojnë si të mira e të bukura dhe për të ndaluar prej atyre që i pranojnë si të këqija e të shëmtuara derisa mbi tokë të mos mbetet përçarje dhe feja e sundimi të jenë për Allahun e Madhëruar.³

Ne si umeti i Muhamedit, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, jemi miqtë e njëri-tjetrit.

Nisur nga kjo, ne jemi miqtë dhe ndihmuesit e njëri-tjetrit. Ne jemi si organet e një trupi të vetëm. Ne kemi përgjegjësinë për të arritur të gjithë së bashku te më e mira duke u mbajtur për njëri-tjetrin. Simboli ynë është që të garojmë në mirësi e devotshmëri dhe ta ndalojmë njëri-tjetrin nga mëkati e armiqësia. Zemrat tona janë bashkuar dhe kanë formuar miqësi me njëra-tjetrën në sajë të mëshirës së Allahut Teala. Allahu i Lartësuar na ka shpallur vëllezër me njëri-tjetrin dhe na i ka bërë haram shumë vepra dhe sjellje si talljen, përçmimin, emërtimet me llagape të këqija, kërkimin e mangësive të tjerët, paragjykimin, përgojimin dhe thashethemet të cilat e prishin këtë vëllazëri. Epërsia te Allahu i madhëruar nuk është vendosur në prejardhje, faretis dhe racë, por vetëm në devotshmëri.

Çdo individ, xhemat dhe shtet ka shumë përgjegjësi për të marrë përsipër në emër të sigurimit të bashkimit dhe unitetit të umetit. Nëse ky umet i nderuar e vazhdon rrugën sipas udhëzimit që ka dhënë Allahu Teala duke e siguruar disiplinën brenda vetes, shumë njerëz të devijuar si qafirët,

zullumqarët dhe hipokritët asnjëherë nuk do të kenë mundësi t'i shkaktojnë ndonjë dëm. Rrezi-ku më i madh për umetin është kur grindja dhe fraksionet shfaqen ndërmjet pasuesve të besimit. Si rezultat, humbasim edhe fuqinë. Nisur nga këto, ndërkohë që pajtimi ndërmjet vëllezërve vjen në krye të veprave më të mira, edhe prishja e miqësisë, lidhjeve dhe bashkimit të tyre është prej mëkateve më të rënda.

Edhe nëse shejtanët prej njerëzve dhe prej xhindeve të dukshëm dhe të padukshëm i bëjnë ata të grinden me njëri tjetrin apo i lëshojnë deri në atë gjendje saqë të luftojnë me njëri-tjetrin për interesa vetjake e materiale, pjesës tjetër prej besimtarëve që nuk janë prekur nga kjo fatkeqësi i takon të qëndrojnë të bashkuar kundër atyre që i drejtohen padrejtësisë dhe t'i kthejnë ata nga rruga e gabuar në të cilën kanë hyrë. Domethënë, besimtarëve u bie për detyrë që t'i ndihmojnë vëllezërit e tjerë besimtarë edhe nëse janë prej atyre që bëjnë padrejtësi, edhe nëse janë prej atyre që u është bërë padrejtësi. Padyshim se ndihma më e rëndësishme që mund t'i bëhet të padrejtis është të ndaluarit e tij nga kjo padrejtësi.

Të gjithë ata që i drejtohen kibles, që nuk mohojnë haptazi dhe që i përshëndesin besimtarët e tjerë me përshëndetjen e Islamit janë elementë bazë të këtij umeti. Askush nuk mund ta nxjerrë nga umeti ndonjë tjetër me justifikimin se nuk i bindet mendimit të tij. Principi ynë themelor si umet është: "Të vepruarit me njerëzit sipas anës së dukshme të tyre, domethënë, sipas veprave dhe sjelljeve që ata reflektojnë në planin e jashtëm dhe t'ia lëmë Allahut Teala botën e brendshme të tyre." Për ta nxjerrë dikë jashtë rrethit të Islamit duhen argumente shumë të qarta e serioze dhe mohim në formë të hapur. Në të kundërt, ai që akuzon për mohim, domethënë, ai që e bën këtë veprimin për ta shpallur qafir dikë, do të thotë se e ka hedhur veten në një rrezik shumë të madh.

Mëkatet nuk e nxjerrin njeriun nga umeti përderisa të mos e pranojë hallallin si haram dhe haramin si hallall. Ne si besimtarë kemi përgjegjësinë që armiçësinë dhe urrejtjen që kemi ndaj mëkatit të mos e mbartim ndaj mëkatarit. Madje, ne e kemi për detyrë ta shpëtojmë këtë vëlla nga humnera e gjynahut në të cilën ka rënë.

Siç ka vend brenda kornizës së madhe të umetit për të devotshmit, të mirët, të sinqertët dhe besnikët, ka vend edhe për gabimtarët, mëkatarët dhe

gjynahqarët. Njëri prej mëkateve më të mëdha që nuk duhet të gjendet ndërmjet të gjitha këtyre grupeve është përçmimi i robërve të Allahut (xh. sh.). Njëra prej cilësive më të rëndësishme që Zoti i Gjithëmëshirshëm dhe Mëshirëplotë dëshiron ta shohë te robërit e Tij është që ndjenjat e mëshirës dhe të butësisë t'i mposhtin zemërimet e tyre. Nisur nga këto, njerëzit e pranuar te Zoti (xh.xh.), nuk janë ata që përpiqen t'i nxjerrin nga rrethi i umetit të gjithë të tjerët duke i shikuar me egoizëm, por janë ata që përpiqen për t'i parë brenda rrethit të umetit robërit e Allahut duke vlerësuar qoftë edhe shenjën më të vogël të tyre në lidhje me besimin dhe që i tërheqin ata drejt qendrës.

Brenda këtij umeti sigurisht që herë-herë kanë dalë individë apo grupe që kanë devijuar nga linja

Të gjithë ata që përpiqen për të formuar klasa brenda umetit, sido që t'i emërtojnë, në të vërtetë e shkatërrojnë umetin. Medhhebet dhe përkatësitë asnjëherë nuk duhet të shndërrohen në përplasje. Çdo lloj qëndrimi apo veprimi që ushqen egon e grupit, do të jetë shkak për të merituar jo kënaqësinë, por zemërimin e Allahut Teala.



qendrore. Këtu e rëndësishme është që besimtarët ta paralajmërojnë njëri-tjetrin dhe të përpiqen për ta afruar njëri-tjetrin sa më afër linjës kryesore.

Të gjithë ata që përpiqen për të formuar klasa brenda umetit, sido që t'i emërtojnë, në të vërtetë e shkatërrojnë umetin. Medhhebet dhe përkatësitë asnjëherë nuk duhet të shndërrohen në përplasje. Çdo lloj qëndrimi apo veprimi që ushqen egon e grupit, do të jetë shkak për të merituar jo kënaqësinë, por zemërimin e Allahut Teala.

Bashkimi i umetit mund të realizohet me udhëheqje të shëndoshë. Nisur nga ky aspekt, umeti duhet të edukojë njerëz që do të bëhen liderë dhe pastaj duhet të mbahen fort pas këtyre liderëve. Përderisa këta liderë të mos urdhërojnë për mosbindje ndaj Zotit, të gjithë besimtarët duhet ta pranojnë bindjen me sinqeritet ndaj tyre si urdhër të Allahut Teala. Individët apo grupet që nuk e formojnë dot një udhëheqje të tillë apo që e copë-

tojnë një udhëheqje të tillë e cila ekziston, duket qartazi se kanë marrë përsipër një përgjegjësi të rëndë dhe kanë rënë në një mëkat të madh.

XHEMATI ËSHTË MËSHIRË

Xhemati është një koncept bashkimi dhe shoqërimi. Feja islame nuk është një fe murgërie, por një fe sociale. Besimtarët e kësaj feje nuk janë njerëz që jetojnë të vetëm dhe të shkëputur nga njëri-tjetri, por janë njerëz që formojnë një bashkim si shembulli i tullave që janë të lidhura fuqishëm me njëra-tjetrën. I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë në lidhje me këtë çështje: “...*Ju këshilloj xhematin! Kini kujdes nga ndarja, sepse shejtani qëndron me atë që është vetëm. Ai qëndron larg dy vetave. Ai që dëshiron mesin e Xhenetit, të mos ndahet nga xhemati!..*” (Ibn Maxhe, Ahkam 27; Tirmidhi, Fiten 7.) “*Në xhemat ka mëshirë, ndërsa në ndarje ka ndëshkim.*” (Munavi, III, 470.)

Në të vërtetë, umeti islam në tërësi është një xhemat i madh. E fshehta që e mban të bashkuar është Islami, i cili është referenca e vetme e parimeve të besimit, adhurimit, veprave dhe moralit. Këtu duhet të shprehemi se edhe koncepti “ehli sunnet ve’l-xhemaat” është i rëndësishëm. Suneti është mënyra e adhurimit që është formësuar dhe simbolizuar në personalitetin e të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-selam. Ja pra, emri i përgjithshëm që i është vendosur një shoqërie që e merr për bazë këtë linjë me të gjitha aspektet e saj (të dukshme dhe shpirtërore), është “Ehli sunnet ve’l-xhemat”. Kjo shoqëri është quajtur edhe “sevadi a’zam”.

Myslimani asnjëherë nuk mund të jetë individualist dhe egoist. Shumë dispozita të Islamit janë për formimin e një xhemati të shëndosh. Në Islam është vënë në pah domosdoshmëria dhe mirësia e xhematit në dispozitat e adhurimeve më themelore si namazi, haxhi e zekati dhe është urdhëruar që myslimanët të veprojnë të bashkuar dhe me mirësi e devotshmëri.

Ndërmjet këtij xhemati të madh të umetit janë formuar edhe grupe të vogla që përsëri janë emërtuar me emrin xhemat. Në lindjen e këtyre strukturave nganjëherë ka qenë influencuese nevoja për dije, nganjëherë nevoja për ndërtimin e personalitetit dhe nganjëherë mendimi për t’u solidarizuar në mirësi dhe devotshmëri. Përderisa qëllimet të jenë të ligjshme e të pranuar, formimi i këtyre xhematëve është krejt i natyrshëm, madje nganjëherë mund të jetë edhe i domosdoshëm.

Këto struktura që janë formuar rreth një dije-tari, murshidi apo mirëbërësi, gjithmonë kanë ekzistuar në histori. Medresetë, teqetë, vakëfet dhe shoqatat në një farë mënyre janë format e institucionalizuara të strukturave të xhematëve. Nëse ata që gjenden në krye të këtyre strukturave janë njerëz të ditur, të urtë, largpamës dhe me vizion, përgjatë gjithë historisë kanë marrë përsipër role mjaft influencuese në shtimin e mirëqenies së umetit. Por për fat të keq ka edhe një të vërtetë të pamohueshme e cila është: Strukturat e këtyre xhematëve nganjëherë janë bërë vegla të abuzimeve të ndryshme. Për shkak të kësaj, detyra që u takon dijetarëve dhe udhëheqësve largpamës të umetit është që t’i parandalojnë këto lloj abuzimesh e shfrytëzimesh.

Këto lloje xhematesh të vogla është shumë e rëndësishme që të jenë të zgjuara kundrejt sëmundjes që mund ta quajmë egoja e xhematit, pëlqimit të vetes dhe përçmimit të të tjerëve, në mënyrë që të mos priset uniteti i umetit. Gjithashtu, nëse këto struktura e shenjtërojnë veten e tyre dhe e shohin të vërtetën e të drejtën sikur është vetëm në anën e tyre, atëherë edhe ky është një rrezik serioz për to. Përfundimisht, zhytja në mendimin e pagabueshmërisë për shkak të dehjes që jep lidhja dhe dashuria ekstreme, është një sëmundje shkatërruese.

Gjithashtu ekzistojnë edhe disa vatra ligësie që janë emërtuar si xhemat, por këto janë jashtë temës sonë. Ndoshta do të ishte më mirë që ky emër fisnik të mos përdorej për ata. Në lidhje me këto vatra sherri mund të përdoret fjala organizatë.

Përfundimisht mund të themi se formimi i xhematëve dhe bashkëpunimi ndërmjet tyre është një nevojë jetike dhe e domosdoshme, në mënyrë që feja të zbatohet, që personaliteti të ruhet, të zhvillohet e të përsoset dhe që mirësia të shtohet. Sikundër kësaj, ndarja në fraksione duke e copëtuar fenë, kapja e secilit grup pas një pjese të saj dhe formimi i grupeve të interesave dhe dëshirave vetjake shkaktojnë përçarje dhe shkatërrim të madh. Ky është devijimi i vërtetë. Allahu i Madhëruar në Kuranin Fisnik thotë: “(O ju që keni besuar!) ***Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Islamit) dhe mos u përçani!***” (Al Imran, 103) “***Me të vërtetë, ti s’ke të bësh fare me ata që e përçajnë fenë e tyre dhe shndërrohen në sekte. Të Allahu është puna e tyre e pastaj Ai do t’u tregojë çfarë patën punuar.***” (En’am, 159)

Tetë ajetet më të mira



PËR UMETIN E MUHAMEDIT (A.S.)

— Doç. dr. Kerim Bulladë —

Çdo ajet i Kuranit Fisnik është një burim drite, një burim nuri dhe një burim udhëzimi. Ndërkohë, gjenden disa ajete dhe disa sure që kanë bukuri, epërsi dhe mirësi të ndryshme. Pra, siç është surja Fatiha, surja Jasin, Ajetu'l-Kursij, Amenerrasulu, etj. Në këtë materialin tonë do të flasim për disa ajete fisnike që u japin shpresë dhe prehje zemrave tona.

Abdullah ibn Abbasi (r.a.), është bërë i famshëm si përkthyesi i Kuranit Fisnik dhe njihet si njeriu që e kuptoi Kuranin më mirë pas të Dërguarit të Allahut (a.s.). Më së shumti njihet si Ibn Abbasi (r.a.). Ai thotë se tetë ajete fisnike që gjenden në suren Nisa janë më të mira për këtë umet se çdo gjë tjetër mbi të cilën ka lindur dhe perënduar dielli.¹ Sipas radhës këto ajete janë:

“Allahu dëshiron që t’ju sqarojë, t’ju udhëzojë në rrugën e të dërguarve të mëparshëm dhe t’ju pranojë pendimet tuaja. Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.” (Nisa, 26) *“Allahu dëshiron që t’ju pranojë pendimet tuaja, por ata që jepen pas epsheve, dëshirojnë që të largoheni krejtësisht nga udha e drejtë.”* (Nisa, 27) *“Allahu dëshiron që t’ju lehtësojë (barrët), pasi njeriu është krijuar si një genie e pafuqishme.”* (Nisa, 28) *“Në qoftë se ju u shmangeni gjynaheve të mëdha, që ju janë ndaluar, Ne do t’ju falim gabimet tuaja të vogla dhe do t’ju shpiem në një vend të nderuar.”* (Nisa, 31) *“Vërtet, Allahu nuk dëmton askënd asnjë grimë, por, nëse (dikush) bën mirësi, Allahu ia shumëfishon atë dhe i jep shpërblim të madh.”* (Nisa, 40) *“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet*

NË ÇDO REKAT TË NAMAZEVE QË FALIM I PËRGJËROHEMI ALLAHUT TEALA: **“NA UDHËZO NË RRUGËN E DREJTË!”** KJO RRUGË ËSHTË RRUGA E PEJGAMBERËVE, E TË SINQERTËVE, E TË DEVOTSHMËVE DHE E DËSHMORËVE. KJO RRUGË ZGJATET DERI NË PËRHERSHMËRI. SHOKËT E KËSAJ RRUGE JANË PRIJËSIT NË UDHËZIM. KJO RRUGË ËSHTË RRUGA E DREJTË, QË ALLAHU TEALA E KA ÇAKTUAR PËR NJERËZIT.



dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ai me të vërtetë, ka humbur dhe është larguar shumë prej udhës së drejtë.” (Nisa, 116) Veçanërisht shik edhe ajetin e 49-të të kësaj sureje.) *“Kush punon vepër të keqe ose e ngarkon veten me gjynahe, pastaj kërkon falje prej Allahut, do të gjejë se Allahu është Falës e Mëshirëplotë.”* (Nisa, 110) *“Përse t’ju ndëshkojë Allahu, nëse ju e falënderoni dhe e besoni?! Allahu është Mirënjohës dhe i Gjithëdijshëm.”* (Nisa, 147)

Allahu Teala na i ka treguar hallallin dhe haramin, shumë punë të urta që nuk i dimë dhe veprat që janë të larta e të dobishme. Përveç të tjerash, na ka treguar edhe për rrugën e atyre që ka ecur me drejtësi prej umeteve të mëparshme dhe na ka ndriçuar në lidhje me këtë çështje. Ai na ka hapur derën e pendimit për të na i falë mëkatet dhe na ka udhëzuar duke na treguar parimet që do të na largojnë nga të këqijat.²

Në çdo rekat të namazeve që falim i përgjrohemi Allahut Teala: **“Na udhëzo në rrugën e drejtë!”**³ Kjo rrugë është rruga e pejgamberëve, e të sinqertëve, e të devotshmëve dhe e dëshmorëve. Kjo rrugë zgjatet deri në përhershmëri. Shokët e kësaj rruge janë prijësit në udhëzim.⁴ Kjo rrugë është rruga e drejtë, që Allahu Teala e ka caktuar për njerëzit. Të gjitha rrugët e tjera përveç kësaj janë rrugë që e shpien njerëzimin në humbje, në shkatërrim dhe në Xhehenem.⁵

Allahu Teala dëshiron që të pendohemi dhe t’i drejtohem atij duke i pohuar gabimet dhe gjynahet tona. Mbi të gjitha, na premtan se do ta pranohet një pendim të tillë. Gjithashtu shprehet se i do ata që pendohen. (Bakara, 222) Ndërkohë mëkatarrët dhe ata që shkojnë pas dëshirave vetjake të tyre dëshirojnë t’i devijojnë besimtarët nga rruga e rëndësishme e adhurimit dhe nënshtrimit ndaj Zotit (xh.sh.). Besimtarët e kanë detyrë të

rëndësishme që të luftojnë me armën e pendimit kundrejt këtyre që dëshirojnë t’i largojnë nga e vërteta. Allahu Teala na njofton se besimtarët pendohen menjëherë kur bëjnë ndonjë të keqe apo padrejtësi dhe i kërkojnë falje Allahut. Ndër të tjera na tregon se besimtarët nuk janë këmbëngulës në mëkate. (Al Imran, 135) Fakti që Allahu Teala e mban të hapur derën e pendimit është një mirësi e madhe për besimtarët.

Njeriu është krijuar i dobët. Ai është i parëzistueshëm nga aspekti fizik dhe shpirtëror. Padyshim se Allahu është Ai që e njeh më së miri njeriun nga aspekti fiziologjik dhe shpirtëror. Për këtë arsye, përsëri është Allahu

Ai që e di më së miri se për çfarë i mjafton fuqia njeriut. Allahu Teala gjithmonë dëshiron jo të vështirën, por të lehtë për robërit e tij. (Bakara, 85) Për sa i përket çështjes së fesë, Allahu Teala nuk i ka ngarkuar robërit e Tij me asnjë vështirësi. Edhe i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, thotë në lidhje me këtë çështje: *“Unë jam dërguar me fenë e pastër e cila bazohet në lehtësi dhe tolerancë.”*⁶

Përderisa besimtari të largohet nga mëkatet e mëdha që i ka ndaluar Allahu Teala dhe i Dërguari i Tij (a.s.), jemi njoftuar se do t’i falen mëkatet e vogla nga ana e Allahut dhe se do të hyjë në një vend të bukur e fisnik, domethënë, do të hyjë në Xhenet.⁷ Ky deklaram hyjnor është një sihariq për besimtarin. Deklarimi se do t’u falen mëkatet e vogla atyre që largohen nga mëkatet si shoqërim i ndonjë ortaku në adhurim ndaj Allahut Teala, i cili konsiderohet si mëkati më i madh, vrasja e një njeriu me pa të drejtë për të cilën është folur në ajete dhe hadithe të ndryshme, kundërshtimi i prindërve, mashtrimi, dëshmimi i rremë, vjedhja, ngrënia e pasurisë së jetimit, shpifja ndaj grave të ndershme, imoraliteti, dezertimi nga fusha e luftës, magjia, përgojimi, shkëputja e shpresës nga mëshira e Allahut, ngrë-



Allahu Teala nuk i bën padrejtësi askujt qoftë edhe sa grimca. Ai është i drejtë. Ai është mëshiruesi më i madh. Ajetet fisnike si: **“Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish. Kush bën një vepër të keqe, do të dënohet vetëm sipas gjynahut që ka bërë dhe nuk do t’i bëhet kurrfarë padrejtësie.”** (En’am, 160), janë burim shprese dhe mbështetje themelore për besimtarët për garën në mirësi.



nia e kamatës, etj. është një siguri dhe garanci për njerëzit që besojnë. Në të vërtetë, besimtari nuk mund të ndjehet i qetë dhe i sigurt me mëkatet të mëdha. Nëse bën ndonjë mëkat të vogël duke mos e pasur në dorë, menjëherë pendohet dhe kërkon mundësitë e pastrimit nga ky mëkat.

Allahu Teala ka deklaruar se nuk do ta çojë dëm asnjë vepër që bëhet për kënaqësi të Tij sado e vogël që të jetë. Për sa i përket madhësisë së fjalës “zerre/grimë” që përmendet në ajetin e 40-të të sures Nisa, që e kemi dhënë të përkthyer më sipër, Ibn Abbasi (r.a.), e komenton në formën: “Koka e milingonës së kuqe.” Edhe grimcave të pluhurit që shfaqen në ajër kur rrezja e diellit bie nga një vrimë quhen “zerre”. Kjo nuk ka ndonjë peshë apo masë.⁸

Allahu Teala nuk i bën padrejtësi askujt qoftë edhe sa grimca. Ai është i drejtë. Ai është mëshiruesi më i madh. Ajetet fisnike si: **“Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish. Kush bën një vepër të keqe, do të dënohet vetëm sipas gjynahut që ka bërë dhe nuk do t’i bëhet kurrfarë padrejtësie.”** (En’am, 160), janë burim shprese dhe mbështetje themelore për besimtarët për garën në mirësi.

Në Ditën e Gjykimit do të peshohen veprat e rob-it. Kur t’i peshohen veprat, do të urdhërohet që ai të gjendet pranë peshores. Ndërmjet tyre (veprave) do të nxirret një letër në të cilën gjendet shehadeti. Në njëërën anë të peshores do të vendosen të gjitha veprat e shkruara në librin e veprave dhe në anën tjetër do të vendoset shehadeti. Ana në të cilën do të vendoset shehadeti do të peshojë më rëndë. Ndërsa ana tjetër në të cilën do të gjenden të vendosura veprat, do të vijë më lehtë.⁹ Në këtë mënyrë do të dalë në pah epërsia dhe vlera e besimit. Shehadeti që besimtari e ka thënë me plot bindje në këtë botë, do të jetë shkak për shpëtimin e tij. Nisur nga ky këndvështrim, besimi është parimi më kryesor i jetës së adhurimit. Nëse nuk ka besim, veprat e tjera nuk kanë asnjë vlerë.

Allahu Teala na ka dhënë sihariqin se do t’ia falë mëkatet përveç shirkut kujt të dojë. Ali ibn Ebi Talibi (r.a.), thotë në lidhje me ajetin e 49-të të sures Nisa që e kemi dhënë të përkthyer më sipër: “Nuk ka ajet më të dashur se ky për mua në Kuranin Fisnik.”¹⁰ Për këtë arsye, besimtari

që dëshiron lumturinë e kësaj bote dhe të botës tjetër duhet të ketë një besim me bindje të plotë dhe larg shirkut, dyshimit e hezitimit. Shpëtimi në botën tjetër do të arrihet vetëm me një besim të tillë.

Allahu i Madhëruar ka premtuar se nuk do ta kthejë duarbosh nga audienca e Tij atë që i kërkon falje ngaqë ka bërë ndonjë të keqe apo i ka bërë padrejtësi vetes. Një shpërblim i tillë mund të arrihet vetëm me pendim duke hequr dorë nga mëkatet dhe me pishmanllëk ndaj Allahut Teala.

Falënderimi është mirënjohje ndaj Allahut (xh. sh.). Ne jemi vepër e Tij me çdo gjë që posedojmë. E gjithë ekzistenca jonë fizike dhe shpirtërore është e Atij. Ai na ka dhënë jetën dhe na ka krijuar si njerëz. Ai na furnizon, na jep për të ngrënë, na jep për të pirë dhe na ngop. Mosmirënjohja është e kundërta e falënderimit. Edhe një kuptim tjetër i fjalës kufër/mohim që është e kundërta e besimit është mosmirënjohje. Besimtari nuk duhet të jetë mosmirënjohës. Allahu (xh. sh.), nuk i do mosmirënjohësit dhe i ndëshkon ata. Në këtë kontekst, Kurani Fisnik na njofton se shumë popuj janë shkatërruar për shkak të mosmirënjohjes së tyre. Allahu na ka njoftuar se nuk do ta ndëshkojë një popull që e di vlerën e mirësive dhe që falënderon. Ai na ka dhënë garanci në lidhje me këtë çështje. Kjo e vërtetë është theksuar qartazi në ajetin e 147-të të sures Nisa.

Në këtë shkrim bëmë disa shpjegime të shkurtra rreth ajeteve që ua dhamë kuptimin në fillim. Siç ka thënë edhe Ibn Abbasi (r.a.), këto ajete fisnike janë mirësi që i janë dhënë umetit të Muhamedit (a.s.).

REFERENCAT

1. Bejdavi, Envaru’t-Tenzil, Bejrut, II, 57; Nesefi, Medadriku’t-Tenzil, Bejrut, II, 61. (Mexhmuatun mine’t-Tefasir.)
2. Shik. Bejdavi, vepra e lartpërmendur, II, 56; Hazin, Libabu’t-Tevil, Bejrut, II, 56. (Mexhmuatun mine’t-Tefasir.)
3. Fatiha, 6.
4. Nisa, 69.
5. En’am, 153.
6. Buhari, Iman, 29; Ahmed ibn Hanbel, VI, 116.
7. Bejdavi, vepra e lartpërmendur, II, 61; Hazin, vepra e lartpërmendur, II, 61.
8. Hazin, vepra e lartpërmendur, II, 75.
9. Shik. Tirmidhi, Iman, 17; Ibn Maxhe, Zuhd, 35.
10. Tirmidhi, Sure, 5, 3037 (Tefsiru Nisa).

MOS U SHIT LIRË

— Nuredin Nazarko —

Qysh nga hershmëria njeriu ka jetuar si i tillë. Thelbi ka mbetur i pandryshueshëm. Nuk është lakuar e as ka humbur duke kaluar në qafat dhe shtigjet e kohës. Njëtrajtshmëria ka qenë dhe mbetet tipari shques. Kanë ndryshuar kushtet materiale në të cilat jeton, por nuk kanë ndryshuar llojet e përpjekjeve. Qysh nga hershmëria është përpjekur të sigurojë ushqim për përmasën fizike. Po kështu është shqetësuar edhe për dilemat ekzistenciale. Të njëjtat vazhdon të bëjë edhe sot.

Jemi duke kaluar një nga periudhat ku dashuria ndaj monedhës është rrënjëzuar thellë. Rrënjët e harlisura në tokën pjellore të shpirtit njerëzor po thithin çdo sekondë lëndët ushqyese. Ikja e këtyre të fundit nga shpirti drejt trupit po jep pasoja të drejtpërdrejta në fizionominë e atyre syresh që kanë zgjedhur t'i nënshtrohen këtij operacioni të vështirë. Ç'është e vërteta këta syresh kanë firmosur kartën e sigurisë para operacionit, duke marrë tërësisht përgjegjësinë për gjithësa ndodh. Firmë e hedhur krejt pavetëdijshtë.

Si pasojë e operacionit po shohim trupa që duan t'u shkëlqejë lëkura, floku. Ndërkohë shpirti po u kthehet në eshkë. Po humb palcën jetësore. Të çara të thella janë krijuar në shpirtin eshkë, nga mungesa e reshjeve mbushur me bulëza virtytesh.

Lëkura ndriçon, shpirti eshkëzohet. Ngjarje dramatike. Fundi për hajër, por në të tilla ngjarje fundi nuk duket të jetë aspak hajër. Si mundet me qënë kur edhe shkëlqimi i lëkurës është kaq i brishtë. Do të mjaftonte një shkëndijë urori dhe lëkura e këtyre syresh do të kallej në zymtësinë e eshkës që digjet.

Paskëndaj, a mund të pretendojnë për suksese në ndërtimin e së bukurës, estetikes?

Për hir të kryelartësisë që buron nga mosdurimi i dështimit edhe mund ta thellojnë më tej qëndrimin e tyre mohues ndaj asaj çfarë ndodh realisht me brendinë e tyre. Po a mundet mohimi t'i shpëtojë nga realiteti? Anashkalimi i problemeve nuk i zgjidh problemet. Thjesht i tulat një kohë. Por kur rizgohen, problemet mund të jenë edhe më agresivë, edhe më shkatërrues se më parë. Atëherë është e vështirë ta ndalësh ortekun e përmbysejeve të mëdha. Në gjendjen e eshkëzimit të shpirtit jemi në kufijtë e së pamundurës për të ndalur goditjen çengel të ortekut të anashkalimit të problemeve.

Ka goditje e goditje. Mund edhe të jenë fatale. Por kur rendja pa fre drejt shkëlqimit të lëkurës të err sytë nuk sheh më se nga cila derë hyn e nga cila derë del. A janë këto dyer me kanate tradicionale apo janë dyer moderne? Me siguri që tradicionalja të duket demode. Modernia bie në sy. "Finesa" industriale "mposht" artin e dorës së artizanit. Dhe ti i gëzohesh kësaj fitore. Ushtima e saj bubullon në veshët e tu që ziejnë nga recetat për shkëlqimin e lëkurës. Dhe kur aty mbërrin ndonjë zë që flet për shpirtin, jetën, virtytet, ngrihesh rrëmbimthi dhe me kamxhikun e egërsisë e dëbon si ndonjë demon që të prish rehatinë dhe ëndrrat për jetë me salltanete.

Dhe kryen gjithë këtë luftë, përse? A nuk ke kohë të ulesh këmbëkryq si burrat e motshëm dikur? Të kuvendosh me qenien tënde në heshtje dhe vetmi, larg zhuzhurimës së murrjelave. Bëje këtë për qe-



nien tënde. Nëse veten e fut në kasafortën e harresës si mund të mendosh se tjetri që të percepton si konsumator, do të vijë e do të të çlirojë nga pesha e lëkurës që shkëlqen duke shkrumbuar shpirtin?

Nëse ke vendosur ta udhëheqësh veten drejt vuajtjeve për rini tokësore, nuk duhet të presësh sa të rreshkesh nga vitet, e të kërrusesh nga pesha e kohës. Ka ende shembuj prej të cilëve mund të nxirret mësim për të shpëtuar nga shakaja pa kripë, “koha ka ndalur për këtë njeri që nuk njih plakje”. Mund edhe të miklohesh e të të pëlqejë vetja, kur dëgjon se koha ka ndalur për ty. Mos u vetëgënje me arsye. Thellë në shpirt ti e ndjen që po shkrumbohesh ngadalë dhe nga kthimi në hi nuk mundesh të shpëtosh kurrsesi. Nëse e ndjen në përbrendësi këtë siguri, çfarë të shtyn të besosh verbërisht se rinia jote nuk merr fund këtu dhe tani?

Ti e kupton shumë mirë se që në momentin që kërkon ta bindësh veten me zor për jetë të rehat-

shme në sajë të monedhave që posedon, ke humbur betejën për jetën e vërtetë. Mund edhe të pyesësh veten, pse mos ka dy jetë njeriu mbi këtë tokë? Po, njeriu ka dy jetë! Jetën që ka jetuar dhe jetën që mund të jetojë tash e tutje.

Nëse deri tash ke shitur shpirtin për pak shkëlqim lëkure që të ndjesh lakminë e të tjerëve karshi teje, përse të mos e braktisësh këtë marrëveshje të heshtur tregtie në dëm të qenies tënde? Tash e tutje ke në dorë ta shfuqizosh shitjen e shpirtit tënd, shitjen e jetës që mund të kesh nën hijen e bulëzave të virtyteve.

Të shesësh shpirtin, jetën që mund të kesh në kopshtin e virtyteve për monedhat që i përdor në shkëlqime të rreme, është shitja më pavlerë që ke bërë. Gëzohu për pak, se shumë nuk të ka mbetur. Në fund vlen rezultati dhe mos harro një mësim thelbësor: -Punët janë sipas përfundimit.



Si **NUK** duhet parë një **EKSPozITË**

— Edison Çeraj —

Një ekspozitë për së mbari na mëson shumë gjëra mbi një epokë, mbi një piktor apo mbi një temë të caktuar; na pasuron vizionin e një vepre dhe, për një apo dy orë, na rrëmben nga jeta e përditshme dhe na kredh në një botë tjetër, një botë bukurie apo shpikjeje. Porse në disa të rralla përjashtime [...], na rrëfen me anë të pikturave – në vend të fjalëve – një histori të mrekullueshme.

(Mario Vargas Llosa)

Në përsiatjen e mësipërme mbi atë se çfarë mund të shenjojë një ekspozitë e artit pamor, gjëja e parë që vëmë re është konstatimi: “një ekspozitë për së mbari”, që do të thotë se ka edhe ekspozita *për së prapthi*.

Në fakt, natyrisht që nuk ka një recetë apo një përkufizim se si duhet bërë apo se si duhet të jetë një ekspozitë, ngaqë nuk ka një përkufizim për vetë veprën e artit. Fundja, përfundimi i mbramë i Heidegger-it, se “Qenia është ajo që është”¹, vlen edhe për veprën e artit: një vepër arti është ajo që është. Duke perifrazuar Bacon-in, mund të themi se nëse një gjë arrin ta shprehësh me fjalë, atëherë nuk është nevoja ta pikturosh, apo ta përkthesh në imazh.

Ka disa dekada që nisma për të hapur një ekspozitë vetjake apo në grup, tanimë është kthyer në një ngjarje rutinë, që ndodh siç ndodhin e gëlojnë qindra e mijëra ngjarje e veprimtari të tjera, të cilat vlejné e marrin frymë deri në çastin që ia beh ngjarja apo veprimtaria e radhës. Pra, për shkak të trysnisë së *shpejtësisë* që imponon motori i qytetërimit, por mbi të gjitha ngaqë ne jemi përshtatur (dorëzuar), edhe një veprimtari mirëfilli kulturorë si ekspozita, duhet t’i nënshtrohet një kategorie të qytetërimit: zbavitjes, spektaklit në përgjithësi.

Prandaj, tashmë nuk na bën më përshtypje dendësia marramendëse e ekspozitave, të cilat zhduken po me atë shpejtësi që hapen; një veçori tipike e spektakolares. Mjafton që ndodhi diçka “e re”, diçka që “të mbërthen”, siç thuhet rëndom; domethënë, që të paralizon.

Koha evolucioniste është një perëndi e llojit të vet që kërkon fli pafund. Në këtë pikë, medoemos që duhet përmendur edhe agjenti që i është nënshtuar këtij rendi të gjërave, pra artisti i shtrënguar paq me detyrën e fabrikuesit të veprës (për qytetërimin çdo gjë është prodhim dhe konsum). Me pak fjalë, për ta reduktuar në terma politikë, meqë qytetërimi tashmë është në pushtet dhe kultura në opozitë, tundimi për t’u bërë pjesë e tij është shumë i madh, së këndejmi edhe flirtimi i artistit me qytetërimin për hir të karrierës, pse jo edhe për të siguruar një vend në historinë e artit!

“Simbolizmi i një sendi mund të jetë i shprehur ose jo, por ekziston gjithnjë. Mund të themi se në një rrëfenjë, një send është përherë një send magjik”, shkruan Calvino-ja në librin *Leksione amerikane*. Ama duhet shtuar se një send ose një gjë në

përgjithësi, pavarësisht magjepsjes që ushtron, – kurmi magjik me të cilin është mbështjellë – mbetet vetëm një ngashënjim të cilin na e përcjellin shqisat tona të brishta, që nuk duhet të harrojmë se janë të kufizuara.

Kështu, këto forma organizuese të ekspozitave, – për t’u rikthyer te citimi në krye – sidoqoftë na japin një leksion pa seminar mbi epokën në të cilën jetojmë, por gjithnjë për një epokë e cila e konsideron veprën e artit thjesht një fabrikim ndër shumë fabrikime të tjera që duhen konsumuar, duke ndrydhur në këtë mënyrë përjetimin.

Brenda këtij rendi dhe duke iu përgjigjur atij, vepër e artit nuk mund të jetë asnjëherë prani/gjurmë e një rendi tjetër gjërash. Nëse artisti resht së na kujtuari rreth kësaj pranie, atëherë ai ka tradhtuar vetveten.

“Porse në disa të rralla përjashtime [...], na rrëfen me anë të pikturave – në vend të fjalëve – një histori të mrekullueshme.” (Llosa)

Ç’është kjo histori e mrekullueshme? Si duhet ta kuptojmë? Ose, më saktë, a ka vërtet një mënyrë se si duhet ta kuptojmë?

Natyrisht që nuk bëhet fjalë për një histori në kuptimin e zakonshëm, me atë narrativën klasike që na mban “të mbërthyer” deri në fund, por për një histori që nuk ia përcaktojmë/shquaajmë dot fillimin apo fundin.

Pra, mund të themi se bëhet fjalë për një meta-histori, që nis aty ku ndodhen kufijtë e fjalës. Pikërisht kjo e bën edhe më të “vështirë” avitjen me veprën, kuptohet jo avitjen fizike, që gjithsesi është e mundur për çdokënd.

Pa u arratisur nga koha mekanike e qytetërimit, do ta kemi gjithnjë të vështirë, mbase të pamundur të provojmë *catharsis*-in, jo vetëm në kuptimin aris-totelian, sepse Aristoteli i ka dhënë këtij nocioni një kuptim gati pragmatik.

Duhet lënë mënjane çdo leksion dhe çdo dije që na dikton në këtë drejtim, pasi pikërisht për këtë arsye jemi zhveshur nga përjetimi dhe jemi mbushur me njohuri kompleksuese, krejt anësore dhe kalimtare.

Nuk lipset të dimë ndonjë gjë konkrete, sepse një vepër arti nuk është dije, pavarësisht që e implikon këtë të fundit. Një vepër arti është vetëm një kujtesë që na shtyn drejt një qëllimi në një botë që po zbrazet nga kuptimi; një hapësirë e veçuar për të biseduar me zërin e brendshëm.

1. Perifrazim nga Bibla.



Arratisja e pamundur

— Xhafer Durmush —

Besimi në botën e përtejme është i rëndësishëm nga aspekti i zgjerimit të botës shpirtërore të njeriut dhe thellimit të mendimit të tij. Gjithashtu ky besim e bën njeriun të arrijë cilësinë e të qenët i volitshëm për të marrë përsipër detyrën që e pret. Besimi është shumë i rëndësishëm sepse e bën njeriun t'i marrë nën kontroll dëshirat e ulëta vetjake dhe pasionet dritëshkurtra. Nisur nga këto që thamë, në të gjitha fetë që janë dërguar nga Allahu i Madhëruar i është dhënë rëndësi e veçantë besimit ndaj Ditës së Gjykimit. Ndërsa në fenë islame, e cila është feja hyjnore e fundit, besimi në botën e përtejme është shprehur në mënyrën më ideale duke u vendosur edhe në bazat e tij. Jeta e ahiretit në botën e brendshme të shoqërive myslimane zë një vend më rrënjësor se sa vetë jeta e kësaj bote në të cilën jetojnë. Për shkak të kësaj cilësie, umeti islam është në pozitën e udhërrëfyesit për njerëzimin.

Jeta e Ahiretit, në të cilën hyhet nga dera e vdekjes, nuk është e kushtëzuar me kohën në kuptimin që pandehim në këtë botë. Në atë oqean të pafund gjenden fazat si jeta e varrit, tubimi në Ditën e Gjykimit, peshorja e veprave dhe ura e Siratit. Njeriu do të kalojë nga të gjitha këto faza dhe së fundi do të shkojë ose në ndonjërin prej bahçeve të Xhenetit, ose në ndonjërin prej gropave të Xhehenemit. Sot dëshiroj që t'i lexojmë disa prej ajeteve fisnike që na e kujtojnë njerërin prej skenave që do të ndodhë në ditën e llogarisë dhe që është prej këtyre fazave.


Në ajetet që na kujtojnë botën e përtejme, Allahu Teala shprehet për gjendjen e njerëzve kur t'u sillet

përpara llogaria me të gjitha detajet e saj në ditën e tubimit: **“Atë Ditë do të ketë fytyra rrëzëllore, të qeshura e të gëzuara. Atë Ditë do të ketë (edhe) fytyra të pluhurosura, që do t'i mbulojë errësira. Këta janë jobesimtarët, gjynahqarët.”** (Abese, 38-42) Ai të cilit do t'i rrëzëllejë fytyra kur t'i vendoset përpara libri i veprave të tij, do të thotë: **“Ja, lexoni librin tim! Vërtet, unë kam qenë i bindur se do të jepja llogari.”** (Hakka, 19-20) Ndërsa ata që do t'u nxihen fytyrat për shkak të insistimit të tyre në kufër dhe mëkate, Allahu (xh.sh.), nuk do t'i pastrojë dhe nuk do t'i mëshirojë.¹ Secila prej këtyre fazave do të jetë e vështirë dhe e rëndë për ata...

Njëri prej shembujve më spikatës në lidhje me hutimin në ditën e llogarisë gjendet në suren Abese. Në këtë sure thuhet: **“Atë Ditë njeriu do të ikë nga i vëllai, nga e ëma dhe nga i ati, nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet. Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t'i mjaftojë.”**² Siç shikohet, këtu bëhet fjalë për dëshirën e arratisjes. Domethënë se ata që tentojnë ta bëjnë këtë, nuk i kanë respektuar në këtë botë të drejtat e atyre prej të cilëve ia mbathin. Ata i kanë lënduar të tjerët ose u kanë bërë gjëra për shkak të të cilave do të japin llogari. Ndërkohë Allahu Teala njofton se një arratisje e tillë do të jetë e pamundur duke u shprehur me këtë ajet fisnik: **“Atë ditë njeriu do të thotë: “Ku të iki?” Askund! S'ka strehë! Atë ditë, streha është te Zoti yt. Atë ditë, njeriu do të**

1. Surja Al Imran, 3/77.

2. Surja Abese, 80/34-37.



vihet në dijeni për veprat që ka bërë dhe për ato që ka lënë pa bërë. Po, vërtet që njeriu do të dëshmojë kundër vetvetes.³

Sipas bindjes sonë, ajetet e sures Abese kanë një vend të rëndësishëm ndërmjet tablove të Ahiretit për të cilat Zoti (xh. sh.), na njofton, sepse në këto ajete njeriut i kujtohet se do të vijë një kohë kur do të kërkojë të arratiset për ato që ka bërë apo që ka lënë pa bërë, porse një arratisje e tillë do të jetë e pamundur. Para së gjithash duhet të mendojmë rreth këtij fakti. Pastaj duhet të mendojmë edhe për faktin se këtu janë përmendur njerëzit më të afërt të njeriut, se shprehja këtu është përdorur në kuptim të përgjithshëm dhe më e rëndësishmja prej të gjithave, ata prej të cilëve njeriu do të dojë të arratiset janë vëllezërit e motrat, prindërit, bashkëshortët dhe fëmijët. Me të vërtetë, a mund ta imagjinojë se çfarë pendimi do të ndjejë ai njeri që do të dojë të arratiset prej njerëzve me të cilët ka dashur më së shumti të qëndrojë me ta në këtë botë? Sa e vështirë do të jetë llogaria me të tjerët e atij që dëshiron të arratiset edhe prej më të afërmve të tij?

Me sa duket, kuptimi i këtyre ajeteve është ky: “Bëjeni jetën në atë formë që të mos keni nevojë të planifikoni një arratisje të tillë, e cila sidoqoftë është e pamundur. Herë pas herë merreni veten në llogari dhe pyeteni atë për çdo gjë. Nëse keni gabime të caktuara, kompensojini, kërkoni hallallin dhe pendohuni. Bëni punë që atë ditë do t’ua ndrisin fytyrën.” Edhe Umeri (r.a.), ka thënë: “Merreni veten në llogari para se të merreni në llogari! Përgatituni për gjykimin e madh!

3. Surja Kijame, 75/10-14.

Shpresohet që llogaria në botën e përtejme të jetë e lehtë vetëm për ata që e kanë marrë veten në llogari kur kanë qenë në këtë botë.” Ndërsa Mejmun ibn Mihrani ka thënë: “Robi nuk mund të bëhet i devotshëm derisa ta kontrollojë veten e tij siç kontrollojnë ortakun si dhe burimin e tij financiar të ngrënies dhe veshjes.”⁴

Përfundimisht mund të themi se në të ardhmen kemi një llogari që do të na sillet para nesh me të gjitha detajet e saj. Atë ditë secili prej nesh do të merret me hallin e tij dhe nuk do të ketë mundësi t’u bëjë ndonjë të mirë as edhe më të afërmve. Të gjithë do të kërkojnë të ikin prej shumë të tjerëve. Ndërkohë jepet edhe sihariqi: “Suksesi i atyre që do t’u ndriçojnë fytyrat do të jetë shpëtimi i madh.”⁵, ngaqë llogaria do t’u kalojë lehtë. Këtë nuk duhet ta harrojmë asnjëherë: Sukseset e mëdha kërkojnë mund dhe përkushtim serioz.

4. Rijazu’s-Salihin, Botimet Erkam, vëll. I, fq. 315-316.

5. Surja Saffat, 37/60.



CILI ËSHTË RREZIKU I VËRTETË?

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: **“Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.”** (Bakara, 195)

Brenda kufijve të “harxhimit të pasurisë në rrugën e Allahut” që u përmend më sipër, futen të gjitha punimet, përpjekjet dhe mundimet e bëra për ta predikuar dhe përhapur fenë, sepse shpenzimet që bëhen në këtë rrugë janë të rëndësishme për sigurimin e paqes siç janë të rëndësishme edhe nga aspekti i gjallërimit të jetës shpirtërore të myslimanëve. Për këtë arsye, nëse myslimanët i harxhojnë mundësitë vetëm për dëshirat vetjake, do të thotë se po e hedhin veten në rrezik me duart e tyre. Nëse veprojnë kështu, do të mposhten dhe poshtërohen në këtë botë. Gjithashtu edhe në botën e përtejme do të kenë një llogari të vështirë.

Shkaku i zbritjes së këtij ajeti fisnik është kjo ngjarje: “Në një ushtri që doli me shpresën për të fituar sihariqin në lidhje me çlirimin e Kostandinopojës/Stambollit, gjendej edhe Ebu Ejjubel-Ensariu (r.a.). Ndërkohë që bizantët e kishin mbështetur shpinën te muret e qytetit dhe po luftonin, një person prej ensarëve shkoi me kalin e tij deri në mes të tyre. Atyre që e panë iu kujtua ajeti: **“Mos e hidhni veten në rrezik me duart tuaja!”** – dhe thanë: “Ai po e hedh veten në rrezik para të gjithëve.” Ndërsa Ebu Ejjubel-Ensariu (r.a.), tha: “Ky ajete ka zbritur për shkak të sjelljeve të ne ensarëve. Kur Allahu i Lartësuar e ndihmoi të Dërguarin e tij (a.s.) dhe i dha fitore fesë islame, ne patëm thënë: “Tashmë le të qëndrojmë në krye të pasurisë sonë dhe të merremi me rregullimin e saj.” Për shkak të kësaj fjale, Allahu Teala shpalli këtë ajete.”

Nisur nga këto që thamë më lart, rreziku i vërtetë është dobësia e shpirtit të luftës e përpjekjes në rrugën e Allahut (xh.xh.) dhe verbërimi i ndjenjave të të dhënit e mirësisë që e ushqejnë këtë. Dëshmitar për këtë është edhe tregimi i rëndësishëm së haxhit dhe umres, të cilat e forcojnë vëllazërinë e solidaritetin ndërmjet besimtarëve, që vijnë në ajetet pas këtyre ajeteve që kemi dhënë më sipër.



Përse jemi NË KËTË GJENDJE?

— Ali Riza Temel —

Gjendja e sotshme e botës islame është ashtu siç e shikojmë të gjithë. Për këtë arsye, ne duhet të flasim në lidhje me shkaqet e dobësisë që po përjeton në ditët e sotme ky umet, i cili i ka prire njerëzimit në shumë aspekte dhe ka formuar një civilizim shembullor. Pa u caktuar diagnoza nuk mund të ketë mjekim.

Një umet, siç shprehet edhe Kurani Fisnik, i cili përkufizohet si “umet mesatar, umeti më i mirë, umeti dëshmitar, umeti që urdhëron të mirën dhe ndalon nga e keqja” dhe që i ka pasur këto cilësi përgjatë historisë, përse sot është i privuar nga këto cilësi?

Me aq sa vihet re, shkakut i vërtetë i problemit është lëkundja e identitetit të vërtetë prej myslimani dhe degjenerimi në planin e mendimit e aksionit. Shkaqet e fitores dhe të humbjes duhet të kërkohen më shumë brenda se sa jashtë. Këtë e pohon edhe Allahu Teala duke u shprehur në ajetin fisnik: **“O ju që keni besuar! Ju keni përgjegjësi vetëm për veten tuaj! Ai që është i humbur nuk mund t’ju dëmtojë, nëse jeni në rrugë të drejtë. Tek Allahu do të ktheheni të gjithë e do t’ju lajmërojë për atë që keni punuar.”** (Maide, 105)

Rrugëzgjdhja për t’u mbrojtur nga tërmeti është ndërtimi i ndërtesave që i rezistojnë tërmetit. Personaliteti që ndërton shpallja hyjnore është rezistues kundrejt çdo lloj lëkundjeje. Një personalitet që mbështetet te themeli i besimit, mendjes dhe moralit është një personalitet i shëndoshë dhe i lartë. Zoti (xh.sh.), flet edhe për këtë çështje: **“Mos u ligështoni dhe mos u pikëlloni, sepse ju, gjithsesi jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë.”** (Al Imran, 139) Shkakut i dobësive që po përjetojmë sot është rënia në pikëpamjen e besimit, mendjes dhe moralit. Nëse nuk forcojmë bazën, nuk mund të ndërtojmë një ndërtesë të qëndrueshme. Dobësitë tona kryesore që burojnë nga prishja e identitetit dhe personalitetit prej myslimani të vërtetë dhe që na sjellin vetëm dështime janë si më poshtë:

1. Kërkimi i mangësisë te të tjerët në vend që ta kërkojmë te vetja jonë. Ky botëkuptim na shtyn që të nxjerrim teori komploti. Ne përpiqemi ta nxjerrim veten të pastër duke thënë se armiqtë tanë janë shkaktarë për çdo tragjedi që përjetojmë. Vazhdimisht i mallkojmë armiqtë tanë. Mikrobet gjithmonë dëmtojnë trupin e dobët. Kjo botë është bota e përpjekjes dhe luftës. Prishja është fundi i pashmangshëm i atij që dobësohet. Armiq gjithmonë do të ketë. Edhe në fillim Islami ka pasur shumë armiq. Megjithatë myslimanët fituan. Në sajë të besimit dhe vullnetit të tyre të fortë, kjo kauzë u përhap dhe u forcua. Prandaj, në vend që të kërkojmë justifikim për mposhtjen, duhet të flasim për shkaqet e saj.

2. Kërkimi i shpëtimit të vullneti i mbinatyrshëm duke e nxjerrë veten jashtë funksioni. Suksesit i vërtetë është që njeriu t’i përdorë të gjitha mundësitë, të bëjë çdo gjë që ka në dorë dhe pastaj t’ia lërë Allahut Teala. Baza është përgjegjësia personale. Edhe Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: **“Njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar.”** (Nexhm, 39) Për ta arritur suksesin, duhet të jemi të fuqishëm dhe të përgatitur. Këtë e urdhëron edhe Zoti (xh.sh.): **“Përgatisni kundër tyre kuaj dhe forcë për luftë sa të mundni, që të tmerroni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerë, përveç tyre, të cilët ju nuk i njihni, por që Allahu i njeh. Çfarëdo që të shpenzoni në rrugën e Allahut, do t’ju shpërblehet dhe nuk do t’ju bëhet padrejtësi.”** (Enfal, 60) Kuajt e luftës janë përmendur ngaqë në atë kohë ata kanë qenë arma më e mirë për luftë. Këtë shprehje duhet ta kuptojmë në formën për të pasur armët më të mira të kohës. Përveç të tjerash, fuqia nuk është vetëm armë. Edhe informacioni, teknologjia, media, paraja, morali, komunikimi, etj. janë prej burimeve të forcës. Lutja, ndih-

ma hyjnore dhe kerameti/mrekullia nuk i bëjnë dobi atij që fle, por atij që përpiqet dhe derdh djersë. Pa punuar nuk ka ndihmë. Zoti (xh.sh.), i jep atij që punon. Siç nuk janë të njëjtë ata që dinë me ata që nuk dinë, po ashtu nuk janë të njëjtë edhe ata që punojnë me ata që nuk punojnë. I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, edhe ka punuar, edhe ka luftuar. Ai (a.s.), ka thënë: *"Fuqia është gjuajtja."* Edhe gjuajtja e shigjetës, gjuajtja e raketës, derdhja e djersës dhe përpjekja serioze janë brenda konceptit të fuqisë.

3. Të besuarit se është i mjaftueshëm për arritjen e suksesit të qenët i mirë dhe i devotshëm. Këto cilësi sigurosh se janë shumë të rëndësishme për një besimtar. Por ja që nuk është e mjaftueshme të jemi vetëm të padëmshëm, gjithashtu duhet të jemi edhe të dobishëm. Sigurisht që është vepër e mirë që t'i kryesh adhurimet, të preokupohesh me nafilet, të falësh namaz nate, të bësh dhikër dhe të bësh tesbih deri në një numër të caktuar, por moskryerja e shkaqeve, mosmarrja e masave që na i bëjnë të domosdoshme kushtet e kësaj bote në të cilën gjendemi dhe qëndrimi larg aktiviteteve, planeve e programeve, nuk mund të jenë prej veprimeve të besimtarit. Përhapja e mirësisë nuk mjafton për t'u bërë i mirë, por duhet që ajo të bëhet edhe dominuese në shoqëri. Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja është detyra themelore e këtij umeti. Për të urdhëruar duhet të jesh i fortë dhe për të dhënë zekat duhet të jesh i pasur. Të dobët nuk mund të urdhërojnë, por marrin urdhra. Besimtari i fuqishëm është më i dashur te Allahu Teala se besimtari i dobët. Njeriu nuk mund ta tërheqë i vetëm ndihmën hyjnore për t'u bërë i mirë dhe i devotshëm. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: *"O ju që keni besuar! Nëse e ndihmoni (fenë) e Allahut, edhe Ai do t'ju ndihmojë dhe do t'ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja."* (Muhammed, 7)

4. Të ngushëlluarit duke u lavdëruar me të kaluarën. Padyshim se nuk do ta harrojmë të kaluarën tonë, por të lavdëruarit vetëm me sukseset në të kaluarën nuk i zgjidh problemet aktuale. Nëse ato suksese shndërrohen në burim fuqie e morali për ne, do të thotë se na bëjnë dobi. Në fakt, kjo është ajo që sot po bëjmë në përgjithësi. Ajo që duhet të bëjmë është që t'i mbrojmë fitoret dhe veprat që na kanë lënë gjyshërit tanë dhe t'ua japim brezave të ardhshëm bashkë me fitoret dhe veprat tona të reja. Nëse lavdërohemi me Selahuddin Ejjubin, Alpasllanin, Sulltan Fatihun, Javuzin, etj. por nuk mbartim asgjë prej përpjekjeve, dashurisë dhe emocionit të atyre, atëherë kjo që bëjmë ne nuk ka asnjë kuptim. Në librin me titull "E djeshmja, e sotshmja dhe e nesërmja e myslimanëve", të cilin e kam përkthyer dhe i cili bën fjalë rreth lavdërimit tonë të pabazë me të kaluarën duke mos bërë gjërat e domosdoshme që na i kërkojnë kushtet e kësaj bote në të cilën jetojmë, profesori Vahidu'd-Din Hani thotë siç vijon: "Kur heronjtë e fjalës flasin në lidhje me çështjen e Palestinës, në përgjithësi e përfundojnë

fjalën e tyre me këtë fjali: "Padyshim se Palestina sot ka nevojë për një Salahuddin Ejjubi që ta çlirojë." Këta heronj besojnë se ia kanë dhënë hakun fjalës kur ta thonë këtë. Ndërsa e vërteta është kjo se një shprehje e tillë buron nga një mendim krejt shterpë për sa i përket kauzës së Palestinës. Lindja e një personi si Salahuddin Ejjubi sot nuk mund ta zgjidhë problemin e Palestinës, sepse Salahuddini ka qenë një hero të cilin e nxorën në pah koha dhe rrethanat e kryqëzatave. Ai e shpëtoi Kudsit që ngeli nën sundimin e fuqive pushtuese për nëntëdhjetë vjet me radhë. Salahuddin Ejjubi ndërroi jetë në vitin 1195. Çlirimet që bëri ia thyen mesin perëndimit. Perëndimi dridhej nga frika prej Salahuddin. Kjo frikë arriti deri në atë gjendje sa që vendosën "taksën e Salahuddin" për të mbledhur para, në mënyrë që ta sulmonin. Vlera e kësaj takse ishte një e dhjeta e fitimit vjetor të një evropiani. Salahuddin Ejjubi nuk përfitonte vetëm nga besimi dhe trimëria, por në të njëjtën kohë përfitonte edhe nga fuqia e madhe ushtarake e asaj periudhe. E vërteta është kjo: Sado i guximshëm që të jetë një njeri, gozhdën nuk mund ta ngulë në mur me grusht. Patjetër ka nevojë për një çekiq. Ndërsa ne mjaftohemi duke u lavdëruar me besimin dhe heroizmin. Ndërkohë, trimëria nuk mund të jetë shkak për fitore pa u armatosur me armatimin e kohës. Lavdërimi me të kaluarën ka nxjerrë në pah hatibë/ligjërues dhe poetë që i prekin ndjenjat me fjalët e fuqishme të tyre. Po të jemi objektivë, do të fillojmë të bëjmë aktivitete për të ndërtuar të ardhmen duke bashkëpunuar si japonezët në vend që të lavdërohemi me të kaluarën dhe të mallkojmë armiqët."

5. Formalizmi dhe fanatizmi. Edhe njëri prej shkaqeve të rëndësishme të dështimit tonë është formalizmi. Ndërkohë i rëndësishëm nuk është formalizmi, por kuptimi dhe urtësia. Imam Ahmed el-Karafi shprehet në veprën e tij me titull "Furuk": "Mos rri pas rreshtave nëpër libra përgjatë gjithë jetës. Preokupimi vetëm me transmetimet me një botëkuptim të ngrirë është devijim në fe dhe shkujes ndaj qëllimeve të dijetarëve të Islamit dhe të paraardhësve tanë të devotshëm." (Furuk, fq. 176-177.) Komentimi i teksteve fetare me kusht duke qëndruar brenda kornizës së dijes dhe duke qëndruar larg arbitrarizmit, është më i përshtatshëm për mirëqenien. Suksesi është i pamundur të arrihet me botëkuptimin e talibanëve.

Ne si individë jemi të detyruar të bëjmë një ndërtim total duke filluar nga vetja jonë dhe të bëjmë një strukturë të re në planin mendor e shpirtëror, në mënyrë që të shpëtojmë nga tabloja aktuale që e zemëron Zotin (xh.sh.) dhe që e lëndon të Dërguarin e Allahut (a.s.). Në këtë formë do të bëhemi robër në kuptim të vërtetë ndaj Allahut dhe umet i të Dërguarit të Allahut (a.s.).





Në ekstremizëm dhe sjelljet e tepruara gjendet një kuptim në formën: “Të mos mjaftohesh me atë që është mjaftuar sheriati dhe të mos e vlerësosh atë.” Domethënë, me një shprehje tjetër, këtu bëhet fjalë për një tentativë si: “Të bëhesh mysliman më tepër seç duhet.” Ndërkohë, një veprim i tillë edhe e lodh njeriun, edhe e shpie atë për t’u bërë bidatçi.

Ekstremizmi

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Çdo ndjenjë, mendim, shprehje dhe veprim i njeriut ka tri gjendje të veçanta që formohen nga ifrati / teprimi, tefriti / mangësia dhe itidali / gjendja normale. Kjo është diçka strukturore. E rëndësishme nuk është që ta mohojmë ndonjë gjendje apo cilësi strukturore/njerëzore, por përdorimi i tyre me masë pa rënë në ifrat e tefrit të cilat janë gjendje prej ku burojnë ekstremizmi dhe parregullsia.

Ekstremizmi në besim/mendim, në të shprehur dhe në veprime shfaqet si mosrespektim i kufijve, apo thënë më drejt, shfaqet si mosnjohje e caktut. Kur kjo gjendje të përhapet, atëherë në shoqëri lind anarkia, kaosi, rrëmuja, dhunimi i kufijve dhe i parimeve, parregullsia, mungesa e sistemit dhe shkelja e të drejtave.

Ekstremizmi e arrin pikën më të lartë dhe më të rrezikshme te teprimi në fe (el-guluvve fi’ d-din). Për shkak të kësaj, zhduket plotësisht apo pjesërisht cilësia “besimtar mesatar” në planin individual dhe “umet mesatar” në planin shoqëror. Kur të humbasë cilësia “mesatar, i mesëm, i drejtë dhe i matur”,

koncepti “mysliman i mirë” dhe “umeti më i mirë”, domethënë, autoriteti dhe influenca për të urdhëruar të mirën dhe për të ndaluar nga e keqja marrin plagë serioze apo ekzekutohen totalisht. Për këtë arsye, kjo temë aq sa është e rëndësishme për individët besimtarë, po aq është e rëndësishme edhe nga aspekti i ekzistencës dhe influencës së umetit.

Siç shprehet qartë në hadithin fisnik: *“Ai që është i kënaqur nga Allahu si Zot, nga Islami si fe e nga Muhamedi si Pejgamber dhe që nuk kërkon alternativë tjetër ndaj këtyre, do të thotë se e ka shijuar ëmbëlsinë e besimit.”*¹, umeti islam ka tri gjëra kryesore të shenjta. Ndërsa ekstremizmi, në cilëndo fushë që të jetë, herët apo vonë do t’u drejtohet/kthehet këtyre tri gjërave të shenjta.

EKSTREMIZMI NDAJ ALLAHUT

Ekstremizmi apo teprimi më i keq padyshim se është ai që bëhet kundrejt Krijuesit të Lartësuar. Ekstremizmi dhe teprimi që bëhet kundrejt Allahut Teala është shirku, domethënë, t’i shoqërosh Atij ortak ndonjëren prej krijesave të Tij dhe të tentosh ta përngjasosh Atë me ndonjëren prej krijesave të Tij. Shirku (politeizmi) është cilësuar si “padrejtësia dhe zullumi më i madh”² ngaqë mbart kuptimin kulmor në ekstremizëm. Edhe e vërteta se nuk do të ketë falje për robin përderisa ai të mos kthehet në besimin e tevhidit (monoteizmit)³, me shumë gjasa këtë vërteton. Edhe besimet si (triniteti) besimi në tre zota, veçimi i Zotit vetëm për një popull, dualizmi etj. janë ekstremizëm dhe mohim i Zotit brenda kornizës së shirkut.⁴

Mbi të gjitha, ekstremizmi kundrejt Krijuesit të Lartësuar në ajete të ndryshme është shprehur si “atribuim i fëmijëve ndaj Atij”, “të thënë Allahu është i varfër”, “mosrespektimi dhe shkelja e kufijve që i ka vendosur Ai”, “tentimi për t’i ndryshuar dispozitat hallall-haram të Tij”, “kundërshtimi i pejgamberëve që ka dërguar Ai duke mos i pranuar ngaqë kanë qenë njerëz”, etj. dhe është refuzuar me shprehje tejet të ashpra. Ajeti fisnik: **“Kush është më keqbërës se ai që trillon gënjeshtër për Allahun ose i përgënjeshtër shpalljet e Tij? Vërtet, keqbërësit nuk do të shpëtojnë.”**⁵, është vetëm një shembull për këto që thamë.

EKSTREMIZMI NDAJ ISLAMIT

Ekstremizmi kundrejt Islamit e shfaq veten e tij në shprehi dhe veprime me teprim dhe mangësi.

1. Tirmidhi, Iman, 10; Veçanërisht shik. Muslim, Iman, 56; Ahmed b. Hanbel, Musned, I, 208.

2. Lukman, 31/13.

3. Nisa, 4/48, 119.

4. Shik. Maide 5/73.

5. En’am, 6/ 21, 93, 144, 157; Veçanërisht shik. A’raf 7/37, 47; Saff 61/ 7.

Ekstremizmi që në përgjithësi shikohet si teprim dhe ekzagjerim në çështjet fetare, nuk e ka shpjerë askënd në shpëtim. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: *“O myslimanë! Largohuni nga ekstremizmi në fe, sepse ekstremizmi dhe pamaturia në fe i kanë shkatërruar ata që kanë qenë para jush.”*⁶ Ky është një paralajmërim i përgjithshëm që përfshin të gjitha llojet e ekstremizmit në besim dhe adhurim. Allahu Teala na ka njoftuar me këtë ajet fisnik se i ka ndaluar edhe umetet e mëparshme nga ekstremizmi/pamaturia: **“Thuaj: “O ihtarët e Librit! Mos i shkëlmi kufijtë e së vërtetës në besimin tuaj”**⁷ Nga ana tjetër, edhe Pejgamberi, alejhi’s-selam, ka thënë në një hadith fisnik: *“Me të vërtetë feja islame është e lehtë. Kushdo që ia vështirëson vetes, në mënyrë që të mos i ketë veprat pak, feja e mposht atë. Atëherë mbani mesataren dhe mjaftohuni me të! (Nëse veproni kështu) përgëzimet qofshin për ju. Përfitonin nga ecja në mëngjes e mbrëmje, gjithashtu, edhe nga ecja e natës dhe mos e lodhni veten tuaj! (Zgjidhni një mënyrë jetese të panxitueshme dhe të pashqetësueshme, në mënyrë që ta arrini qëllimin!)”*⁸ Këtu njoftohemi qartë se do të ishte më e drejtë sikur të përpiqemi që punët t’i bëjmë në kohët më të përshtatshme dhe pa e futur veten në vështirësi. Edhe hadithet fisnike si: *“Janë shkatërruar ata që shfaqin përpikëri të tepërt dhe që i vështirësojnë punët.”*⁹ – dhe: *“Feja më e dashur te Allahu është feja (Islami) që është ngritur mbi lehtësinë.”*¹⁰, na inkurajojnë për mesataren, domethënë, që t’i zbatojmë urdhrat e fesë me masë dhe me kriter.

Në ekstremizëm dhe sjelljet e tepruara gjendet një kuptim në formën: “Të mos mjaftohesh me atë që është mjaftuar sheriati dhe të mos e vlerësosh atë.” Domethënë, me një shprehje tjetër, këtu bëhet fjalë për një tentativë si: “Të bëhesh mysliman më tepër seç duhet.” Ndërkohë, një veprim i tillë edhe e lodh njeriun, edhe e shpie atë për t’u bërë bidatçi.

Të mosmjaftuarit me bazat që ka sjellë dhe na ka sugjeruar feja, në fazat e mëvonshme të shpie në ekstremizmin e pranimit të hallallit si haram dhe të haramit si hallall. Kjo gjë është vetë kufri. Nga Ibn Abbasi (r.a.), transmetohet se: *“Edhe ai që e konsideron hallallin haram është si ai që e pranon haramin hallall.”*¹¹ Ndoshta disa mund të veprojnë me hezitim në përfitimin nga disa mirësi që janë hallall dhe të lejuara me qëllim për ta edukuar veten

6. Ibn Maxhe, Menasik, 63.

7. Maide, 5/77.

8. Buhari, Iman, 29; Nesai, Iman, 28; Ahmed b. Hanbel, Musned, V, 29.

9. Muslim, IIm 7; Ebu Davud, Sunnet 5; Musned, I, 386. Veçanërisht shik. Darimi, Mukaddime 19.

10. Buhari, Iman 29. Veçanërisht shik. Buhari, I’tisam 5; Darimi, M - kaddime 19.

11. Abdurrezzak, Musannef, XI, 292.

apo për të arritur devotshmërinë. Nëse ky veprim mbështetet në mendimin për ta konsideruar haram atë që është mubah dhe hallall, atëherë nuk është devotshmëri, por kufër.

Ebu Kilabe (r.a.), transmeton: Një burrë shkoi te i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam dhe i kërkoi që t'ia falte namazin e xhenazes nënës së tij e cila kishte mbajtur agjërim derisa kishte ndërruar jetë. I Dërguari i Allahut (a.s.), tha: *"Ajo as nuk ka agjëruar, as nuk ka bërë iftar..."*¹² – dhe nuk ia fali namazin e xhenazes.

Fakti që i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *"Ajo as nuk ka agjëruar, as nuk ka bërë iftar..."*, për një grua që e ka praktikuar agjërimin, i cili është një ibadet, pa maturi dhe në një formë që e shkel kufirin që ka vendosur feja, nxjerr në pah në një mënyrë absolute se është e pamundur të bëhet një ibadet/adhurim i pranueshëm duke i shkelur kufijtë që ka vendosur feja.

Një lloj tjetër i ekstremizmit në fushën e zbatimit të fesë shfaqet në formën e tefritit/mangësisë/neglizhencës. Edhe pse të qenët besimtar është kushti themelor për të qenë në rrugë të drejtë dhe si rezultat, për të shpëtuar, prapë se prapë nuk është kusht i mjaftueshëm. Besimi ka nevojë për zbatim, domethënë, për vepra. Të shfaqësh indiferentizëm dhe neglizhencë ndaj detyrave (urdhrave dhe ndalesave) që ka caktuar feja dhe pastaj të pohosh se je një mysliman i pjekur dhe i mirë, të mjaftohesh duke qenë mysliman vetëm në mendime dhe të mashtrosh veten me pohimet se e ke zemrën e pastër, në të vërtetë është mungesë respekti dhe pamaturia ndaj fesë që ne e quajmë tefrit. Nisur nga këto që thamë më lart, edhe fetaria dhe devotshmëria e tepërt, edhe pohimet për mirësi në mungesë të veprave përbëjnë dy fronte të kundërta (teprim dhe mangësi/neglizhencë) në ekstremizmin/pamaturinë ndaj fesë.

EKSTREMIZMI NDAJ TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (A.S.)

Ekstremizmi ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), shfaqet në formën e mangësisë/neglizhencës dhe teprimit në nderim. Refuzimi i profecisë dhe i fesë që ka sjellë ai duke i mëshuar aspektit se ka qenë njeri, siç kanë bërë bashkëbiseduesit e parë me të (politeistët mekas), është ekstremizëm i natyrës së mangësisë. Siç dihet, edhe pse i Dërguari i Allahut (a.s.), ka qenë i njohur në shoqëri me personalitetin e tij të besueshëm, kur pohoi se ishte i Dërguari i Allahut, kjo e vërtetë nuk u pranua dot nga shumica e shoqërisë. Si të gjithë popujt e mëparshëm, edhe populli i Mekës nuk mund ta pranonte të vërtetën e të qenët e një njeriu profet. Ndërkohë ata duhej ta

pranonin si një njeri që merrte shpallje hyjnore, domethënë, si një njeri që ishte i Dërguari i Allahut.

Në Islam shpesh herë thuhet se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka qenë një njeri dhe kjo theksohet me këmbëngulje. Kjo është një e vërtetë strukturore që përbën pengesë për pamaturitë dhe prirjet ekstreme shenjtëruese, që mund të arrijnë deri në pranimin si zot të Hz. Pejgamberit. Gjithashtu përbën pengesë edhe për përqsjet dhe pamaturitë që e bëjnë Hz. Pejgamberin njeri të zakonshëm, që e kufizojnë dhe që ia ulin vlerën.¹³

I Dërguari i Allahut (a.s.), Allahu na faltë, nuk është zot siç kanë pas pandehur pasuesit e disa feve të tjera para Islamit për pejgamberët e tyre. Gjithashtu, ai nuk është biri i Zotit, gjysmë Zot apo engjëll. Çifutët e kanë cilësuar Uzejrin si bir të Zotit. Edhe të krishterët e kanë cilësuar Isain (a.s.), si bir të Zotit.¹⁴ Edhe kundërshtimet në formën: *"A një njeri ka dërguar Allahu si pejgamber?"*¹⁵, apo: *"A një njeri do të na çojë në rrugë të drejtë?"*¹⁶, janë një ekstremizëm apo pamaturia që vjen nga prirja për të kërkuar te një pejgamber cilësi të mbinatyrshme dhe mbinjerëzore.

Kufirin në lidhje me çështjen e pikës së fundit deri ku mund të arrijë ekstremizmi dhe pamaturia e teprimit në nderim, e ka vënë pikërisht vetë i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam. Ai (a.s.), ka thënë: *"Mos e teproni në lavdërim kundrejt meje siç e kanë bërë zot të krishterët birin e Merjemes gjoja duke e lavdëruar! Padyshim se unë jam një rob i Allahut. Për mua thoni: Robi dhe i Dërguari i Allahut. Kjo është e mjaftueshme!"*¹⁷

PËRFUNDIM

Kur ekstremizmi/pamaturia të përhapet si ifrat/teprim dhe tefrit/neglizhencë, mesatarja nuk ngelet më si rregull dhe nuk njihet. Kjo do të thotë që çdo gjë të bëhet rrëmujë, pra, pikërisht një ekstremizëm i vërtetë. Ndërkohë në fenë tonë ka sevap pa masë për atë që vepron me maturi dhe ndëshkim me masë për atë që vepron pa maturi. Atëherë, shfaqja e një kujdesi të veçantë e të madh në çdo çështje kundrejt gjërave të shenjta të Islamit, kufijve që ka vendosur dhe formave të praktikave që ka nxjerrë në pah Suneti, është një shenjë bazë që tregon pjekurinë e umetit në fetari.

13. Për informacion më të gjerë në lidhje me ekstremizmin dhe pamaturinë në fjalë, shik. Ismail Lutfi Çakan, "Përqsje të ndryshme kundrejt Hz. Pejgamberit", Biografia dhe Suneti i Hz. Pejgamberit në strukturimin Islamik, fq. 185-201, Stamboll, 2013, Botimet Ifav, nr: 235.

14. Tevbe, 9/30.

15. Isra, 17/94.

16. Tegabun, 64/6.

17. Buhari, Enbija, 48.

12. Shik. Abdurrezzak, Musannef, XI, 292.



Çfarë gjuhë të huaj kemi për të mësuar në shkollë?

A e keni vrarë mendjen ndonjëherë se pse ca breza mësojnë frëngjisht, ca gjermanisht, e ca rusisht si gjuhë të huaj në shkollat e tyre? Gjuha angleze e ka gjetur vendin e saj në programet mësimore në shumë shkolla publike dhe private. Kjo tendencë pasqyron prirjet e përgjithshme mbi informacionin dhe ekonominë globale. Askush nuk është i sigurt nëse kjo ka për të zgjatur për shumë kohë, por tashmë janë dhënë sinjale të rëndësishme që tregojnë se tashmë po shfaqen gjuhë të reja.

HISTORI DHE PARASHIKIME

Natyra dhe zhvillimi i blloqeve gjuhësore përgjatë historisë ka një bashkëlidhje të fortë me

lëvizjet e kolonializmit në Europë, që filluan në shekullin e pesëmbëdhjetë. Argumentet mbi zhvillimin e gjuhës janë të lidhur ngushtë me periudhën e kolonializmit. Për shembull, shumë gjuhë afrikane nuk ishin të institucionalizuara gjatë kësaj kohe, dhe kolonizatorët imponuan gjuhën e tyre në administratë, shkolla, e në komunikimet e tjera zyrtare shtetërore. Ky rend i ri i gjuhëve do të bashkekzistonte me ato lokalet, duke formuar kështu hierarki të reja dhe duke shtyrë më tej institucionalizimin e këtyre gjuhëve lokale. Të rriturve dhe fëmijëve u është mësuar frëngjishtja apo anglishtja, duke lënë pas dore gjuhët vendase të këtyre kolonive.

Dejvid Gredol (David Graddol) bën në studimin e tij dallimin midis niveleve të ndryshme të gjuhës. Perceptimi i tij mbi gjuhët e mëdha në vitin 1997 ishin anglishtja dhe frëngjishtja, por parashikimi mbi gjuhët e mëdha në vitin 2050 përfshin kinezishten, hinduishten/urduishten, spanjishten dhe arabishten. Ai shpjegon se këto zhvillime kanë për t'u nxitur nga shumë ndryshime ekonomike. Zhvendosja e gjuhës do të jetë e pashmangshme për shkak të numrit të këtyre folësve dhe rritjes së ekonomive midis tyre. “Asnjë gjuhë nuk do të ketë në shekullin e njëzet e një pozitën hegjemone që pati anglishtja në shekullin e njëzetë”, shprehet Gredol (Graddol).

HIERARKIA AKTUALE E GJUHËVE SIPAS GRADDOL-IT:

Gjuhët e mëdha: anglishtja dhe frëngjishtja

Gjuhët rajonale: arabishtja, kinezishtja, anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, ruishtja, spanjishtja

Gjuhët kombëtare: rreth 80 gjuhë, u shërbejnë 180 shteteve-kombe

Gjuhët zyrtare brenda shteteve-kombe: rreth 600 gjuhë në tërë botën

Gjuhët e folura lokale: pjesa e mbetur e 6000 gjuhëve të botës

HIERARKIA E PARASHIKUAR E GJUHËVE NË VITIN 2050 SIPAS GRADDOL-IT:

Gjuhët e mëdha: kinezishtja, hinduishtja/urduishtja, anglishtja, spanjishtja, arabishtja

Gjuhët rajonale (gjuha e blloqeve të mëdha tregtare): arabishtja, malezishjtja, kinezishtja, anglishtja, ruishtja, spanjishtja

Gjuhët kombëtare: rreth 90 gjuhë, u shërbejnë 220 shteteve-kombe

Gjuhët e folura lokale: 1000 apo më pak gjuhë të botës, me shkallë të ndryshme njohjeje zyrtare

GJUHA DHE PJESËMARRJA NË EKONOMITË GLOBALE

Gjuha dallon nga “mallrat” e tjerë në terma ekonomikë, sepse nuk është e konsumueshme. Gjuhës i rezervohet një besnikëri e lartë, sepse njerëzit nuk mund ta lëshojnë brenda natës zotërimin e gjuhës dhe të sigurojnë një tjetër, siç mund të jetë rasti me një produkt apo me një shërbim. Mësimi i gjuhës kërkon kohë, përpjekje, e shpesh angazhim në procesin e gjatë që mund të jetë i kushtueshëm.

Zgjedhjen tonë e përcaktojnë teknologjia, llojet e ndryshme të mjeteve të informimit, edukimi formal në shkollë dhe përfitimet e veçanta që sigurojmë me zotërimin e gjuhës. Ky varg kompleks faktorësh ka për të ndikuar në faktin nëse ne do të zgjedhim të mësojmë anglisht, kinezisht (apo, të themi më mirë, dialektin mandarin), portugalisht, spanjisht, apo ndonjë gjuhë tjetër. Afërsia e gjuhës suaj amtare me ndonjë gjuhë tjetër është gjithashtu një faktor i rëndësishëm dhe nxitje që ka për t'ju shtyrë drejt zotërimit të saj. Për shembull, rumanishtja i përket familjes së gjuhëve romane. Kjo do të thotë se folësit vendas të rumanishtes kanë për ta mësuar spanjishten, italishten apo frëngjishten me më pak përpjekje e me më pak kohë të harxhuar se një folës vendas gjerman.

Por çfarë e bën gjuhën globale? Vetëm numri i folësve vendas nuk mjafton për ta bërë gjuhën globale. Për shembull, nëse flasim për shifrën, kinezishtja mund të ketë numrin më të madh, por ajo mbetet një gjuhë e rëndësishme për rajonin aziatik, në veçanti për tregtinë dhe prodhimin industrial. Një gjerman, francez, kinez a indian ka për të zgjedhur anglishten si mjet komunikim në një takim ndërkombëtar biznesi. Kjo zgjedhje nuk është e rastësishme. Politikat publike në arsim në këto vende i kanë dhënë përparësi mësimi të anglishtes si gjuhë të huaj kundrejt gjuhëve të tjera.

Së fundi filloi të shfaqet në shkencat shoqërore termi “shoqëri rrjetesh”, si rezultat i zhvillimit në teknologji. Termi “shoqëri rrjetesh” u fut nga Manuel Kastels (Manuel Castells), dhe më tej ai e përkufizon termin si “një shoqëri struktura e së cilës përbëhet nga rrjete të fuqizuara nga informacioni me bazë mikroelektronikën dhe teknologjitë e komunikimit”. Rëndësia e këtij koncepti e kapërcen vetë termin. Ndryshimet në shoqëri ngjasin më shpejt, shkëmbimi i informacionit ngjet më shpejt, çështjet globale mund të jenë në pak minuta çështje lokale, dhe e kundërta. Ekonomitë nën një ndikim shumë të fuqishëm të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit kanë drejtime të ndryshme nga praktikat e shkuara, apo mund të ndryshojnë kryekëput në vetëm pak sekonda. Mendoni normën e këmbimit të aksioneve për firma të ndryshme aksionere globale; në pak sekonda ju mund të fitoni apo të humbisni miliona.

ZOTËRIMI I GJUHËS

Gjuha hap dyert e informacionit. Lindja e epokës së informacionit dhe zhvillimet e shpejta në internet dhe në platformat mediatike globale i bëjnë shumë tërheqëse format e reja të ekonomisë. Ekonomia informative është tashmë në agjendën e tendencave globale. I vetmi parakusht për kapitalin njerëzor është zotërimi i gjuhës.

Le të hedhim një vështrim retrospektiv në gjuhën e përdorur në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Tendencat në vitin 1997 treguan një shtrirje të gjuhës angleze në internet. Por rezultatet në vitin 2000 provuan shfaqjen e shumë blloqeve të tjera gjuhësore në përmbajtjen e internetit. Është e rëndësishme të vihet në pah rënia e dukshme e përqindjes së përmbajtjes në anglisht të internetit, nga 84 në 64.8 për qind. Kjo nuk do të thotë se materiali në anglisht është fshirë. Është rritur numri i gjuhëve të tjera, dhe

thjesht anglishtja nuk ka qenë në gjendje ta ndjekë këtë prirje me të njëjtën përqindje. Të dhënat e vitit 2010 tregojnë shfaqjen e blloqeve të tjera gjuhësore, sipas Internet World Stats. Anglishtja zbrit në 26.8%, e ndjekur këmba-këmbës nga gjuha kineze, me një diferencë prej 2.6%.

Përqindja e faqeve elektronike sipas gjuhës në vitin 2000:

anglisht	64.8
japonisht	5.9
gjermanisht	5.8
kinezisht	3.9
frëngjisht	3
spanjisht	2.4
rusisht	1.9
italisht	1.6
portugalisht	1.4
koreanisht	1.3
në gjuhë të tjera	4.6

Dhjetë gjuhët më të përdorura gjatë vitit 2010 në faqet elektronike (përqindjet):

anglishtja	26.8
kinezishtja	24.2
spanjishtja	7.8
japonishtja	4.7
portugalishtja	3.9
gjermanishtja	3.6
arabishtja	3.3
frëngjishtja	3
rusishtja	3
koreanishtja	2
gjuhët e tjera	17.8

Politikat publike, së bashku me faktorë të tjerë shtesë, kanë për të vendosur se ç’gjuhë kemi për të mësuar në shkollë. Cila do të jetë më me përfitim gjatë dhjetë viteve? Kjo mbetet për t’u parë!

*"Ah sikur të kisha vdekur
para 20 vjetësh!.."*

Sulejman ibn Surad

- RADIJALLAHU ANHU -

— Mustafa Erish —

Sulejman ibn Surad el-Huzai (r.a.), ishte një sahab jetëgjatë, i përkushtuar ndaj adhurimit dhe hero!.. Ai i përkiste fisit Huzaa. Lindi në Merru'z-zahran, i cili ishte atdheu i dytë i këtij fisi që pati ardhur nga Jemeni. Sulejman ibn Surad el-Huzai (r.a.), para se të bëhej mysliman e kishte emrin Jesar. Pasi u bë mysliman, i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ia ndërroi emrin dhe ia vendosi Sulejman. Në literaturën islame, për fat të keq, nuk gjenden shumë të dhëna në lidhje me jetën e tij. Vetëm thuhet se ai ka qenë ndër ata që kanë emigruar në Medine dhe se ka transmetuar hadithe.

Sulejman ibn Surad el-Huzai (r.a.), ishte trim, i dashur, i mëshirshëm dhe zemërbutë. Ai kishte një personalitet të dashur dhe të nderuar ndërmjet njerëzve të fisit të tij.

Kur u themelua qyteti i Kufës, ai ishte ndër të parët që shkoi atje për të banuar. Në Siffin qëndroi pranë Aliut (r.a.). Në luftën e Xhemelit nuk mori pjesë. Për këtë arsye, u qortua nga Aliu (r.a.).

Sulejman ibn Surad el-Huzai (r.a.), gjithmonë u shqetësua prej këtyre ngjarjeve të dhimbshme e të tmerrshme që ndodhën ndërmjet sahabëve. Deri në fund të jetës së tij nuk shpëtoi dot nga ndikimi i këtyre ngjarjeve. Dhimbjen dhe shqetësimin që ia shkaktonte në zemër kjo fitne e madhe e shprehu vazhdimisht deri në fund të jetës duke thënë: "Ah sikur të kisha vdekur njëzet vjet më parë dhe të mos

i shikoja këto që po ndodhin!" Shpesh nuk i mbante dot lotët prej trishtimit që i sillnin ngjarjet në fjalë. (Ibn Ebi Shejbe, Musannef, VII, 546/37835.)

Sulejman ibn Surad el-Huzai (r.a.), pasi Aliu (r.a.), ra dëshmor, i dha besën birit të tij, Hz. Hasanit. Pasi ai ia la kalifatin Muavijë ibn Ebi Sufjanit, nuk ia dha besën Muavijes dhe kreu detyrën e zëdhënësit të delegacionit që shkoi te Hasani (r.a.), që të hiqte dorë nga vendimi për ta lënë kalifatin.

Ai ka transmetuar rreth dhjetë hadithe. Njëri prej tyre përmendet në "Rijazu's-Salihin". Sulejman ibn Surad el-Huzai (r.a.), tregon: "Një ditë po qëndroja pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.). Dy vetë e ofenduan njëri-tjetrin. Njërit prej tyre iu skuq shumë fytyra prej zemërimit dhe iu frynë damarët e qafës. Pastaj menjëherë doli jashtë. Sapo i Dërguari i Allahut, alejhi's-salam, e pa këtë, tha:

"Unë di një fjalë që nëse ky njeri e thotë atë, do t'i kalojë zemërimi. Nëse ai thotë: Eudhu bi'l-lahi mine'sh-shejtani'rr-raxhim / i kërkoj mbrojtje Allahut nga shejtani i mallkuar, do t'i largohet zemërimi." Ata që gjendeshin aty, e njoftuan atë për këtë këshillë të të Dërguarit të Allahut (a.s.)." (Buhari, Bed'u'l-Halk 11, Edeb 44, 76; Muslim, Birr 109; Ebu Davud, Edeb 3.)

Në shpjegimin e këtij hadithi fisnik vihen në pah këto specifika: Një njeri që i është ngjitur gjaku në tru, që është skuqur shumë për shkak të zemëri-

mit dhe që i janë fryrë damarët e qafës e damarët anësorë të kokës, këshillohet që të thotë “eudhu besmelenë”, në mënyrë që të qetësohet pa bërë ndonjë veprim të gabuar. Kjo këshillë e të Dërguarit të Allahut (a.s.), e përforcon këshillën hyjnore që jepet në ajetin fisnik: **“Nëse djalli fillon të të nxisë, kërko mbështetje te Allahu. Me të vërtetë, Ai i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha.”** (Fussilet, 36)

Gjithashtu ka edhe një hadith tjetër që e transmeton Sulejman ibn Surad el-Huzai (r.a.), i cili i ndriçon shumë bukur ngjarjet e ditëve të sotme. I Dërguari i Allahut (a.s.), dha një lajm që do ta gëzonte umetin, pasi ushtria politeiste u arratis në fund të luftës së Hendekut. Ai dha sihariqin se tashmë e kishin myslimanët përparësinë për ta sulmuar armikun. Ja, hadithi të cilin e ka transmetuar Sulejman ibn Surad el-Huzai (r.a.):

Sulejman ibn Surad el-Huzai (r.a.), thotë: “Kur ushtria politeiste u shpërnda dhe po arratisej ditën e Hendekut, të Dërguarin e Allahut (a.s.), e dëgjova duke thënë:

“Këtej e tutje do t’i sulmojmë ne mushrikët, jo ata ne!.. Radhën e kemi ne...” (Buhari, Megazi 29.)

Lufta e Hendekut tregohet kështu në Kuranin Fisnik. Allahu i Madhëruar ua dërgoi ndihmën e Tij atyre që besonin. Në ajetet fisnike thuhet: **“O ju që keni besuar! Kujtoni dhuntinë e Allahut kur ju erdhi një ushtri (idhujtarësh), e Ne dërguam mbi ata erë dhe një ushtri (engjëjsh) që ju nuk e shihnit; ndërsa Allahu i sheh të gjitha ato që bëni ju.”** (Ahzab, 9) **“Allahu i zmbropsi jobesimtarët (e**

ushtrisë së aleatëve) me hidhërimin e tyre dhe ata dolën duarbosh. Ai i kurseu besimtarët nga lufta. Vërtet, Allahu është i Fortë dhe i Plotfuqishëm.” (Ahzab, 25)

Kur politeistët ikën të poshtëruar, mbrapa lanë shumë kafshë, armatime lufte, ushqime dhe gjëra të tjera. Në sajë të këtyre, mori fund edhe gjendja e dobët në Medine. Pas kësaj mirësie hyjnore dhe fitoreje të madhe, i Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, u tha sahabëve: *“Tashmë radhën e keni ju! Këtej e tutje kurejshit nuk mund t’ju sulmojnë!”* (Buhari, Megazi, 29)

Në këtë mënyrë, i Dërguari i Allahut (a.s.), u shpreh se tashmë nuk do të bënin vetëmbrojtje, porse mund të kalonin në sulm, sepse mushrikët ishin thyer edhe nga aspekti i krenarisë, edhe nga aspekti i fuqisë për të sulmuar. Tashmë në të gjitha zemrat e besimtarëve jehonin fjalët e të Dërguarit të Allahut (a.s.), që shprehnin këtë të vërtetë: *“Këtej e tutje do t’i sulmoni ju ata!”*

Sulejman ibn Surad el-Huzai (r.a.), ra dëshmor në moshën 93- vjeçare, në vitin 65 hixhri, në luftën Ajnu’l-Verde nën komandën e Ubejdullah ibn Zijadit që u bë me forcat emevite.

Allahu qoftë i kënaqur prej tij!

Allahu na dhëntë të gjithëve prehje dhe paqe! Na e mundësoftë të gjithëve që të marrim mësim nga përpjekjet dhe heroizmi i Sulejman ibn Surad el-Huzait (r.a.)! Të gjithë neve na bashkoftë në Xhenet me të! Amin!



VRASËSI E KA DHUNËN NË GJENE! POR...

— Xhihan Tashtan —

Vitet e fundit është rritur shumë numri i “vrasësve psikopatë”, por parandalimi i përhapjes së tyre, është në dorën tonë. Ne jemi një ymet që e duam “të gjelbrën”! Le ta edukojmë veten dhe familjen tonë me dashuri, dhembshuri dhe mëshirë.

Në filmin “Rruga e gjelbër” të vitit 1999, shikojmë John Coffey, një njeri të dashur, por që akuzohet se ka përdhunuar dhe ka vlarë dy vajza të vogla. Përmasat e tij gjigande dhe ngjyra e zezë e lëkurës, bëjnë që t’i vendoset vula e një vrasësi psikopat. Ai deklarohet fajtor që në seancën e parë. Gjatë qëndrimit në burg takohet me gardianë me cilësi mrekullibërëse, të cilët besojnë se Johni është i pafajshëm dhe është dënuar në mënyrë të padrejtë. Rojet nuk dëshirojnë që ai të dënohet për diçka që nuk e ka bërë, por Johni që nuk duron më të shikojë fytyrën e kësaj bote të mbushur me gjynahe, e derdh botën e vete shpirtërore në këto fjalë: “Jam lodhur, padron. Jam ngopur me sjelljet e padrejta të njerëzve ndaj njëri-tjetrit. Jam lodhur nga dhimbjet që ndjej dhe dëgjoj çdo ditë. Ka kaq shumë, më duket sikur çdo çast një xham më shpon pjesën e brendshme të kokës... A më kupton?”

Mos t’ia lejojmë vetes që të mashtrohemi nga pamjet e jashtme të njerëzve. Në mënyrë që ta kuptojmë një vrasës psikopat, duhet të lexojmë deri në thellësi të shpirtit të tij. Gjenet e fshehura ose faktorët ndikues të shoqërisë mund të bëhen shkak që nga mesi ynë, në çdo moment të dal një vrasës psikopat.

Babai i dashur i djalit “psikopat”

James Fallon është një profesor neurobiolog, në Universitetin e Kalifornisë që studion sjelljet e njerëzve. James është një njeri shumë i lidhur me familjen që ka ardhur nga një martesë e suksesshme. Në vitin 2005, teksa hulumton veçoritë e vrasësve psikopatë ai përballet me një fakt shokues. Pjesa më e madhe e konstatimeve e nxjerrin atë vetë vrasës psikopat. Ai kthehet me kujdes në studimin e rrënjëve familjare dhe zbulon se në familjen e tij, shumë breza më përpara, ka pasur 7 vrasës psikopatë. Një zbulim i tillë e bën që t’i shtrojë vetes pyetjen: “Sa do të ndikojë tek ai një e shkuar e tillë, a do të transformohet në vrasës?”

Ai bën analiza krahasuese mes trurit të njerëzve normalë dhe atij të vrasësve psikopatë. Qëllimi i tij



është që të kuptojë se si ndikojnë gjenetika, dëmtimet e trurit dhe faktorët shoqëror në kthimin e një njeriu normal në vrasës. Në fund të studimeve ai arrin në përfundimin se vrasësit serialë kanë një dëmtim në korteksin orbital, në pjesën sipër syve.

Gjithashtu, njerëzit psikopatë kanë nivel të lartë të gjeneve dominante të dhunës (MAOA). Individit i merr nga nëna këto gjene që merren me anë të kromozomit X. Në këtë mënyrë shpjegohet edhe fakti se pjesa më e madhe e vrasësve psikopatë janë meshkuj. Sepse vajza merr dy kromozome X, njërin nga nëna dhe tjetrin nga babai, duke bërë që ato të neutralizojnë njëri-tjetrin. Ndërsa djali e merr kromozomin X vetëm nga nëna, prandaj tek ai shihet më shumë ndikimi i këtyre gjeneve.

Gjatë zhvillimit në barkun e nënës, prodhohen sasi shumë të mëdha të hormonit serotinë, i cili ka veti qetësuese. Në sajë të kësaj, gjenet agresive qetësohen dhe nuk mbetet më asnjë veçori e tij tek jeta e ardhshme e individit. Ndërsa dalja në pah e gjeneve agresive është e lidhur ngushtë me traumat që njeriu ka në moshën e pubertetit. Dhuna ndaj fëmijës që i ka aktive gjenet agresive, ka shumë mundësi që të luajë rol të rëndësishëm në kthimin e këtij individit në një vrasës psikopat.

James, që e dinte se as babai dhe as xhaxhallarët e tij nuk kishin qenë njerëz të dhunshëm, arrin në një përfundim. Gjenet tona ose veçoritë e trashëguara (epigjenetika jonë) mund të fshehin brenda vetes potencialin për t’u kthyer në vrasës psikopat. Por është mënyra jonë e jetesës, marrëdhëniet me familjen dhe sjelljet e prindërve që mund t’i hapin rrugë një situatë shkatërruese.

Vendi ynë është i zhytur në situata stresuese. Agresiviteti i shoqërisë mund të shikohet gjithandej. Vitet e fundit është rritur shumë numri i “vrasësve psikopatë”, por parandalimi i përhapjes së tyre, është në dorën tonë. Ne jemi një ymet që e duam “të gjelbrën”! Le ta edukojmë veten dhe familjen tonë me dashuri, dhembshuri dhe mëshirë. Le të bëhemi nga njerëzit e drejtë, ato të “rrugës së gjelbër”.



SHTËPIA E VOGËL

Një fshatar shkoi te një i ditur dhe filloi t'i ankohej: "Ju lutem më ndihmoni. Përndryshe do të çmendem. Ne jemi një familje me shumë pjesëtarë dhe jetojmë në një shtëpi me një dhomë. Ngaqë nxehemi, i bërtasim njëri-tjetrit."

I dituri e pyeti: "A më jep fjalën se do ta bësh atë që do të të them?" Burri ia ktheu:

"Ju betohem se do të bëj çfarëdo që të më thoni." I dituri i tha:

"Mirë. Sa kafshë ke?" Fshatari iu përgjigj:

"Një lopë, dy dele dhe katër pula." I dituri i dha këtë sugjerim:

"Futi brenda në shtëpi të gjitha kafshët! Pas një jave eja përsëri te unë!"

Fshatari u habit prej atyre që i tha i dituri, por ja që e kishte dhënë fjalën. Në këtë mënyrë, edhe kafshët filluan të jetonin në shtëpi. Fshatari pas një jave shkoi te i dituri në gjendje të rraskapitur dhe i tha:

"Jemi në një gjendje shumë të keqe. Papastërti! Erë e keqe! Zhurmë! Të gjithë jemi gati duke u çmendur."

Kur i dituri i tha që të shkonte te shtëpia dhe t'i nxirrte kafshët, fshatari shkoi menjëherë si shigjetë. Të nesërmen fshatari shkoi prapë te i dituri dhe sytë po i qeshnin. Nga goja e tij dolën këto fjalë: "Sa e bukur paska qenë jeta! Shtëpia jonë është mjaft e rehatshme, e pastër dhe e madhe. Ajo duket pothuajse si një xhenet!"

NJË THËNIE

"Ai që kap shpatën duke qenë i zemëruar, më vonë do të kafshojë dorën duke u penduar."

(Sadi Shirazi)

NJË LUTJE

"O Zot! Shpëtoji myslimanët e dobët (nga shtypja e politeistëve).!"

(Ebu Davud, Vitr, 10.)

FAKTE INTERESANTE

- Të dëgjosh diçka me kufje për një orë, e shton me 700% numrin e baktereve në kufje.
- Asnjë letër nuk mund të paloset në dysh më shumë se shtatë herë.
- Fryma jonë në temperaturën minus 90 gradë, ngrin në ajër dhe bie.
- Çdo grimcë sheqeri ka 16 qoshe.
- Për ta hedhur njeriu një hap, i duhet të përdorë 200 muskuj.



Mjë Ajet

"Dhe Libri (i veprave të tyre) do t'u vihet përpara, e do t'i shohësh gjynahqarët se si do të tmerrohen nga ato që gjenden në të e do të thonë: "Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa shënuar". Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar. Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt."

(Kehf, 49)

Ky ajet na jep një tablo të qartë për atë që do të përjetojnë njerëzit në ditën e gjykimit, kur të gjithë pa përjashtim, të ndodhen të rreshtuar përpara audiencës hyjnore, pa asnjë mundësi për t'u fshehur apo për t'iu anashkaluar gjykimit suprem.

Mëkatarëve do t'u vendoset përpara regjistri që përfshin deri në detajet më të vogla, të gjitha veprat që kanë kryer në dynja, në mënyrë që të kenë mundësi të shikojnë veprat e tyre që edhe mund t'i kenë harruar. Kur shikojnë veprat e veta të mirëruajtura në këta regjistra, fillojnë të frikësohen për veten.

Duke u ndodhur përpara këtyre fakteve të pakontestueshme, nuk kanë asnjë arsye për të përligjur veprat e tyre. Kështu që, pa iu bërë asnjë padrejtësi, dënohen për veprat e kryera. Të gjithë ata që ditën e gjykimit do të përballen me një situatë të tillë, e dinin shumë mirë se shejtani ishte armiku i tyre, por ata e morën për mik dhe udhërrëfyes në jetën e tyre. Djalli i devijoi nga rruga e drejtë, duke i zvarrisur nëpër humnerat e ferrit.

Për të mos u përballur me një situatë të tillë, duhet patjetër që "çdo njeri

të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen." (Hashr, 18); pra gjykoni veprat tuaja, përpara se të gjykojeni dhe shikoni çfarë keni përgatitur për ditën e gjykimit kur të ndodheni përpara krijuesit tuaj. Kjo është një frazë që përçon mesazhe shumë domethënëse në zemrat e besimtarëve. Me të arritur në zemër ky mesazh, përpara besimtarit shfaqet regjistri i veprave mbi të cilin ai reflekton, me qëllim që të përmirësojë sjelljen a punën e tij. Dhe në këtë mënyrë e kupton çfarë ka përgatitur për të siguruar të ardhmen në botën tjetër.

Nëse një njeri reflekton dhe kontrollon në mënyrë të vazhdueshme veprat e tij, mundësia për t'i përmirësuar është më e madhe. Kurse njeriu që nuk reflekton mbi sjelljet e tij, duke treguar mospërfillje ndaj gjykimit në botën tjetër, do të dalë para Allahut në ditën e gjykimit i mjerë dhe pa mundësi kthimi mbrapa. Për të mos rënë në këtë gjendje të mjerueshme, çdo ditë duhet të arsyetojmë, ta riefreskojmë besimin duke kryer të mira që kënaqin Krijuesin.

Ebu Ja'la Sheddad ibn Evs (r.a.) transmeton se Resulullahi (a.s.) ka thënë:

"I zgjuar është ai që kontrollon veten e tij dhe përgatitet për jetën e botës tjetër, kurse i paaftë është ai që ndjek epshin e vet dhe krijon iluzione se Allahu do ta falë."

(Buhari)

RRETH TRANSMETUESIT

Ebu Ja'la Sheddad ibn Evs (r.a.), rrjedh prej një familjeje myslimane, mjaft të njohur ndër sahabët për dijen dhe asketizmin. Ka transmetuar 50 hadithe nga Pejgamberi (a.s.). Të gjitha transmetimet gjenden në koleksionin e famshëm kutubu sitte.

Janë një grup faktorësh, si besimi, shpirti, shoqëria, shejtani, që ndikojnë në vlerësimin e kësaj bote apo botës së përtejme.

Kontrollimi i vetes dhe përpjekjet për botën tjetër janë tregues të zgjuarsisë. Të mbash veten nën kontroll, së pari do të thotë të gjykos veten para se të gjykohesh, siç mbështetet edhe nga thënia e Omerit (r.a.): "Gjykoni veten para se të gjykoheni. Përgatituni për ditën e madhe të gjykimit, sepse gjykimi në botën tjetër do të jetë i lehtë për ata që në radhë të parë gjykojnë veten." Kurse Pejgamberi (a.s.), në një hadith tjetër, thotë: "Vlera e vërtetë e veprave matet sipas pasojave që sjellin", pra sipas hadithit, mençuria dhe zgjuarsia e vërtetë e njerëzve do të evidentohen në ditën e madhe të gjykimit.

Simptomë e paaftësisë është ndjekja e epsheve dhe krijimi i iluzioneve të kota se do të falesh nga Allahu. Të

gjithë ata që harxhojnë jetën pas epsheve të veta, u hapin krahët fantazive dhe ëndrrave të kota, sepse e vetmja gjë ku mund të ngushëllohen, janë fantazitë.

Feja islame i inkurajon, i nxit besimtarët t'i luten Allahut (xh.sh.), për çdo gjë. Por gjithmonë duke i marrë të gjitha masat që duhen për të përbushur dëshirat. Kurse ai që ushqehet me shpresa të kota në kryerjen e diçkaje, pa bërë përpjekjet e duhura, nuk ka bërë gjë tjetër vetëm se ka gënjyer veten e tij.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Mençuria dhe largpamësia dallohen nga sjelljet dhe veprat.
2. I mençuri dhe jo i mençuri përkufizohen sipas perceptimit dhe vlerësimit që i bëjnë botës dhe ahiretit dhe sipas përgatitjes që bëjnë në këtë botë për botën tjetër.
3. Për të përfituar prej mëshirës së Allahut, duhet të kryejmë detyrat që na takojnë.
4. Duhet të kontrollojmë vazhdimisht veten.
5. Allahu (xh.sh.), shpërblen veprat dhe jo shpresat e kota.

Mjë Hadith



EDUKATA E DHURIMIT



Nëse shohim thelbin e qëllimit të tasavvufit, vërejmë se ai përbëhet prej *dashurisë*, e cila është mjeti kryesor i zhvillimit shpirtëror dhe *edukatës*. Në bazë të kësaj, besimtari qëndron në rrugën që të çon në takimin hyjnor, aq sa ia përkushton thelbin e shpirtit të vet Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s). Dhe treguesi më i rëndësishëm i kësaj, është ngritja e nivelit moral personal, në nivelin e moralit pejgamberik.

Thelbin e moralit pejgamberik e përbën “ndjenja e lartë e edukatës”. Ashtu siç shprehen edhe sahabët fisnikë, i dashuri ynë, Pejgamberi (a.s.), ishte i turpshëm po aq sa një vajzë e virgjër, e mbështjellë me rrobën e saj. Në lidhje me edukatën që zotëronte, vetë Pejgamberi ynë (a.s.), shprehet: “*Mua më ka edukuar Zoti im dhe edukatën time e bëri të bukur.*” (Sujuti, el-Xhamiu’s-Sagir, I, 12.)

Mevlana, Xhelaleddin Rumi, në lidhje me *edukatën*, e cila shpreh virtytin e nivelit më të lartë njerëzor, thotë:

“Nëse do që t’i shtypësh kokën shejtanit, hapi sytë dhe shiko; ajo që e shkatërron shejtanin, është edukata. Nëse biri i njeriut nuk ka edukatë, në të vërtetë ai nuk është njeri...”

Mendja, e pyeti zemrën time: “Çfarë është besimi?”. Ndërsa zemra ime duke u përkulur në veshin e mendjes, tha: “Besimi është edukatë”.

Kjo shpjegon edhe faktin se në të shkuarën, një nga pllakatet që të tërhiqte më shumë vëmendjen në muret e teqeve, ishte: “**Edeb ja Hu!**”. Kjo shprehje, përveçse të ftonte në edukatë, në të njëjtën kohë ishte edhe një lutje/dua, që do të thotë: “O Zot! Na fal edukatë!”.

Ndjenja e edukatës, e cila përbën thelbin e besimit, është një cilësi që përfshin çdo fushë të jetës së besimtarit. Në veçanti, fushën e adhurimit dhe të veprave... Allahu i Madhëruar ka deklaruar duke na e bërë të qartë, se na ka krijuar vetëm e vetëm që ta adhurojmë Atë. Për këtë arsye, adhurimet dhe veprat tona, konsiderohen arteria kryesore e devot-



shmërisë sonë ndaj Allahut Teala. Pra, devotshmëria pa adhurime dhe pa vepra (të mira), as që mund të mendohet.

Megjithatë, aq sa është i rëndësishëm plotësimi i detyrave të devotshmërisë ndaj Allahut, po aq e rëndësishme është edhe mënyra e plotësimit të këtyre detyrave. Kjo, sepse respektimi i rregullave të edukatës gjatë adhurimeve dhe veprave është kushti i vetëm i arritjes së kënaqësisë dhe dashurisë së Allahut Teala. Për këtë arsye, adhurimet që bëhen pa respektuar rregullat themelore dhe edukatën, në mënyrë të pakujdesshme dhe vetëm për të kaluar radhën, nuk kanë shpërblime. Madje, ato janë vetëm një lodhje e padobishme për të zotin e tyre. Në lidhje me këtë, në një hadith fisnik, thuhet:

“Ka shumë njerëz që agjërojnë, por ajo që përfitojnë, nuk është gjë tjetër veçse një uri e thatë! Ka shumë njerëz që falin namaz nate, por prej atyre namazeve nuk përfitojnë gjë tjetër, përveçse pagjumësinë.” (Ibën Maxhe, Sijam, 21.)

Namazi, i cili është edhe një nga shtyllat e fesë sonë, ka disa kushte dhe rregulla. Po ashtu, edhe në dhënien e zekatit dhe sadakasë duhen respektuar me përpikmëri disa rregulla të rëndësishme të edukatës. Përndryshe, ashtu siç janë përmendur me një paralajmërim të ashpër ata që janë të pakujdesshëm në namaz; **“Mjerë për ata, të cilët falen dhe janë të pakujdesshëm”** (Maun, 4-5.), ashtu edhe shfaqja e sjelljeve të gabuara gjatë adhurimit të zekatit dhe sadakasë, mund ta çojnë robin në të njëjtin përfundim të keq.

MOS I ÇONI DËM DHURIMET DHE LËMOSHAT TUAJA!..

Allahu Teala, në lidhje me edukatën që duhet të tregojmë gjatë dhurimit, urdhëron:

“Ata, që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, pa e përcjellë atë me përgojim apo fyerje, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.

Fjala e mirë dhe falja e gabimit janë më të vlefshme se lëmosha që përcillet me fyerje. Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Butë (nuk nxiton në dënime).

O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në Allahun dhe Ditën e Fundit...” (Bekare, 262-264.)

Në këto ajete fisnike, Zoti ynë flet qartë për edukatën që duhet të tregojmë edhe gjatë bërjes së mirësisë. Pra, një mirësi, e cila bëhet duke thyer zemrat, duke poshtëruar nevojtarin, duke shkaktuar hidhërim dhe duke thumbuar, nuk ka asnjë vlerë tek Allahu Teala. Ata që dhurojnë me ndjenja të tilla arrogante dhe ashpërsie, i shkatërrojnë me duart e tyre shpërblimet e asaj që japin!..

T'i kujtosh të mirën që i ke bërë, duke e fyer nevojtarin, jo vetëm që e çon dëm mirësinë që ke bërë, por shkakton edhe zemërimin e Allahut Teala.

Njëherë, Pejgamberi (a.s.), tha tri herë me radhë:

“Janë tre persona, të cilëve në Ditën e Kiametit, Allahu Teala nuk do t'u flasë, nuk do t'i shohë dhe nuk do t'i pastrojë. Ata do të kenë një dënim shumë të dhembshëm”. Ebu Dherri (r.a.), pyeti:

“O Rasulallah! Kush janë këta persona, që iu shof-të emri, mos iu plotësofshin dëshirat dhe qofshin të humbur?” Pejgamberi (a.s.), u përgjigj:

“Ai që e tërheq zvarrë robën e tij (me mburrje dhe mendjemadhësi), ai që e shet mallin e tij duke u betuar rrejshëm dhe ai që kujton të mirën që ka bërë duke fyer.” (Muslim, Iman, 171.)

Siç shihet, dhurimet dhe lëmoshat për sy e faqe, që shoqërohen me fyerje dhe hidhërim, janë gjynahe të mëdha, të cilat në vend të shpërblimit, e shpjen njeriun në një dënim të dhembshëm. Kjo, sepse zemrat janë epiqendra e vëzhgimit hyjnor. Prandaj dhe nuk duhen lënduar..

Mbi të gjitha, zekati dhe sadakaja, janë e drejta më e natyrshme e nevojtarit, e cila merret prej pasurisë së të pasurve e përcaktuar me urdhër hyjnor. T'i japësh këtë të drejtë të varfrit, nuk është mirësi, por vetëm dorëzim i së drejtës së tij. Pasuria e kësaj bote, është një amanet hyjnor. Prandaj, ta harrosh këtë e të sillesh me dyfytirësi duke e fyer dhe hidhëruar nevojtarin, është shkujdesje, papjekuri dhe injorancë.

Gjatë dhurimit nuk duhet të sillemi me mendjemadhësi dhe nuk duhet ta përcjellim të varfrit, por përkundrazi, duhet ta vëmë veten në vend të tij dhe të mendojmë se një ditë edhe vetë mund të biem në gjendjen e tij. Edhe pse pasuria dhe varfëria janë çështje disi të lidhura me punën dhe përpjekjen, ato më tepër janë çështje të lidhura me caktimin e Zotit. Allahu Teala mund ta bëjë të pasurin të varfër dhe të varfrit të pasur, sepse këto nuk janë kritere superioriteti apo inferioriteti tek Ai. Të dyja

këto, janë një mënyrë sprove vetëm për këtë botë. Superioriteti është vetëm në devotshmëri. Pra, të sillësh me arrogancë dhe mburrje para të varfrit për shkak të dhurimit që bën, do të thotë se nuk e ke kuptuar dhe je i shkujdesur ndaj urtësisë së sprovës në jetën e kësaj bote. Shejh Sadiu, në veprën e tij *“Bostani”*, shprehet:

“Kur i bën mirësi dikujt, mos u mburr duke thënë: ‘Unë jam zotëri, ai ma ka nevojën! Mos thuaj: Koha e ka goditur atë nevojtar! Sepse shpata që godet, ende nuk ka hyrë në këllëf dhe është e mundur që një ditë, ajo shpatë të të godasë edhe ty.’”

Njerëzit e pasur, duhet të dinë se si ta vënë veten në vend të të varfërve dhe duhet të mendojnë: “Zoti mund të na kishte krijuar ne në gjendjen e tyre dhe ata në gjendjen tonë. Por, meqenëse na ka falur mundësi dhe ata i ka bërë nevojtarë, do të thotë se ata na i ka lënë amanet, të dobëtit i ka lënë në përgjegjësi të të fortëve. Ne na ka bërë përgjegjës për ta dhe ka urdhëruar t’u japim atyre si falënderim ndaj mirësive, që na ka falur Ai...”

Po në të njëjtën vepër, Shejh Sadiu na jep këto këshilla shumë të vyera e kuptimplote:

“Nëse ndonjë i mjerë vjen në derën tënde, mos e nis duarbosh! Allahu të ruajtë, por ndonjë ditë mbase edhe ti mjerohesh dhe troket në dyert e botës.

Interesohu për gjendjen e zemërthyerve dhe kujdesu për ta. Mbase ndonjë ditë edhe ti bie në gjendjen e tyre.

Ti që nuk troket në dyert e të tjerëve për të kërkuar diçka! Si falënderim për këtë, mos e dëbo të varfrin që troket në derën tënde dhe mos e var fytyrën, por prite buzagaz...”

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“A nuk ishe nevojtar e të bëri të mos ia kesh nevojën askujt? Prandaj, mos e shtyp jetimin, ly-pësin mos e shty me ashpërsi dhe shpalli dhuntitë e Zotit tënd!” (Duha, 8-11.)

Pjesa më e rëndësishme sjelljes me edukatë ndaj nevojtarit, është mospërmendja e mirësisë së bërë. Për të mos e hidhëruar nevojtarin dhe për të mos u mburrur para tij, duhet që pasi t’i kesh bërë një mirësi, ta harrosh atë. Sa bukur shprehet Llukmani:

“Dy gjëra mos i harro kurrë: Allahun Teala dhe vdekjen. Ndërsa dy gjëra harroji përgjithmonë: Të mirën që i bën dikujt dhe të keqen që të bën dikush.”

Të bëhesh me kuptimin e plotë të fjalës prej atyre që dhurojnë, është një mirësi shumë e vyer, e cila të fal paqe dhe qetësi në të dyja botët. Ata që arrijnë ta kryejnë në mënyrën e duhur këtë lloj

adhurimi, në bazë të përgëzimit të Allahut Teala, do të shpëtojnë prej frikës dhe hidhërimit gjatë krismës së tmerrshme të Kiametit. Për këtë arsye, mëshiruesi i pakufishëm, Allahu Teala, me anë të qindra ajeteve fisnike, ndërsa Pejgamberi ynë (a.s.), që dridhej me mëshirë ndaj umetit të vet, me anë të shumë haditheve, na motivojnë të arrijmë paqen dhe lumturinë që sjell dhurimi.

Me qëllim që mirësia e dhurimit, vlera e të cilit do të kuptohet më mirë në botën tjetër, të mos shkatërrohet për shkak të disa sjelljeve të pahijshme, Allahu Teala na paralajmëron ne robërit e Tij, me këtë ajet: ***“Mos i çoni dëm dhurimet dhe sadakatë tuaja!”***

Besimtari, është njeri bujar. Ndërsa bujaria e vërtetë është dhurimi me gjithë shpirt, pa u dridhur qerpiku e dora dhe me një qetësi të natyrshme, po aq sa rënia e shiut. Pra, me qëllim që mirësitë të kenë vlerë tek Allahu Teala, ato duhet të bëhen me të njëjtën natyrshmëri me të cilën lulet përhapin përreth aromën e tyre të këndshme!.. Vetëm një dhurim i tillë arrin tek Allahu i Madhëruar. Në një ajet fisnik, urdhërohet: ***“...Allahu është Ai që pranon pendimin dhe bamirësinë nga robërit e Vet...”*** (Teube, 104.)

Sa bukur e shpreh Mevlana i nderuar begatinë e një dhurimi, i cili bëhet me ndjenja kaq të bukura:

“Pasurinë dhe gjithçka që ke, dhuroje në mënyrën më të bukur, që të fitosh një zemër, duaja e së cilës do të të bëhet dritë në varr, në atë natë të errët!..”

Pra, ashtu siç nuk e kursejmë pasurinë tonë ndaj nevojtarit, duhet të mos e kursejmë as buzëqeshjen dhe as mirësjelljen ndaj tij.

I nderuari Shejh Mahmud Sami Ramazanoglu, kur shihte një nevojtar ndërkohë që ndodhej në makinë, e ndalonte atë, hapte derën ecte disa hapa deri tek nevojtari dhe ia dorëzonte sadakanë duke e zbukuruar atë me buzëqeshje dhe mirësjellje.

TË DHUROJMË DUKE FALËNDERUAR

Edukata dhe mirësjellja islame kërkon që dhurimi të konceptohet si një mirësi. Përveç kësaj, ai që jep duhet ta bëjë këtë duke qenë falënderues, sepse ky veprim e shpëton atë prej përgjegjësisë dhe bëhet shkak që ai të fitojë shpërblime prej Allahut Teala. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“..Çfarëdo të mire që të jepni, është në dobinë juaj, nëse këtë e bëni vetëm për hir të Allahut! Çfarëdo që të jepni nga të mirat, do t’ju rikthehet e plotë dhe nuk do t’ju bëhet padrejtësi.” (Bekare,



272.)

Nga kjo, kuptojmë se begatinë e vërtetë të mirësisë që bëhet, do ta gëzojë vetë ai që e bën atë, pa asnjë mangësi dhe, në bazë të sinqeritetit të tij, ai do të shpërblehet edhe shumëfish më tepër... Pra, edhe pse në pamje të parë duket sikur prej dhurimit fiton ai që merr, në të vërtetë ai është më i dobishëm për atë që jep. Për këtë arsye, ai që jep, në vend që t'ia kujtojë marrësit mirësinë që i bën, duhet t'i jetë mirënjohës atij. Imam Sha'bi thotë:

"I pasuri, i cili nuk e kupton se ka nevojë për shpërblimin e sadakasë më tepër se i varfri për sadakanë, e ka shkatërruar sadakanë e vet dhe e ka humbur shpërblimin."

Lum për ne, nëse kur të dhurojmë diçka, më parë kontrollojmë zemrën tonë dhe arrijmë bujarinë e vërtetë!..

Ka shumë prej atyre, që bëjnë mirësi duke e kujtuar atë, duke hidhëruar dhe duke pritur ndonjë përfitim prej saj. Mirëpo, ata që e konsiderojnë si mirësi dhurimin dhe nevojtarin, janë shumë të paktë. Robi duhet ta falënderojë Zotin e tij për mundësinë që i ka dhënë për të dhuruar dhe në të njëjtën kohë, duhet t'i jetë mirënjohës nevojtarit, i cili u bë shkak për këtë mirësi.

Kjo këshillë e Shejh Sadiut në lidhje me konsiderimin si mirësi të mundësisë për të dhuruar, përmban shumë urtësi:

"Falënderoje Allahun, që të dha mundësinë të bësh mirë, sepse Ai nuk e kurseu butësinë dhe mirësinë ndaj teje. Ai që i shërben sulltanit, nuk mund të presë që sulltani t'ia dijë për nder. Por ai vetë duhet t'ia dijë për nder, që e mori në punë."

Fort i nderuari Musa Efendiu, rahmetullahi alejh, zotëronte kriteret e duhura të edukatës së dhurimit, të cilat ishin për t'u marrë shembull. Ai dhuronte me një mënyrë islame aq të bukur, aq të mirësjellshme dhe aq të edukuar, saqë kujt dhe sa dëshironte t'i jepte, e vendoste në një zarf dhe pasi i drejtohej me respekt, mbi të shkruante:

"Ju falënderojmë që e pranuat dhuratën tonë." Pra, për arsye se u bë shkak që ai të fitonte kënaqësinë e Allahut, e falënderonte prej zemrës nevojtarin dhe tregonte kujdes të madh që të mos e bënte nevojtarin të ndihej i detyruar për mirënjohje ndaj tij.

Në vjershat e tij plot urtësi, Mevlana i nderuar shprehet:

"I skamuri është pasqyra e bujarëve. Kujdes, mos ia zbeh shkëlqimin pasqyrës, duke i thyer zemrën me fjalë fyese!"

"Ashtu siç ka nevojë skamnori për bujarinë dhe mirësinë, ashtu ka nevojë edhe bujaria dhe mirësia për skamnorin. Siç kërkojnë të bukurat, pasqyra pa pluhur, pa ndryshk dhe të shndritshme, të shikojnë bukurinë e tyre, ashtu e kërkon edhe bujaria skamnorin dhe të dobëtin."

"Manifestimi i bujarisë së Allahut del në pah tek të varfrit, të cilët kërkojnë prej bujarëve dhe ua qajnë hallet e veta. Dhe në këtë mënyrë, ata përgatitin rrugët e lumturisë për të pasurit fisnikë."

Për këtë arsye, faktin që një nevojtar kërkon ndihmë prej nesh duhet ta konsiderojmë si një mirësi prej Allahut dhe një nder që i bëhet besimit tonë. Sa bukur e shprehin këtë të vërtetë këto fjalë të Aliut (r.a.):

"Janë dy mirësi, që nuk e di se cila prej tyre më gëzon më shumë. E para: Kur dikush vjen tek unë me shpresën se do t'ia plotësoj nevojën dhe më kërkon ndihmë me sinqeritet të plotë. E dyta: Kur Allahu ia plotëson dëshirën ose e lehtëson nëpërmjet meje. Unë ndihem më mirë të plotësoj nevojën e një myslimani, sesa të kem një botë të tërë me flori dhe argjend." (Ali el-Muttaki, Kenzu'l-Ummal, VI, 598/17049.)

Mburrja e atyre që dhurojnë diçka, pritja për falënderim dhe mirënjohje, i fshin të gjitha shpërblimet dhe begatinë e të mirave që kanë bërë. Ai që dhuron diçka, përveç kënaqësisë hyjnore, nuk duhet të bartë qëllime të tjera dhe shpërblimin duhet ta presë vetëm prej Allahut Teala. Të mos harrojmë se të presësh dua dhe falënderim prej nevojtarit, është diçka që hedh hije mbi sinqeritetin e veprës.

Dhurimi që bënin Aliu dhe Fatimja (radijallahu anhuma), në lidhje me të cilin zbriti edhe një ajet përgëzues, duhet të jetë shembull për të gjithë besimtarët që janë bujarë dhe dhurojnë shumë:

"Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënë rob, edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: 'Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t'i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura.' Por Allahu do t'i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t'u japë shkëlqim dhe gëzim." (Insan, 8-11.)

*Ndjenja
e edukatës,
e cila përbën
thelbin e besimit,
është një cilësi që përfshin
çdo fushë të jetës
së besimtarit. Në veçanti,
fushën e adhurimit
dhe të veprave...*



Ja edhe një shembull tjetër nga nënat e umetit islam, në lidhje me dhënien e sadakasë “hasbeten lillah”, pra “vetëm për kënaqësinë e Allahut” dhe mospritjes së ndonjë falënderimi, me qëllim që të mos u pakësohet shpërblimi prej Allahut:

“Nënat tona, Aisheja dhe Ummu Seleme (radijallahu anhumaa), kur dëshironin t’u dërgonin diçka të varfërve, e porositnin dërguesin të mësonin përmendsh duanë/lutjen që bënëin të varfrit për to dhe në këtë mënyrë, edhe ato bënëin të njëjtën dua për ta (të varfrit). Duaja jonë le të jetë e barazvlershme me duanë e tyre, thoshin ato. Kjo, për arsye se ato nuk prisnin dua prej të varfërve, me qëllim që duaja e të varfërve të mos ishte shpërblimi i tyre. Sepse duaja është si shpërblim për sadakanë.” (Ihjaw Ulumi’d-Din, I, 601.)

RRUGA E ARRITJES SË MIRËSISË...

Zoti ynë, në një ajet fisnik, urdhëron:

“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni...” (Al ‘Imran, 92.) Me anë të këtij ajeti, Allahu na tregon rrugën për të arritur afërsinë me Të.

“Të dhurosh prej asaj që do”, është një nga çështjet ndaj së cilës duhet pasur më shumë kujdes gjatë dhurimit, sepse kjo tregon nivelin e dashurisë së besimit të robit ndaj Allahut.

Atëherë edhe ne duhet të mundohemi ta ngremë nivelin e dhurimit tonë, duke dhuruar në mënyrën më të bukur atë që e duam dhe na pëlqen më shumë dhe që do të kënaqeshim po të na e dhuronin të tjerët. Në këtë mënyrë, duhet të përparojmë në rrugën e cila na shpie tek përsosmëria e mirësisë. Duke e vënë veten në vend të të varfrit, të mendojmë se si do të dëshironim të na dhuronin të tjerët dhe sipas asaj të dhurojmë edhe ne. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që keni fituar dhe nga ato që jua kemi nxjerrë Ne nga frytet e tokës. Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj, të cilat ju nuk do t’i pranoni ndryshe veçse symbyllur. Ta dini se Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lëvdatë.” (Bekare, 267.)

Askush nuk duhet të mendojë se ka dhuruar gjë, nëse u jep të varfërve gjëra të prishura dhe pa cilësi, të cilat nuk do t’i merrte as vetë, nëse do t’ia jepnin të tjerët. T’i japësh nevojtarit një rrobë të vjetër, ushqim të prishur apo ta gëzosh atë për momentin me një dhuratë simbolike dhe më vonë ta lësh vetëm për vetëm me nevojën, skamjen dhe problemet e tij, nuk konsiderohet dhurim në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Besimtari, është njeri bujar. Ndërsa bujaria e vërtetë, nuk është të dhurosh gjëra të thjeshta dhe të

pakta, por përkundrazi, të dhurosh atë që do më shumë, që do të zgjidhë problemin, që do të shërojë zemrat, që është e dobishme dhe me vlerë.

NDIHMOUNI NË MIRËSI DHE DEVOTSHMËRI!

Qëllimi i dhurimit është ta shpëtosh plotësisht nevojtarin prej vështirësisë. Sigurisht që jo të gjithëve u mjafton buxheti dhe mundësitë për këtë. Atëherë, është e domosdoshme të bashkohemi dhe të ndihmohemi në mirësi. Allahu i Madhëruar, në një ajet fisnik ka urdhëruar:

“...Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira...” (Maide, 2.)

Të ndihmohemi në punë të mira, është urdhri i Zotit tonë. Kjo do të thotë që veçanërisht në punët ku përpjekjet individuale për mirësi janë të pamjaftueshme, të bashkëveprojmë dhe të përparojmë në mirësi, duke punuar sistematikisht, madje duke e kthyer këtë punë në një institucion.

Nga kjo pikëpamje, në kushtet kur nuk kemi forcë dhe mundësi në nivelin e mjaftueshëm për të zgjidhur problemet, duhet të përpiqemi të nxisim në mirësi shoqërinë përreth nesh dhe të zbatojmë në jetën tonë të përditshme urdhrin e Zotit tonë **“...Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira...”**

Besimtari duhet të jetë gjithmonë në kërkim të punëve të mira. Edhe nëse nuk gjejmë diçka për të dhuruar, duhet të dhurojmë kohën dhe punën tonë, me qëllim që të bëhemi shkak ose mjet për një mirësi.

Ne s’duhet të na zërë sëmundja e ngushëllimit të ndërgjegjes, sëmundje e cila sot është shumë e përhapur në shoqërinë tonë, ku njerëzit mjaftohen me dhënien e diçkaje të pakët, sa për të larguar të varfrin dhe nuk zgjidhin asnjë problem.

Duhet të mendojmë dhe të llogarisim mirë se sa prej mirësive që na ka falur Allahu mund t’i dhurojmë në rrugë të Tij?.. Në ç’përpjestim janë ato që dhurojmë në krahasim me ato që shpenzojmë për veten tonë?.. Apo mos ndoshta në çështjen e dhurimit e krahasojmë veten me nivelin e shoqërisë dhe e ngushëllojmë ndërgjegjen me disa ndihma të pakta?.. Ndërkohë, si besimtarë që jemi, në çdo çështje duhet ta krahasojmë veten me Pejgamberin tonë (a.s.) dhe sahabët e tij të zgjedhur. Edhe Allahu i Madhëruar na ka urdhëruar të marrim shembull robërit e Tij të devotshëm:

“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët, që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë...” (Teube, 100.)

Brezi i sahabëve, të cilët Zoti ynë na i ka treguar si shembull, **për herë të parë**, në periudhën e Me-

kës paguan **çmimin e besimit** të tyre me vuajtjet që hoqën dhe sakrifikimin e pasurisë dhe jetës. **Për herë të dytë**, në Medine paguan **çmimin e të jetuarit si myslimanë** duke mbajtur mbi supe sulmet e shumta të idhujtarëve. Ndërsa **për herë të tretë**, paguan **çmimin e përgjegjësisë së besimit**, duke punuar për të përhapur dhe bartur ndër shekuj dritën e fesë dhe të udhëzimit. Ata i shpenzuan në rrugë të Allahut të gjitha mirësitë që kishin, sepse jetuan gjithmonë duke menduar rreth ajetit:

“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!” (Tekathur, 8.)

Për t’u bërë edhe ne prej atyre që dhurojnë me sinqeritet në rrugën e Allahut, duhet të marrim shembull brezin e sahabëve të nderuar dhe të mundohemi të jetojmë të tria cilësitë e tyre, për të cilat folëm më sipër.

AI QË BËHET SHKAK I MIRËSISË, ËSHTË NJËSOJ SI AI QË E BËN ATË

Nga ana tjetër, ne duhet të sigurohemi që dhurimet që kemi bërë, të shërojnë një plagë të shoqërisë ose të zgjidhin një problem. Në lidhje me këtë çështje, në rast se nuk jemi të mjaftueshëm si një individ i vetëm, në vend që të tërhiqemi mënjane e të themi: “Ç’ të bëjmë, kaq kemi mundësi...”, duke e lënë nevojtarin vetëm për vetëm me dertin e tij, duhet t’i përvishemi punës me mendimin: “Vallë, a mund të gjej dikë tjetër, i cili mund ta shpëtojë këtë njeri prej vështirësive?..”, duke luajtur rolin e urës ndërmjet nevojtarit dhe atyre që kanë mundësi t’i ndihmojnë. Në një hadith fisnik, thuhet:

“Ai që bëhet shkak i mirësisë, është njësoj si ai që e bën atë.” (Tirmidhi, Ilim, 14.)

Për këtë arsye, sa herë që kanë pasur mundësi, të dashurit e Allahut i kanë motivuar njerëzit për mirësi, duke përjetuar shpirtërisht kënaqësinë e të qenit ortak në mirësitë e tyre.

Edhe të parët tanë, që ishin brumosur me këtë edukatë dhe vetëdije, arritën majat në mirësi dhe dhurime duke e pajisur shoqërinë me institucione bamirësie, të cilat u bënë rrjet mirësie. Në lidhje me këtë çështje, gjendja e të nderuarit Akshemsedinit, i cili luajti një rol shumë të madh në formimin e personalitetit dhe arritjet luftarake të sulltanit të famshëm Mehmet Fatihut, është shumë kuptimplotë:

Pas namazit të parë të xhumasë, pasi u çlirua Stambolli, në një shesh të madh u mbajtën festimet për fitoren e madhe. Padishahu u ishte shumë mirënjohës njerëzve të tij për ndihmën e tyre në këtë fitore të jashtëzakonshme. Prandaj, pasi mbajti një fjalim, ku ndër të tjera tha: “Mëshira e Rrahmanit qoftë mbi dëshmorët, lavdia dhe nderi mbi veteranët dhe falënderimet mbi pasuesit e mi...”, si dhuratë

për fitoren, u ndau pasuri, mall dhe tokë njëqind e shtatëdhjetë mijë ushtarakëve dhe civilëve. Ndërkohë, udhëzuesi shpirtëror i Mehmet Fatihut, Akshemsedini, iu drejtua veteranëve të luftës, të cilët ndodheshin aty duke i këshilluar me këto fjalë:

“O ju veteranë! Dijeni se Pejgamberi i fundit, për të gjithë ju ka thënë: **“Sa ushtarë të mirë që janë ata...”**. InshAllah të gjithë jenë të falur prej Allahut. Pasurinë dhe mallin që fituat prej luftës, mos e shpërdoroni, por shpenzojeni në bamirësi dhe bindjuni padishahut tuaj!..”

Në këtë mënyrë, për ta kurorëzuar me një lavdi të re, lavdinë e ushtrisë që çliroi Stambollin, ai i motivoi ata të ndërtonin institucione bamirësie për ndërtimin e qytetit dhe rimëkëmbjen e shoqërisë. (shih. Samiha Ayverdi, *Türk Tarihinde OSMANLI ASIRLARI*, Istanbul 1999, s. 227-228.)

Ne jemi pasardhësit e gjyshërve tanë, të cilët ndërton një civilizim të madh virtytesh. Frytet e begata të civilizimit, të cilin ata e ndërton me ndjenja dhe parime të larta, mund t’i shohim edhe sot në formën e vakëfeve, ndërtesave të ndryshme, çezmave etj. Prandaj, ne duhet ta ruajmë trashëgiminë e gjyshërve tanë dhe të përpiqemi edhe ne të ndërtojmë institucione të reja bamirësie dhe të gjallërojmë ato që ende ekzistojnë. Më parë duhet të bëhemi shembull duke pajisur botën tonë të brendshme me virtyte të larta; pastaj, për të ruajtur vlerat e shenjta që na kanë lënë të parët, duhet të edukojmë brezat e rinj me besim të fortë dhe dashuri për atdheun. Përndryshe, feja dobësohet, brezat humbasin dhe atdheu bie në dorë të huaj. Prandaj, duke qenë të vetëdijshëm për këto përgjegjësi, duhet të bëhemi prej atyre që dhurojnë dhe bëjnë shumë bamirësi.

Si përfundim, një besimtar bamirës, është njeri altruist. Është një njeri, i cili e di shumë mirë se arritja e shpëtimit të tij varet prej përpjekjeve që bëhen për shpëtimin e të tjerëve. Kjo, sepse Allahu Teala e refuzon tipin e njeriut egoist, që mendon vetëm për veten dhe është koprrac. Në bazë të kësaj, nuk duhet të harrojmë se llogarinë për përgjegjësinë që kemi, do të mund ta japim lehtë, aq sa edhe e ndjejmë në supet tona përgjegjësinë për të tjerët.

Zoti ynë na bëftë prej atyre që përpiqen dhe punojnë për fenë. Ndërsa dhurimin e bamirësinë që bëhet brenda kritereve të edukatës, duke shpresuar vetëm kënaqësinë hyjnore, e bëftë thesar të qetësisë dhe lumturisë së zemrave tona!

Amin!..



SEMI DHE BESIR

PËRGJËRIM DREJTUAR ATIJ QË DREJTON DHE SHEH ÇDO GJË

Ilir Hoxha


O Allah! Dija Jote përfshin çdo gjë. Ti dëgjon atë që nuk e dëgjon kush dhe sheh atë që nuk e sheh kush. Për Ty nuk bën dallim nëse diçka është bërë fshehtas apo hapur, nëse një mendim është thënë me pëshpëritje apo me zë të lartë, e madje edhe nëse ai mendim nuk shprehet me fjalë, por ngelet përbrenda. Për Ty nuk përbëjnë asnjë pengesë gjërat që janë pengesë për shikimin dhe dëgjimin tonë, si errësira-drita, afërsia-largësia, madhësia-vogëlsia, etj... E fshehta dhe e hapura, e folura dhe heshtja janë të njëjta për Ty. Ti sheh edhe milingonën që lëviz mbi një gurë të zi në një natë të errët dhe ujin i cili përziejhet me një ujë tjetër. Fakti që unë e di se Ti je i tillë, më jep paqe e qetësi, për aq kohë sa nuk bëj gjëra që duhen fshehur dhe prej të cilave duhet të kem turp. Këtë paqe e ndjej vetëm nëse kam jetuar i pastër aq sa për të hapur duart dhe me përlulje të strehohem tek emrat e Tu të bukur Semi dhe Basir. Unë e di se Ti sheh, dëgjon dhe regjistron çdo gjë që më është bërë mua dhe që nuk kam mundur ta pengoj.

Mirëpo, kur edhe unë bëj gjëra të pahijshme për t'u dëgjuar apo shikuar, atëherë fakti që Tij je Semi dhe Basir, kam frikë se është një kërcënim për mua. Çfarë do të bëja unë nëse nuk do të ishte tërësia e emrave të Tu, që plotësojnë njëri-tjetrin? Pra, çfarë do të bëja unë nëse në këtë situatë nuk do të strehohesha tek emrat e Tu Tevvab, Gaffar dhe Afuvv? Si do të jetoja me turpin e punëve të mia të shëmtuara që nuk mund të dalin para Teje?

Ti, Veten Tënde e ke cilësuar si "Semiu'd-Dua

/ Dëgjuesi i lutjeve". (shih. Al-i Imran, 38.) Ti na ke njoftuar se dëgjon çdo përgjërimit tonin që të drejtohet. (Shih. Bekare, 186.) Kur bëhet fjalë për Ty, "dëgjimi" zhvishet nga e zakonshmja. Atë që dëgjon Ti, e kupton dhe nuk e lë pa përgjigje, sepse Ti, edhe pse ne jemi robër me të meta, na ke urdhëruar që të mos të neglizhojmë asnjë përgjërimit që vjen në veshin tonë. (shih. Duha, 10.) O Ti që mban në duar çelësat e qiejve e të tokës! (shih. Shuara, 12.) Ti na ke bërë të ditur se i dëgjon lutjet tona. A nuk do të thotë kjo se Ti i pranon ato? (shih. Muxhadele, 1.) Për këtë shkak edhe ne kemi mësuar nga Profeti ynë (a.s.), të mbarojmë çdo lutje tonën me këtë fjali: "O Allah! Ti dëgjon çdo dua!" Me këtë fjali e kanë mbaruar lutjen edhe profetët në Librin Tënd. Prandaj edhe ne kemi mësuar se emri Yt Semi, është shkak i pranimit të duave tona. (shih. Al-i Imran, 38; Ibrahim, 39.)

Profeti ynë (a.s.), na ka mësuar që saherë të jemi para Teje, të fillojmë me falënderim. Çdo rekat të namazit e fillojmë me falënderim dhe pasi e kemi përsëritur fjalën Tënde, përkulemi me nderim. Dhe kur ngrihem nga rukuja, themi "Semiallahu li men hamideh / Allahu dëgjon atë që falënderon", si një myzhde për ne. Kur e themi këtë fjali, në fakt kemi thënë, "Allahu e pranon adhurimin e atij që e falënderon dhe e lavdëron Atë". Pra dijetarët tanë na thonë se nëse Ti e dëgjon një përgjërimit, do të thotë se Ti e ke pranuar atë. Kështu e dimë dhe kështu besojmë edhe ne, sepse edhe Profeti ynë (a.s.), fjalën "semi" në lutjet e veta e ka përdorur në kuptimin "të pra-



nosh”: “O Allah! Strehohem tek Ty prej zemrës që nuk drithërohet, prej duasë që nuk pranohet (dëgjohet), prej egos së pangopur dhe dijes së padobishme!” (shih. Tirmidhi, Deauat, 68.)

Kur na prezanton Vetën në Librin Tënd, pranë emrit Semi, qëndron ose emri Basir, ose emri Alim. Të jem në prezencë të Zoti tim që gjithmonë më dëgjon, më sheh dhe më njeh në mënyrë të përsosur, të di që çdo punë e bëj në prezencë të Tij dhe të jem gjithmonë i vetëdijshëm për këtë, siç na ka mësuar edhe Profeti Yt (a.s.), është mënyra për të arritur “gradën e mirësisë”. Ai që e di se Ti sheh gjithçka, do të përpiqet të korrigjojë çdo gjendje të tij, të hapur apo të fshehtë. E në këtë mënyrë do të rritet grada e myslimanit. E në fakt, kur njeriu silltet në mënyrë të hijshme para Allahut, ai vendoset në qoshe pranë Tij. O Zoti im! Nëse Ti do manifestohesh tek ne me këto emra, shikimi ynë do të zgjerohej dhe tashmë nuk do të shihnim vetëm atë që shihet me sy, por edhe atë që shihet me zemër. Nuk do të dëgjonim vetëm atë që thërret, por edhe atë që lëshon britma të heshtura. Po ashtu, do t’i dëgjonim e do t’i kuptonim bukur e mirë edhe njerëzit që na ke lënë amanet.

O Zot! Ne kemi nevojë të shohim e të dëgjojmë drejtë edhe për të vendosur në vend drejtësinë që pret prej nesh, edhe për treguar mëshirën dhe dhembshurinë tonë! O Zot! Na e mpreh shikimin dhe na e forco dëgjimin, me qëllim që t’i vlerësojmë të gjithë ashtu siç duhet. Në këtë mënyrë, ajo që dimë, nuk do të mbështet në pandehma por në të vërteta dhe çdo njeri do ta vendosim në vendin e duhur. Me këtë dëgjim dhe shikim, do t’u bëheshim shërim atyre që vuajnë, do të

shihnim e do të dëgjonim bukuritë e fshehura dhe do të kënaqeshim me to!

O Zot! Ti na premtove se nëse ne do të afrohem me Ty me adhurim dhe devotshmëri, do të bëheshe syri ynë që sheh, dora jonë që mban dhe këmba jonë që ecën. Nëse bëhemi të tillë, kushedi se çfarë do të shohim e do të dëgjojmë!? Kushedi se sa mirësi na iki prej duarve për shkak të shikimeve tona të ndotura me gjynah. (shih. Jasin, 9.) Kushedi se sa robër të Tu të dashur nuk arrijmë t’i shohim e t’i njohim vetëm për shkak të shikimit tonë të ndotur. Nëse e ruajmë syrin dhe veshin tonë nga gjërat e palejueshme, do të fitojmë dashurinë Tëndë dhe, nëse e fitojmë atë, do të mund t’i përdorim siç duhet këto shqisa. Na e bëj të mundur o Zot!

Për shkak se ai na ndriçon që ne të shohim të vërtetat, Ti i quajte “*besair*” ajetet e Librit Tënd. (shih. A’raf, 203.) Ndërsa ata që nuk e përlyejnë veten me gjynahe dhe ndjenja egoiste, por veprojnë me dritën e mendjes dhe të besimit, e i shohin të vërtetat e kësaj bote dhe të botës tjetër në mënyrë të hapur. E për këtë arsye, Ti i cilësove ata si “*ulu’l-ebzar*”. (Al-i Imran, 13.)

O Zot! Na ndriço edhe neve me ajetet e Tua dhe na bëj prej atyre që e kanë të hapur syrin e zemrës dhe të cilët Ti i ke lavdëruar në Librin Tënd! Ashtu si në të gjitha mirësitë e Tua, edhe në këtë mirësi, çdo rob ka pjesë të ndryshme. Por Ti na e shtoi pjesën tonë o Zot! Dhe kur të fillojmë të shohim me syrin e zemrës, mos na lër të harrojmë kurrë se të vërtetën absolute nuk mund ta mësojmë prej askujt tjetër përveçse prej Teje!

Dashuria për fenë

Ferit Piku

Allahu (xh.sh) u drejtohet besimtarëve në shumë ajete kuranore, u drejtohet atyre që kanë besim në zemra, duke iu thënë: **“O ju që besuat, ç’është me ju, që kur ju thuhet: “Dilni në (luftë) rrugën e Allahut!”, ju u rënduat në vend** (si të ishit të gozhduar). **A mos ishit më të kënaqur me jetën e kësaj bote, sesa me atë të ardhmen? Përjetimi i jetës së kësaj bote ndaj asaj të ardhmes, nuk është asgjë”.** (Teube: 38).

Asnjë individ nuk mund të ketë sukses në aktivitetin e tij, pa plotësuar dy kushte:

1- Të jetë i bindur me punën që po bën, pra të jetë i bindur që kjo punë është e hajrit dhe duhet bërë.

2- Ta dojë atë punë, të ketë pasion për të.

Biznesmeni nuk ka sukses, kur ai nuk do biznesin e tij, kur nuk përpiqet që ky biznes t’i sjellë fitime.

Gjithashtu edhe mësuesi nuk ka sukses me nxënësit e tij, kur ai nuk e do profesionin e tij.

Po ashtu asnjë lëvizje, asnjë parti nuk ka sukses, kur vetë kryetari i partisë nuk e do projektin e tij dhe nuk beson, që kjo punë që po bën, është diçka e mirë.

E njëjta gjë ndodh edhe me prindërit. As burri

dhe as gruaja nuk mund të krijojnë familje, kur s’duan fëmijët e tyre, kur s’duan jetën bashkëshortore. Atëherë kur secili prind e merr jeten si përrallë, kjo familje nuk mund të rrisë e të edukojë fëmijë të denjë për shoqërinë.

Pra për të pasur sukses në çdo gjë, kushti i parë është të bindesh për punën që po bën dhe e dyta është ta duash punën dhe të kesh pasion për të. Thonë se aktivitetet më të suksesshme janë ata aktivitete, iniciatori i të cilave i sheh edhe në ëndërr. Atij i del në ëndërr biznesi apo profesioni i tij, për arsye se ai është gjithmonë i shqetësuar për të.

A e duam ne Islamin? A kemi dashuri për fenë tonë? A e duam këtë fe nga thellësia e zemrës tonë? Këto pyetje mund të kenë dy lloj përgjigjesh: Të lehtë dhe të rëndë.

1- Përgjigja e lehtë mund të jetë: “Përderisa unë kam ardhur në xhami dhe fal namazin, atëherë e dua fenë”.

2- Përgjigja e vështirë vjen atëherë kur e pyet sinqerisht veten tënde: “A e dua unë me të vërtetë këtë fe”?

Fjala **dashuri** nuk është fjalë që del nga goja, por ajo duhet të dalë nga zemra, sepse me atë dashuri lëviz gjaku. Pikërisht rreth kësaj pyetje duam të flasim sot: “A e duam fenë e Zotit?”

Kjo është një pyetje madhështore. Le ta pyesim të gjithë së bashku veten tonë: “A e duam me të vërtetë fenë e Allahut (xh.sh), a kemi dashuri për të?”

A e ndjejmë se dhuntia më e madhe që na ka dhënë Zoti, është Islami?! A e quajmë veten të privilegjuar, për faktin se Zoti na zgjodhi nga të gjithë njerëzit e tjerë, apo e ndjejmë se rastësisht edhe ne u bashkuam me të tjerët?! A e ndjejmë me sinqeritet, se kapitali më i madh që kemi është kjo fe, të pasur apo të varfër qofshim?!

A e ndjen këtë pasaniku milioner, i cili kur e krahason gjithë këtë pasuri me dhuntinë më të madhe që i ka dhënë Zoti, duke e bërë besimtar, nuk i hyjnë fare në sy këto miliona?! A e ndjen këtë i varfri, të cilin Zoti e ka sprovuar me mungesë pasurie, por kur kujton se Zoti i ka dhënë Islamit, nuk i hyn në sy fukarallëku?! A thotë ai: “Falenderimi i takon Zotit, i Cili më ka bërë besimtar dhe më ka zgjedhur nga të tjerët”.

Cilën nga sprovat do të zgjidhnim:

- a) Të hyjmë në zjarr apo
- b) Të lemë fenë?

Besimtari duhet të pranojë të parën. Ai zgjedh të hyjë edhe në zjarr, por nuk heq dorë prej Islamit. Besimtari ndjek shembullin e Ibrahimit (a.s), i cili pranoi të hyjë në zjarr. Po pse vallë, mos ishte budalla që pranoi të hyjë në zjarr? Ai zgjodhi zjarrin, sepse e donte fenë dhe nuk hiqte dorë kurrë prej saj.

Ta duash Islamit, do të thotë të shqetësohesh për të, të të dhembë zemra për këtë fe. Kur te biesh në gjumë, pyete veten: “O Zot çfarë bëra unë sot për fenë Tënde?” Ndërsa kur të zgjohesh në mëngjes, pyete veten: “O Zot çfarë do të bëj unë për fenë Tënde, çfarë do të bëj unë për Islamit?” Kjo është feja jonë, këtu është e ardhmja jonë, por është edhe e tashmja jonë.

Kurani tregon historinë e një ftuesi të mirëfilltë, që nuk ishte as profet, as besimtar, as burrë, as grua e as mbret. Ai ishte nje zog, pupëza, i quajtur Hud-Hud. Ky zog kishte shqetësim për fenë e Zotit, i dhimbte zemra për këtë fe.

Sulejmani (a.s) ishte mbret dhe profet. Në ushtrinë e tij bënin pjesë njerëzit, xhindet, kafshët dhe zogjtë. Një ditë Sulejmani (a.s) nuk e gjen pupëzën në rresht si ditët e tjera dhe vendos që ta dënojë për moskorrektesën dhe për largimin pa leje. Pasi pupëza kthehet tek Sulejmani (a.s), i thotë: “Mos u nxito, sepse unë nuk dola për të bredhur e për të bërë xhiro, por kam qenë në një mision shumë të

madh. Kam parë një popull, që kishin një mbretëreshë shumë të pasur, por ata nuk adhuronin Zotin, ata adhuronin diellin”.

Sulejmani (a.s) jetonte në Palestinë. Pupëza kishte shkuar në Jemen me mijëra kilometra larg. Po pse vallë? Sepse këtij zogu që është ushtar i Zotit, i kishte bërë shumë përshtypje fakti, që një popull i tërë nuk adhuron Zotin. Ai mendonte me vete: “Si nuk po e adhurojnë Zotin, i Cili di të fshehtën në qiej dhe në tokë, i Cili di atë që njerëzit e thonë haptas dhe atë që ata kanë në zemër, i Cili është Zot i qiejve dhe i tokës?”

Këtij zogu nuk i bëri habi pasuria e atij populli, por fakti që ata nuk besonin Zotin. Ky është shembulli i një ftuesi, shembulli i një krijese që ka shqetësim për fenë e Zotit. Po ne a e kemi shqetësimin e këtij zogu?

Gjithmonë duhet të pyesim veten tonë: “Çfarë bëjnë njerëzit që rrinë pranë nesh, si jetojnë komshinjtë tanë, çfarë dinë për Zotin?” Po familjet tona, shoqëritë tona ku jetojmë, çfarë dinë për Zotin? Çfarë mund t’iu themi që t’i afrojmë tek Allahu (xh.sh). Kjo është të kesh shqetësim për fenë e Zotit, kjo është dashuria për fenë.

Ne të gjithë e dëgjojmë ezanin, madje një pjesë e madhe e thërrasin atë, por pak prej nesh e dinë se si ka ardhur ezani. Ezani nuk ka ardhur as me ajet kuranor e as me hadith profetik, por ka ardhur me shqetësimin e disa besimtarëve. Kur muslimanët shkuan në Medinë, filluan të pyesin njëri – tjetrin: “Ne po falemi, po si t’ia bëjmë për t’i thirrur njerëzit në namaz?”

Dikush tha: “Do t’i biem daulles”. Të tjerët nuk pranuan.

Dikush tha: “Do t’i biem këmbanës si të krishterët”. Të tjerët nuk pranuan.

Dikush tha: “Do t’i fryejmë borisë”. Përsëri nuk u pranua dhe nuk u arrit në ndonjë zgjidhje.

Atëherë të gjithë u larguan për në shtëpitë e tyre të shqetësuar. U larguan duke pyetur vetet e tyre se si do t’i thërrisnin njerëzit për në namaz. Me këtë shqetësim shkuan në shtëpi. Zoti i gjithësisë bën mrekullinë. Tre prej këtyre njerëzve që kishin shqetësim në zemrat e tyre, iu doli ezani në ëndërr, i njëjti ezan që thërrasim ne sot, me të njëjtat fjalë.

Po kur të del diçka në ëndërr?

Në ëndërr na dalin paratë, kur kemi nevojë për para apo jo? Na del makina, kur gjithë ditën e kemi mendjen tek makina, na del me ngjyrën, me formën dhe me modelin e saj. Pra na dalin në ëndërr ato gjëra, për të cilat jemi gjithmonë të shqetësuar.

Këtyre njerëzve iu doli në ëndërr ezani, sepse

kishin shqetësim për të thirrur njerëzit për namaz. Të nesërmen shkuan të tre tek profeti (a.s) dhe pasi i treguan çfarë kishin parë, ai (a.s) tha: **“Me të vërtetë kjo është thirrja, që do të përdorim ne”**.¹ Pra, e miratoi pejgamberi (a.s), e miratoi edhe Allahu (xh.sh). Ky është tregues, që Zoti na bën shkak për mirë, kur kemi shqetësim për këtë fe dhe kur e duam fenë tonë.

Ta duash Islamin, do të thotë ta duash të mirën, të kesh dëshirë të përhapet mirësia, bamirësia, vlera, e pastërta, të përhapet namazi, të përhapet hixhabi, të përhapen punët e mira në shoqërinë ku jeton, të kënaqesh kur shikon diçka të mirë dhe të urresh kur përhapet e keqja.

Ta duash Islamin do të thotë të të vijë shumë keq kur shikon, se ka një rritje gjithmonë më të madhe të prostitucionit, korrupsionit e tradhëtisë, ku shikon se lakuriqësia ka filluar të na mbulojë nga të katër anët. Një besimtar duhet t'i vijë keq nga të gjitha dukuritë negative, që shfaqen në shoqërinë tonë. Shkurt, tregues i dashurisë për fenë e Zotit është, kur të dhemb zemra për të keqen dhe kur të hapet kraharori për të mirën.

Profeti (a.s) tregon, se Zoti i gjithësisë i dha urdhër Xhibrilit (a.s), që ta shkatërrojë një popull. Xhibrili kthehet dhe i thotë: “O Zot, Ti më dhe urdhër, por në atë popull ishte një njeri besimtar, i cili beson tek Ti dhe të përmend shumë”. Allahu (xh.sh) i thotë: “O Xhibril! Me atë filloje shkatërrimin”.

LA ILAHE IL ALLAH!

Po përse të nisë shkatërrimi me besimtarin? “Me atë filloje – tha Zoti – sepse atij njeriu nuk i është skuqur asnjëherë fytyra, kur ka parë të keqen”. E shikonte të ligën dhe s'i bënte fare përshtypje, s'i skuqej fytyra, s'i dridhej zemra. Me atë të filloje shkatërrimin”. E ç'vlerë ka për dikë që është besimtar, kur ai nuk kënaqet për të mirën, kur nuk mërzhitet nga e keqja?!

Prandaj duhet ta masim besimin tonë, ashtu siç

masim temperaturën me termometër. A ndjejmë kënaqësi, kur përhapet e mira në familjet tona, në shoqërinë tonë, në rrugë, në punën ku jetojmë? A na vjen keq, kur përhapet e keqja? Ky është tregues i besimit dhe i dashurisë për fenë e Allahut (xh.sh).

Ta duash Islamin, do të thotë ta rrisësh nivelin e vetes tënde, sepse ti je pasqyra e Islamit. Kjo do të thotë që t'iu thuash njerëzve: “Unë jam pasqyrë e rregullt e Islamit, nuk jam pasqyrë e thyer, në të cilën del imazhi i ngatërruar apo i përmbysur”. Do të thotë që në punën ku je të të bëhet me gisht, se ti je më i miri, do te thotë që sjellja jote duhet të jetë sjellja më e mirë. Pra kur të të thuhet: “Ky është musliman”, ta meritosh të të drejtohet gishti për mirë.

Ta duash Islamin do të thotë që të paktën prej teje të mos i vijë e keqja Islamit. A e di se Islamit mund t'i vijë e keqja prej punës tonë, prej sjelljes tonë, edhe pse ne nuk e dimë. Sfida me e madhe që kanë muslimanet sot në botë, sidomos në Shqipëri është që ta rrisin nivelin e tyre. A janë të aftë të thonë: “Ne jemi muslimanë”. A jemi prej atyre burave, që kur themi: “Ne jemi muslimanë”, të tjerët të mendohen dy herë, përpara se të të thonë diçka?! Kjo është sfida jonë, është sfidë me veten tonë. Sfidë në nivelin shkencor, sfidë në sjellje, në etikë, në edukatë, në të gjitha vlerat që duhet të ketë njeriu. Sot muslimanët dinë shumë fjalë të bukura, por u mungojnë shumë vlera.

Kurse në atë kohë nuk kishte fjalë, por mjaftonte që muslimani të ecte dhe njerëzit thoshin: “Ky paska lezet, do hyjmë në fenë e këtij njeriu, se është më i mirë se ne”. Kjo është sfida jonë, prandaj le të punojmë me veten tonë.

Në qoftë se e duam Islamin, ta duam veten tonë, ta rrisim nivelin në çdo aspekt të jetës tonë. Në qoftë se je tregtar apo në çdo profesion tjetër, rrite nivelin e punës, rrite sjelljen tënde, rrite moralin dhe besnikërinë tënde. Lus Allahun të na bëjë shkak për të udhëzuar të tjerët në Islam dhe jo shkak që të tjerët të largohen prej kësaj feje.

Ta duash fenë e Zotit, do të thotë që fëmijët e tu t'i rrisësh me dashurinë për fenë. Ta mbjellësh në

TA DUASH ISLAMIN,
DO TË THOTË TA DUASH TË
MIRËN, TË KESH DËSHIRË TË
PËRHAPET MIRËSIA, BAMIRËSIA,
VLERA, E PASTËRTA, TË
PËRHAPET NAMAZI, TË PËRHAPET
HIXHABI, TË PËRHAPEN PUNËT E
MIRA NË SHOQËRINË KU JETON,
TË KËNAQESH KUR SHIKON
DIÇKA TË MIRË DHE TË URRESH
KUR PËRHAPET E KEQJA.

1. **Hadith i pranuar.** Ebu Daudi (499), Tirmidhiu (187) dhe Ibn Maxheh (706). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të pranuar.

zemrën e tyre dashurinë për fenë, sic mbjell bimën në tokë.

Kjo do të thotë, që kur të martohesh, të martohesh me nijetin që të kesh fëmijë që duan Allahun (xh.sh), fëmijë që duan Islamin, do të thotë që ti të jesh shembulli më i mirë për fëmijët e tu. Nuk mjafton që thjesht ta marrësh fëmijën në namaz, t'i tregosh për fenë e për Zotin e kur të vijë një moment në shtëpi ti të kalosh cakun e të nevríkosesh, sepse fëmija e regjistron prej teje këtë sjellje.

Është detyre e madhe ta rrisësh fëmijën me dashurinë për Zotin, t'i fusësh në zemrën e tij dashurinë për Allahun (xh.sh), që ai ta dojë këtë fe. Kjo është puna më e madhe që mund të bëjmë me fëmijët tanë dhe me familjet tona.

Ta duash Islamin, do të thotë që aftësitë që na ka dhënë Allahu (xh.sh), t'i vëmë në shërbim të tij. Zoti i ka ndarë gjërat siç ka ndarë edhe rrizkun. Dikujt i jep pasurinë, dikujt forcën, dikujt fjalën, dikujt penën e kështu me rradhë.

Nëse Zoti të ka dhënë **pasuri**, mos e shpenzo kot atë. Ajo është pasuria e Zotit, i Cili ta ka dhënë ty amanet, por ti nuk e kupton kënë gjë. Pyete veten tënde edhe në qoftë se je pasanik: “Pse e bleva këtë gjë? A më duhej a s’më duhej? Pse me këto para nuk bëj diçka që është më e hajrit?”

Nëse Zoti të ka dhënë **forcë**, ku e përdor këtë forcë? A e përdor për mirë apo për keq? A jep edhe ti kontributin tënd, për të mbajtur sadopak peshën e Islamit?

Nëse Zoti të ka dhënë **aftësi** e logjikë, përdore mirë atë. Merresh me fjalë lart e poshtë gjithë ditën, apo mundohesh që me logjikën tënde të ndash të drejtën nga e gabuara?

Nëse Zoti të ka dhënë **fjalën**, fol mirë, fto për mirë, mundohu që me fjalët e tua të ndikosh për mirë tek njerëzit.

Nëse Zoti të ka dhënë **penën**, shkruaj drejt dhe qartë, përdore këtë penë për hir të Zotit dhe bëji të ditura me të argumentet e Zotit.

Halid Ibn Velidi (r.a) ishte ushtarak i shkëlqyer, që nuk kishte të krahësuar, i cili para Islamit i mundonte shumë muslimanët, sa që kur dëgjohej që ai ishte komandanti i ushtrisë tjetër, njerëzit kishin frikë. Kur u bë musliman, shkoi tek peygamberi (a.s), i dorëzoi shpatën dhe i tha: “O profet i Zotit! Unë jam dorëzuar, prandaj merre shpatën time. Pëndo hem që me këtë shpatë kam vvarë njerëz dhe nuk do ta përdor më”. Profeti (a.s) i tha: “**O Halid, siç e përdore këtë shpatë kundër muslimanëve,**

sot e tutje përdore për muslimanët, përdore për Zotin, kështu është pendimi yt. Aftësite e tua vëri në shërbim të Zotit, në shërbim të fesë”.² Pas kësaj Halid Ibn Velidi u quajt **shpata e Zotit**. Me të vërtetë ai i përdori aftësitë e tij për hir të Allahut (xh.sh), për hir të kësaj feje.

Sikur ta donim me të vërtetë këtë fe, a do të bënim fjalë nëse falim pesë namaze apo falim tre namaze?! Do ishte turp. A do të pyeste njeri veten, nëse duhej ta pinte një gotë apo jo?! Do ishte turp. A vërtet do të diskutonim, nëse duhet t'i japim 500 lek sadaka apo jo?! Prapë do ishte turp.

Nëse e do fenë e Zotit, duhet të të vijë turp, kur i bën vetes këto pyetje. Ta duash këtë fe, do të thotë që obligimet nuk janë barrë, por janë kënaqësi.

Profeti (a.s) i thoshte Bilalit: “**O Bilal thërrite ezanin, na qetëso zemrat**”.³ Nuk thoshte: “Thërrite ezanin e ta falim këtë namaz, se e kemi borxh para Zotit”. Çfarë borxhi! Të kënaqesh kur ta bësh këtë punë! Në qoftë se e kemi pasion fenë tonë, ke për ta parë vëlla dhe motër e nderuar, se nuk do të të bëjë përshtypje asgjë në rrugë të Zotit, asnjë punë sado e vështirë qoftë.

Por në qoftë se nuk e ke pasion këtë fe, do të të rëndohet çdo ditë dalëngadalë, sa që do të vijë një kohë e do të thuash: “Unë nuk e mbaj dot fenë e Zotit”.

Do nisësh të thuash: “Vallahi se le dot rakinë, vallahi se fal dot namazin, vallahi nuk kam kohë”. Kur nuk e do një punë, do të gësh justifikime që të mos e bësh atë.

Tregohet se një njeri e pyet profetin (a.s), se kur do të bëhet Kijameti. Profeti (a.s) e pyeti: “**E çfarë ke përgatitur ti për atë ditë**”? Ai përgjigjet: “Pasha Zotin unë nuk kam bërë ndonjë punë të madhe, por unë e dua Allahun dhe të dua edhe ty”. Atëherë profeti (a.s) i tha: “**Ti do të jesh me ata që i do**”.⁴ Atë ditë sahabët u gëzuan shumë, sepse thanë: “Ne e duam shumë profetin (a.s), e duam Zotin, e duam dhe Islamin”.

Prandaj e lus Allahun (xh.sh) të fusë në zemrat tona dashurinë për madhësitin e Tij, dashurinë për fenë e Tij dhe dashurinë për Profetin e Tij. E lus Allahun ta bëjë këtë fe të dashur në zemrat tona, të dashur në shtëpitë tona, të dashur në shoqërinë tonë. E lus Allahun të mos e bëjë këtë fe barrë të rëndë, por lehtësim për ne në këtë jetë, lehtësim

2. **Tabekatu Ibn Sad.**

3. **Hadith i vërtetë.** Ebu Daudi (4985, 4986). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të vërtetë.

4. **Hadith i vërtetë.** Buhari (57126) dhe Muslimi (2640).

në varret tona dhe lehtësim kur të dalim përpara Allahut (xh.sh).

Ta duash këtë fe, do të thotë ta duash vëllain që ke në krah, ta duash çdo musliman, do të thotë t'i lutesh Zotit, që t'i afrojnë zemrat tona. O Zot mos na bëj nga ata njerëz, që shikojnë një gabim të vogël tek vëllai i tyre dhe nuk shikojnë pemën e mëkatit, që është përpara syve të tyre, tek vetet e tyre. Pra le t'i afrojmë zemrat tona, t'i japim dorën njëri – tjetrit, të bashkohemi se nuk jemi shumë, por jemi pak.

Të gjithë ne e dimë, se çfarë shkruhet në gazetat e përditshme për ne, për gjithë muslimanët, e dimë se çfarë flitet në televizionet tona. Të gjithëve na dhemb zemra, por pjesa më e madhe e jona vetëm sa bën një debat të ftohtë se kush e ka mirë dhe kush e ka keq.

Për mua kjo nuk ka asnjë vlerë. Dihet që Zoti i ka sprovuar besimtarët, madje sahabët e profetit (a.s) i ka sprovuar me luftë, por ata kanë ditur të pozicionohen. Ata iu drejtuan Zotit: “O Zot mos na sprovo, o Zot bashkoji zemrat tona, o Zot mos fut përçarje në zemrat tona”.

Nese Zoti fut përçarje në zemra, nuk ka gjë që të nxjerr në dritë. Lusim Zotin të mos e fusë shejtanin mes nesh dhe vëllezërve tanë”. Unë dua ta pyes veten time, t’iu pyes edhe juve: “Kush prej nesh e ka lënë debatin dhe është veçuar 5 minuta, për t’iu drejtuar Zotit të gjithësisë e t’i lutet Atij: “O Zot mos na përçaj, mos na bëj sprovë për ata që nuk besojnë”.

A e dini se çfarë thonë njerëzit?

“Shiko se kush janë muslimanët, përditë bëjnë debate dhe përçahen”. Kjo është sprova për të tjerët. Ateisti, laiku, ai që nuk ka vlera, thotë: “Më mirë që nuk jam musliman, shyqyr që nuk jam musliman”. Kjo është sprovë për ne.

Kush prej nesh i lutet Zotit, të na udhëzojë neve, t’i udhëzojë të parët tanë, t’i forcojë ata, t’i drejtojë nga e mira, t’i largojë nga a keqja. Ky është obligimi më i paktë që duhet të kemi. Na duket vetja se jemi shumë, por jemi shumë pak dhe kjo është e dukshme, pasi nuk kemi forcë të ndryshojmë shumë gjëra. Por ama kemi një armë të fuqishme, e cila

është duaja (lutja), prandaj le ta lusim Zotin për vete dhe për njëri – tjetrin.

Ne s’jemi nga ata njerëz, që janë thjesht njerëz me logjikë të ftohtë, që analizojnë vetëm kush e ka mirë dhe kush e ka keq, por jemi nga ata njerëz, që i luten Zotit. E mira e tjetrit është edhe e mira ime, e keqja e tjetrit është edhe e keqja ime. Ne nuk mund të ndahemi. Muslimanët janë të gjithë një umet dhe duhet të jenë gjithmone bashkë.

Do të tregoj vetëm shembullin e profetit Muhamed (a.s). Në betejen e parë, në Bedër numri i besimtarëve ishte 314, përballë 1000 apo edhe më shumë jobesimtarëve. Profeti i Zotit doli në një qoshe dhe filloi të përgjërohet e të qajë, duke e lutur Allahun (xh.sh). Aq shumë iu drejtua Zotit, duke ngritur duart drejt qiellit, sa që i ra dhe pelerina nga shpina. Shokët kur e panë, u erdhi shumë keq dhe i thanë: “O Profet i Zotit, aman mos e munda kaq shumë veten, ka për të të ndihmuar Allahu (xh.sh), po nuk të ndihmoi ty, kë do të ndihmojë?” Kurse ai thoshte:

“**O Zot, po u shkatërrua ky grup muslimanësh që janë sot, nuk do të adhurohesh më në tokë, s’do të ketë më besimtarë që do të të adhurojnë**”.⁵ Kjo ishte ndjenja e peygamberit (a.s) dhe kjo duhet të jetë edhe ndjenja jonë. Prandaj unë ftoj veten time dhe çdo musliman që të jemi të sinqertë me Allahun (xh.sh) dhe me fenë e Tij. E kemi obligim që ta lusim Zotin: “O Zot bashkoji zemrat tona, mos fut përçarje mes nesh, na forco e mos na dobëso, na lartëso neve dhe të parët tanë dhe mos na rrëzo”.

E lus Allahun (xh.sh) të na bëjë njerëz të punës dhe jo njerëz të debatit. E lus Allahun t’i bashkojë zemrat tona me fjalën “La ilahe il Allah, Muhamed Resulullah”. Allahu e lartësoftë Islamit dhe muslimanët kudo që janë. Allahu na mundësoftë të jemi pjesë e fitores dhe triumfit të fesë së Tij e Allahu do t’i japë sukses fesë së Tij, Ai është i fuqishëm për cdo gjë.

Falenderimet janë vetëm për Allahun, Zotin e botëve.

Amin!..

5. **Hadith i vërtetë.** Muslimi (1763).



Konservatorizmi II

— Murat M. Aliu —

Konservatorizmi si një ideologji politike apo si një stil-mënyrë e të menduarit në esencë ka lindur si reaktion ndaj ndryshimeve radikale në të gjitha sferat e jetës që përfshinë Evropën e pas lindjes së modernitetit. Konservatorizmi në një masë të madhe kundërshton transformimet dhe ndryshimet radikale të cilët në një farë mënyre kanë tëhuajësuar individin nga natyra e tij e vërtetë. Thënë shkurtë konservatorizmi refuzon të gjitha ndryshimet revolucionale të cilat shkatërrojnë të gjitha strukturat tradicionale dhe mohojnë vlerat dhe moralin e këtyre strukturave. Në këtë kontekst konservatorizmi gjatë zhvillimit të tij historik ka zhvilluar dhe kultivuar parimet dhe vlerat e tij themelore, të cilët sot paraqesin element konstituiv të kësaj ideologjie politike. Familja, tradita, prona private, religjioni, shoqëria, shteti, autoriteti, historia etj., paraqesin elementet konstituive apo parimet themelore konservatorizmit.

Por për dallim nga parimet e liberalizmit të ngërthejnë një dimension universal në kohë dhe hapësirë, parimet e konservatorizmit shpesh herë dallojnë nga njëri tjetri, varsisht nga kultura, tradita, historia apo karakteri i një shoqërie të caktuar. Kështu për shembull nëse koncepti i civilizimit përbën një rëndësi ndër shtyllat kryesore për konservatorizmin turk, i njëjti koncept mund të mos jetë pjesë e parimeve të konservatorizmit në vendet Perëndimore. Apo nëse në një shoqëri perëndimore parimi i autoritetit mund të posedojë një natyrë më liberale, i njëjti parim ta zëmë në Iran apo në ndonjë vend tjetër të Lindjes mund të interpretohet në mënyrë tjetër.

Sidoqoftë, në vazhdim do të mundohemi në mënyrë më të përgjithësuar t'i analizojmë dhe elaborojmë vetëm disa prej parimeve të konservatorizmit, të cilët në të njëjtën kohë janë parimet më të rëndësishme të tij.

FAMILJA

Familja si një institucion shoqërorë që nga fillimi deri më sot ka pasur detyra dhe obligime të ndryshme sociale. Ashtu si institucionet tjera shoqërore, familja, përveç funksioneve biologjike, psikologjike, ekonomike, sociologjike, religjioze ka pasur një rol të rëndësishëm në përcjelljen e vlerave morale e tradicionale nga një gjeneratë në tjetrën. Por, me lindjen e modernitetit, procesin e modernizmit dhe konceptet tjera moderne, si individualizmi dhe familja bërthamë roli i familjes në edukimin dhe përcjelljen e vlerave tradicionale është minuar dhe marginalizuar. Në këtë periudhë (moderne) ka filluar partikularizmi dhe fragmentarizmi i strukturave të gjëra të familjes tradicionale, dhe familja tradicionale është transformuar në atë që sot quhet familja bërthamë. Madje në periudhën postmoderne, familja si një institucion social akoma më shumë po atomizohet dhe kësaj shtet flitet për konceptin “një familje një individ”. Paralelisht me këtë situatë hasim edhe në ndryshimin e vlerave morale, traditave dhe zakoneve.

Transformimet dhe ndryshimet në institucionin e familjes, vërtetë sot paraqesin një rëndësi ndër problematikat që më së shumti shqetëson konservatorët. Sepse, sipas konservatorizmit familja është një institucion vital për ruajtjen e vlerave tradicionale

dhe morale në një shoqëri të caktuar. Njëri ndër mendimtarët më të mëdhenj konservatorë dhe njëherit edhe themeluesi i konservatorizmit francez, Bonald, mendon se molekula e shoqërisë nuk është individi, por familja. Sipas tij familja është institucioni më i vjetër dhe më i suksesshëm i edukimit shoqërorë. Ai në mënyrë të qartë tërheq një paralel ndërmjet institucionit të familjes dhe monarkisë; ku në rolin e mbretit është babai, ndërsa qytetarët janë fëmijët dhe anëtarët tjerë të familjes (Bottomore ve Nisbet, 1990: 110).

Sipas një mendimtari tjetër konservator, Thomas Fleming, familja paraqet një institucion shoqërorë që vendos themelet për një shoqëri të lirë. Reliashat fondamenti epistemologjik i konservatorizmit në Evropë gjendet në vlerat e krishterimit mbi konceptin e individit dhe botës. Konservatorët (të krishterë) për shkak të besimit në “mëkatën e parë” janë skeptik ndaj potencialit të individit dhe si rrjedhojë ata lartësojnë familjen dhe shoqërinë. Sepse shoqëria dhe familja janë atë të cilët individit i mveshin një identitet të caktuar. Me që individi nga natyra është një qenie e pamjaftueshme dhe e dobët, ai ndjen nevojë për “udhëzime institucionale” për të bërë gjykimin e drejtë ndërmjet të mirës dhe të ligës, mendon Fleming (Fleming, 1990: 13). Edhe babai i mendimit konservator, filozofi britanik, Burke, mendon se dashuria dhe lidhshmëria për familjen është një fenomen natyrorë dhe në përputhshmëri me natyrën e njeriut.

Konservatorizmi familjen e sheh si njësinë themelore shoqërore, por edhe si gardian që ruan dhe mbron vlera morale e tradicionale. Familja është ajo që mban të unifikuar shoqërinë dhe përforcon këtë unifikim ndërshoqëror. Në të njëjtën kohë familja pengon atomizimin dhe fragmentarizmin e shoqërisë, siguron dhe kultivon ndjenjën e solidaritetit dhe përfundimisht familja luan rolin e institucionit më të rëndësishëm edukativ në shoqëri. Familja po ashtu përforcon ndjenjën e përkatësisë shoqërore ndër individët. Në këtë drejtim është edhe klasifikimi i sociologut amerikan Talcot Parsons i cili numëron tre funksione themelore të institucionit familje: “vazhdimësinë e gjeneratave”, “rehabilitimin social”, dhe “socializimin”.

Duke pasur parasysh rëndësinë e familjes në mendimin konservator, sot, si pasojë e efekteve të modernitetit dhe post-modernitetit njëra ndër sfidat më të mëdha dhe njëkohësisht njëra ndër çështjet më problematike për konservatorët është minimizimi dhe marginalizimi i rolit të familjes në shoqëri. Dhe me të vërtete në periudhën post-moderne, familja si një institucion shoqërorë përballet me problemin ontologjik, në kuptimin se rrezikohet ekzistenca e saj. Martesat të së njëjtës gjini, fenomeni i abortit dhe individualizmi ekstrem sot janë ndër temat

më të debatuar në koluaret konservatore, sepse që të gjithë këto fenomene sociale dhe biologjike paraqesin një rrezik potencial për shkatërrimin e institucionit familje.

TRADITA

Në literaturën e shkencave sociale, termi “traditë” reflekton disa kuptime. Termi traditë derivohet nga shprehja *traditum* që shpreh gjithçka që është trashëguar apo përcjellë nga e kaluara në ditët e sodit. Tradita ngërthen atë që trashëgohet, besimin në individët, institucionet dhe praktikën e ndryshme. Pra, tradita ngërthen e gjithë atë që është trashëguar nga e kaluara në ditët e sodit si në rrafshin teorik ashtu edhe në rrafshin material-praktik (Shils, 2003: 110).

Konservatorët traditën e konceptojnë si një lloj burimi i dijes apo njohjes. Nga këndvështrimi konservator tradita paraqet një akumulim i përvojës përgjatë një periudhe të caktuar historike. Sipas tyre institucionet dhe normat tradicionale paraqesin akumulimin e përvojës historike të një shoqërie të caktuar. Ndërsa thellësia dhe gjerësia e kësaj njohje dhe dije është e pamundur të konceptohet nëpërmjet arsyes spekulative të një individi. Nga këtu vërejmë negacionin dhe kundërshtinë e konservatorëve ndaj liberalizmit dhe parimeve liberale. Për dallim nga konservatorizmi, liberalizmi shpërfill traditën dhe gjithçka çka ka të bëjë me rendin e vjetër. Kështu në vend të traditës-përvojës vendos arsyen dhe në vend të shoqërisë individin. Në këtë kuptim për liberalët nuk është me rëndësi kontinuiteti historik i institucioneve sociale, por për ata me rëndësi është fakti se këta institucione a mundë ti plotësojnë nevojat dhe interesat e individëve apo jo. Nëse këta institucione nuk janë në gjendje ti plotësojnë nevojat dhe interesat e individëve atëherë këta institucione humbin edhe vlefshmërinë sociale dhe legjitimitetin politik (Heywood, 2010: 90).

Përkundër kësaj për konservatorët konceptimi i traditës është një kusht i pashmangshëm. Sipas tyre tradita ruan kontinuitetin identitar të një shoqërie të caktuar. Tradita gjithashtu përcakton ruajtjen e vazhdimësisë të mënyrë së jetesës të cilën shoqëritë e trashëgojnë nga kohërat e kaluar. Tradita individit i jep një ndjenjë të caktuar të përkatësisë dhe e ruan atë nga ndjenja e të qenit ahistorik. Pra, konservatorët traditën e konceptojnë si një burim i njohjes por e cila bazohet në përvojën kolektive dhe në këtë mënyrë kundërshtojnë parimet liberale të cilët bazohen në arsyen abstrakte dhe njohjen teorike. Tradita në konceptualizimin e ideologjisë konservatore nuk është kategori abstrakte, por kategori konkrete. Ajo është një fushë reale ku materializohet brenda institucioneve konkrete siç janë familja, institucionet fetare, universitet, si dhe brenda normave mora-

le shoqërore. “Jemi të shqetësuar nga të jetuarit e njerëzve duke marrë për bazë vetëm arsyen si një masë të vetme. Sepse ne mendojmë që racioja e çdo individit është e pamjaftueshme dhe se njerëzit në vend të arsyes duhet të përfitojnë nga kapitali dhe akumulimi të kombeve dhe periudhave” shkruante Edmund Burke (Burke, 2005: 11-12).

SHOQËRIA ORGANIKE

Ashtu siç theksuam edhe më lartë në mendimin konservatorë, shpesh herë individit llogaritet si një qenie e pamjaftueshme dhe si i tillë është një qenie e kufizuar. Sipas konservatorëve natyra e njeriut është e pandryshueshme dhe të gjitha përpjekjet për idealizimin dhe konceptimet perfeksioniste për individin i sheh vetëm si një manipulim. Sipas kësaj njeriu gjithmonë do të ngelet një qenie e dobët dhe e kufizuar dhe se asnjëherë nuk do të arrijë nivelin e perfeksionizmit. Pra kjo është qasja teologjike krishtere mbi individin.

Shikuar nga këndvështrimi i imagjinatës së shoqërisë organike, individit nuk mundë të ekzistoj jash-të shoqërisë. Individët në këtë kontekst nuk kanë zgjidhje tjetër përveç se të jenë pjesë e shoqërisë. Sipas kësaj imagjinate grupet sociale nuk lindin si rezultat i një kontrate vullnetare apo në mënyrë të vetëdijshme, përkundrazi, grupet sociale formohen në rrugë natyrore dhe spontane (Erdoğan, 2004: 7). Më fjalë tjera, shoqëria formohet si pasojë e disa proceseve të domosdoshme natyrore. Shoqëria, sipas konservatorëve, është formuar para individit dhe shoqëria është ajo që e formon personalitetin dhe karakterin e individit. Sipas imagjinimit të shoqërisë organike shoqëria në mënyrë të pavarur nga individët paraqet një organizëm i gjallë. Ashtu si organizmi i njeriut edhe shoqëria është e përbërë nga pjesët e saj, si lukthi, zemra, dhe organet tjera. Pra, pjesët e shoqërisë (individët) duhet të funksionojnë në pajtim më tërësinë (trupi) që në këtë rast është shoqëria.

Sipas konservatorëve shoqëria është si një trup që jeton dhe zhvillohet. Ndërsa pjesët më të rëndësishme të këtij organizmi janë familja, shteti, autoriteti dhe institucionet tradicionale. Me qëllim që individit të mos ngelet i vetmuar konservatorët theksojnë rëndësinë e familjes, religjioni, historisë dhe traditës. Prandaj konservatorët mohojnë pikëpamjet dhe botëkuptimin liberal se individit mundë të mbijetoj i vetëm si një qenie racionale dhe i zhveshur nga ndikimet e jashtme të shoqërisë.

RELIGJIONI

Religjioni është njëra ndër pikat kryesore në mendimin konservator. Religjioni është një institucion që përbën “shpirtin e shoqërisë” do të thoshte autori turk Omer Çaha (Çaha, s.22). Nëse autoriteti, shteti,

ekonomia dhe prona private përbëjnë trupin fizik të shoqërisë, religjioni përbën shpirtin dhe frymën e saj. Në këtë kuptim shoqëritë të cilët janë privuar nga religjioni, njëkohësisht ata janë privuar nga fryma dhe shpirti. Rëndësia e religjioni në mendimin konservator konsiston në atë se religjioni llogaritet si burim i moralit dhe vlerave shpirtërore. Gjithashtu religjioni ndikon në formimin e traditave dhe zakoneve. Por edhe përkundër kësaj, rëndësia e religjionit në mendimin konservator nuk konsiston në dimensionin metafizik të tij, por rëndësia e tij qëndron në forcën kohezive të tij për t’i unifikuar individët brenda shoqërisë. Pra, religjioni në botëkuptimin konservatorëve shihet si një instrument i rëndësishëm dhe efikas për të krijuar dhe ruajtur shoqërinë organike. Konservatorët më shumë vëmendje i kushtojnë ritualeve dhe ceremonive religjioze se sa praktikimit esencial të tij (Bora, 2012: 58). Kështu religjioni është një instrument për ruajtjen e stabilitetit dhe autoritetit shoqërorë i cili është një element i pashmangshëm i mendimit konservator. Duke u nisur nga mendimi i konservatorëve se shoqëria është si një organizëm i gjallë që jeton, atëherë ky organizëm ka edhe ndjenjat dhe besimet e tij. Sipas tyre ajo që mban shoqërinë të unifikuar janë dogmat dhe religjioni në këtë drejtim është një instrument efikas. Edmond Burke mendon që nëse nuk do të ekzistonte religjioni njeriu në asnjë rast nuk do të mund të shpëtonte nga natyra e tij egoiste dhe nga dëshirat-kërkesat e tij radikale. Edhe Bonald, mendon se religjioni është një besim. Por ai përtej kësaj religjionin e sheh si një shoqëri dhe si një komunitet. Nga këtu mundë të konstatojmë se në mendimin konservator dimensionin shekullarist dhe sociologjik është shumë më i rëndësishëm se sa dimensionin shpirtërorë dhe metafizik.

REFERENCAT

- Bottomore, Tom ve Nisbet, Robert (1990), *Sosyolojik Çözümlemenin Tarihi*, (Çev. Mete Tuncay ve Aydın Uğur), Verso Yayınları, İstanbul, 2004.
- Fleming, Thomas (1990), “The Facts of Life”, **Chronicles**, Vol. 14, No: 10, October.
- Shils, Edward, “Gelenek”, **Doğu Batı Dergisi**, 2003, Yıl: 7, Sayı: 25.
- Andrew Heywood, *Siyasi ideolojiler*, (Çev: Ahmet Kemal Bayram, Özgür Tüfekçi, Hüsamettin İnaç, Seyma Akın, Busra Kalkan), Adres Yayınları, Ankara, 2007.
- Edmund Burke, “Gelenekselcilik” (Der: Russel Kirk, Çev: Bilal Canatan), **Muhafazakar Düşünce Dergisi**, Sayı: 3, (Kis 2005).
- Erdogan, Mustafa, “Muhafazakarlık: Ana Temalar”, **Liberal Düşünce Dergisi**, Yıl: 9, Sayı: 34.
- Bora, Tanıl, *Türk Sağının Üç Hali: Milliyetçilik, Muhafazakarlık, İslamcılık, Birikim*, İstanbul, 2012.
- Çaha, Ömer, “Muhafazakar Düşüncede Toplum”, **Liberal Düşünce Dergisi**, Yıl: 9, Sayı: 34.

Dieta më ideale

TË HASH PAK

— Dr. Betyl Nefise Inall —

Të ushqyerit e shëndetshëm është marrja e lëndëve kryesore ushqyese, me qëllim që qelizat të cilat formojnë trupin tonë ta kryejnë funksionin e tyre në mënyrë të shëndetshme dhe të rregullt. Pra është marrja e yndyrave, proteinave, karbohidrateve, vitaminave dhe mineraleve në masë të mjaftueshme e të ekuilibruar. Masa e kalorive ditore që njeriu duhet të marrë ndryshon sipas moshës, gjinisë dhe punës që bën. Kaloritë që merren më tepër se nevoja ditore, bashkohen në qelizat e yndyrës në formën e lëndës me emër “**triglicerit**”. Kur indet dhjamore janë të tepërt në pjesë të panevojshme të trupit, formohet ajo që quhet “**obezitet**”. Kur vlerësohet obeziteti, zakonisht përdoret indeksi i masës trupore. Këto vlera arrihen si përpjesëtim i peshës trupore me gjatësinë. Për shembull, indeksi i masës trupore të një njeriu me peshë 65 kg dhe gjatësi 165 cm arrihet duke pjetësuar përfundimin e (165 x 165) me 65. Kjo del që është 41,88kg/m².

Sipas kësaj, ata që e kanë indeksin e masës trupore:

- 18,5kg/m², janë të dobët;
- 18,5-24,9kg/m², kanë peshë normale;
- 25-29,9kg/m², kanë mbipeshë;
- 30-39,9kg/m², janë obezë;
- 40kg/m², kanë obezitet të tepruar.

Këto vlera nuk duhet të përdoren te fëmijët, gratë shtatzëna dhe muskolorët, sepse te këta persona nuk arrihen përfundime të sakta.

PSE NJERIU SHTON NË PESHË?

Jetojmë në një botë që mundohet të modernizohet në shekullin XXI. Për shkak të zhvillimit teknologjik, shëndeti mendor dhe fizik i njeriut sa vjen e dëmtohet... Njerëzit që jetojnë në ndërtesa të larta apo në vende ku mezi e shohin qiellin, në krahasim me kohën e mëparshme, jetojnë me ritëm më të shpejtë, përballen me trafikun kur shkojnë në punë dhe kthehen në shtëpi shumë të lodhur e të stresuar. Për t'u çlodhur e qetësuar ndezin televizorin dhe kalojnë sa të një kanal të tjetri. Kur i merr uria, bëjnë një supë të gatshme për pesë minuta ose zbresin te “fast food”-i poshtë shtëpisë dhe marrin një hamburger. Nevojën e komunikimit e plotësojnë në botën virtuale duke folur me njerëz në anën tjetër të botës, por fqinjin ngjitur nuk e njohin.

Shumica e njerëzve të këtij shekulli jetojnë pa lëvizur aspak. Ushqehen sipas mënyrës amerikane, pra hanë “fast food” kur i merr uria dhe pinë kola kur i kap etja. Në një shoqëri ku aktiviteti po pakësohet si rezultat i ngrënies së tepërme dhe të pa ekuilibruar, njerëzit sa vijnë e shtojnë në peshë. Ata që hanë pa masë çfarëdo që dëshirojnë, pas një kohe fillojnë të kërkojnë rrugë për t'u dobësuar. Ndërkohë që në njërin anë të botës njerëzit vdesin

ngaqë nuk mund të gjejnë një kafshatë bukë për të ngrënë, në anën tjetër harxhohen trilionë për kurimin e sëmundjeve që dalin në pah si rezultat i ngrënies së tepërt.

Kohët e fundit në shoqërinë tonë shprehja “Ajo që është e hollë, është më e bukur”, ka bërë një presion psikologjik. Sidomos gratë, në mënyrë që të duken më elegante dhe më të bukura, e kanë vënë në rrezik shëndetin e tyre fizik dhe mendor duke zbatuar dieta të ndryshme. Disa, duke thënë “Po piva ujë, më bën dobi!”, e kalojnë jetën në dietë; disa të tjerë thonë “Nesër do të filloj dietën” dhe të sotmen e kalojnë duke ngrënë pa masë...

Nëse gabimisht syri ju shkon te ekrani, brenda pesë minutave të para do të përballlet me dhjetëra reklama që paraqesin formula dietash dhe ju do të shastiseni duke menduar se cila mund të jetë e saktë. Dietat e dobësimit, ilaçe për dobësimin, çajrat, ushqimet, uniformat dhe rripat e dobësimit, operacionet e dobësimit etj., janë të gjithë faktorë që ua shtojnë fitimet firmave shumë prej të cilave janë të papërcaktuara, nuk kanë licencë nga ministria e shëndetësisë, nuk kanë vlera shkencore dhe reklamojnë ilaçe të cilat e vënë në rrezik shëndetin. Programe që i bëjnë vazhdimisht lavazh trurit të njerëzve me ekzagjerime si: “Jepni 10 kg në muaj pa qenë të uritur” ose “Hiqni 4 kg në javë nga pesha duke ngrënë çdo gjë!”

Po përgatiten shkrime e materiale në lidhje me çështjen e dietës që bëhet pa marrë pikëpamjet e ndonjë specialisti, pa bërë ndonjë studim shkencor, me orientime të gabuara dhe në mënyrë të pavetëdijshme. Sidomos kohët e fundit po përdoren dieta që kanë efekte anësore serioze ndaj shëndetit të mendjes, trupit e shpirtit dhe që mbështeten në konsumimin e ushqimeve të tipit tek. Rezultati i dietave zvicerane me tip unik që përmbajnë sallatë, fruta, patate e qepë dhe dietave që përgatiten me program të ç’ekuilibruar, shumicën e rasteve përfundojnë në dyert e spitalit. Këto nuk janë regjim, por formula që prodhojnë sëmundje.

Këto dieta që përmbajnë një lloj ushqimi, energji të ulët, shumë karbohidrate, proteina të pamjaftueshme, pa yndyrë, me shumë mangësi në vitamina e minerale (B6, B12, kalcium, hekur, zink, fosfor, magnez), sjellin shumë dëme serioze në funksionimin e organizmit: Probleme në sekretimin e insulinës, çekuilibrimin e sheqerit në gjak, bëhen shkak për diabetin, probleme në lidhje me tretjen, të përziera, të vjella, dhimbje stomaku, gastrit, gurë në tëmth, shpërqendrimin i shpejtësisë së metabolizmit, lehtësimin në marrjen e kilogramëve të humbur, mungesën e vitaminave e mineraleve, anemi, shkujdesje, mpirje, lodhje, rënie flokësh, tension të ulët, sëmundje të zemrës dhe damarëve, sëmundje të veshkave, tretje e kockave etj.

Kur humbja e peshës shkon deri në 2-3 kg në javë, ekuilibri muskuj-dhjamë shkatërrohet duke dëmtuar muskujt dhe në këtë mënyrë digjen qelizat e muskujve në vend të qelizave të dhjamit. Dietat shokuese dhe dobësimi i menjëhershëm, mbi të gjitha dëmton muskujt e zemrës e cila është me rëndësi jetike dhe bëhen shkak për vdekje të papritur. Dietat e pavetëdijshme që mbajnë vajzat e reja në kohën e zhvillimit të tyre sjellin shumë probleme shëndetësore, duke filluar me aneminë (40%), lodhje e vazhdueshme, debulesë, depresion i zgjatur, rrahje të shpeshta zemre, ngushtim i frymëmarrjes, sëmundje e shpeshtë, çrregullim i ciklit menstrual dhe shterpësi. Prandaj duhet të qëndrohet larg dietave të pavetëdijshme dhe ilaçeve të dobësimit.

Ç’ËSHTË DIETA? SI DUHET TË JETË DIETA IDEALE?

Fjala dietë nënkupton mënyrën e të ushqyerit. Dietë do të thotë që së pari të ushqehesh në mënyrë të shëndetshme dhe të ekuilibruar, pastaj të shpëtosh nga kilogramët e tepërt. Në një dietë ideale duhet: të jetë një masë e mjaftueshme dhe e ekuilibruar e grupeve të ushqimeve bazë, nuk duhet të përmbajë një ushqim më tepër dhe një më pak, masa e humbjes së peshës



në muaj duhet të jetë 1-2 kg, pesha trupore duhet të zbritet në nivelin e peshës ideale.

Kjo dietë, duke mbrojtur peshën trupore, duhet të parandalojë marrjen e kilogramëve të mëparshëm. Ë njëjta dietë nuk duhet të praktikohet nga miliona njerëz, por duhet të jetë e veçantë për çdo person. Kur përgatitet lista e dietës, duhet të merret parasysh mosha, gjinia, gjatësia trupore, pesha, zakoni i ushqyerjes dhe gjendja social-ekonomike e personit i cili do ta praktikojë atë. Ai duhet të vizitohet te specialisti i endokrines ose te mjeku i sëmundjeve të brendshme dhe duke bërë analizat e duhura, të shihet nëse ka ndonjë sëmundje. Pas kësaj duhet të konsultohet me specialistin e dietës dhe në këtë mënyrë të zgjidhet programi i ushqyerjes sipas strukturës së tij trupore.

Dieta e vërtetë mundësohet duke bërë ndryshime të përhershme në mënyrën e jetesës dhe zakonin e të ushqyerit. Dietat me kohë të shkurtër dhe duke ndenjur të uritur, nuk vlejnë për asgjë.

Kemi parë që listat e disa dietave në shumicën e rasteve përmbajnë 6-7 vakte, por praktikimi i këtyre programeve është më se i vështirë për njerëzit që punojnë dhe garojnë me kohën. Prandaj çfarë mund të bëjnë ata që punojnë?

Së pari duhet të qëndrojnë larg alkoolit, duhanit dhe vendeve ku pihet duhani, larg pijeve që përmbajnë kafeinë, lëngjeve të gatshme të frutave dhe pijeve me acid. Nuk duhet të konsumojnë brumëra, ëmbëlsira, ushqime të shpejta, çipsa, çokollata dhe karamela. Çajin duhet ta pinë të lehtë dhe me pak sheqer. Duhet të pinë shumë ujë dhe të ecin gjatë ditës.

Shkaku i shumë sëmundjeve në ditët e sotme është i lidhur me zakonin e të ushqyerit. Sëmundjet si obeziteti, diabeti, paraliza, yndyra në gjak dhe në organet e brendshme, ngërçi, sëmundjet e damarëve dhe zemrës, hipertensioni, sëmundjet endokrine, problemet seksuale dhe psikologjike

etj., burojnë nga të ushqyerit e tepërt. Tre rregulla të artë për të qenë i shëndetshëm dhe në formë; të mos hash pa qenë i uritur dhe të ngrihesh nga ushqimi pa u tejnopur.

Shpirti, ashtu siç vjen nga fyti, nga fyti ikën. Në një botë ku ekzistojnë njerëz që vdesin nga uria, duhet të ndalemi dhe të mendojmë para se të harxhojmë para për ilaçet e dobësimit, dietat dhe qendrat e dobësimit dhe të rishikojmë shpenzimet e pavetëdijshme që bëjmë për zakonin e të ushqyerit.

Kur na shqetësojnë kilogramët e tepërt dhe kur stomaku na bëhet gur nga mbingopja, duhet me mendjen tone të shkojmë në epokën e lumturisë. T'i hedhim një shikim me kujdes jetës shembullore të Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem. Në kohën kur Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ishte kryetar shteti në Medine-i Munevvere, kalonin javë dhe në shtëpinë e Tij (s.a.s.) nuk ndizej zjarr për gatim. Nga uria ai (a.s.), lidhte gurë në bark dhe sërish interesohej me edukimin e sahabëve suffe. Kur arrinte të gjente një kafshatë bukë, ia jepte atë menjëherë ndonjë nevojtar. Nuk hante pa e marrë uria, ngrihej nga sofa pa u tejnopur. I këshillonte sahabët e nderuar të hanin në masë të mjaftueshme dhe thoshte:

“Njeriu nuk ka mbushur enë më të keqe se stomaku. I mjaftojnë birit të Ademit disa kafshata sa për të drejtuar belin. Nëse njeriu i mbizotëron nefsit, ta ndajë një të tretën e stomakut për ushqim, një të tretën për ujë dhe pjesën tjetër për të marrë frymë.” (Ibn Maxhe, Libas, 31.)

Në shekullin tonë në të cilën obeziteti po përhapet shumë shpejt si një sëmundje epidemike, ky hadith fisnik që përbën bazën e mjekësisë e të shëndetit, na tregon qartazi se kemi nevojë më shumë se asnjë herë tjetër për të mësuar, kuptuar dhe zbatuar jetën shembullore dhe traditën e lartë të Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem.

Rëndësia e gjumit

— Tuba Sokmen —

Një nga elementët më të rëndësishëm të formulës për arritjen e sukseseve, paqes, lumturisë dhe devotshmërisë, është edhe nevoja e domosdoshme e njeriut për gjumë. Një ditë, dy ditë, e deri në njëmbëdhjetë ditë... Në bazë të studimeve të bëra, njeriu që qëndron pa gjumë për njëmbëdhjetë ditë çmendet e më pas vdes. Pra, kaq i rëndësishëm është gjumi për jetën tonë. Por, gjumi nuk është i rëndësishëm vetëm për të jetuar. Ai është një tregues po aq i rëndësishëm në vendosjen dhe ruajtjen e rregullit në jetë. Një njeri mund ta njihni shumë mirë nëse njihni regjimin e tij të gjumit.

Shiko rregullsinë/parregullsinë e gjumit dhe njih njeriun. Në bazë të kësaj, puno me të, bëhu shok, ose besoji një amanet, sepse njeriu që e ka rregulluar këtë nevojë që përbën një pjesë të rëndësishme të jetës, do të thotë se ai ia di vlerën mirësisë së kohës. Do të thotë se ai nuk i neglizhon punët.

Sprova e gjumit ka filluar që në kohën kur Islami ende nuk ishte shpallur hapur. Ashtu si Profeti ynë (a.s.), edhe myslimanët e fshehtë e falnin namazin e natës si namaz farz, duke e gjallëruar natën me tehexhud. Nëse nata e njeriut është e gjallë, edhe dita e tij do të jetë e tillë. Për një kohë të gjatë, myslimanët jetuan duke u përshtatur me diellin. Ata u bënë shokë për kokë me natyrën dhe përputhjen me rregullin e vendosur prej Allahut, nuk e konsideruan si zgjedhjen më të mirë, por si zgjedhjen e vetme.

Pas perëndimit të diellit, ata tërhiqeshin në shtëpitë e tyre dhe pas namazit të jacisë, i linin të gjitha punët e kësaj bote. Ata nuk kanë pasur kurrë nevojë për orë që të ngriheshin në namazin e sabahut, sepse regjimi i rregullt i gjumit, i ngrinte në këmbë përnjëherësh. Për t'u ngritur në namazin e sabahut, duhet të marrësh masat që në darkë. Kjo çështje nuk mund të zgjidhet në mënyrë rrënjësore as duke lexuar libra se si të ngrihesh në namazin e sabahut, e as duke kurdisur dhjetëra orë. Ashtu si adhuret, edhe gjumi duhet të jetë i rregullt në mënyrë të vazhdueshme. Të thuash, më mjaftojnë gjashtë orë gjumë dhe, ato gjashtë orë ndonjëherë i fillon në dymbëdhjetë të natës, ndonjëherë në dhjetë, e ndonjëherë në dy të natës, jo vetëm që nuk do të

mjaftojnë, por do të trullojnë edhe më tepër.

Sot, gjumi ynë nuk është më në bazë të diellit dhe të namazit. Ne kemi ngecur midis dy punëve; edhe të namazeve të ditës, edhe të namazeve të natës, nëse arrijmë të ngrihemi dhe jemi të turbulluar prej dehjes së gjumit. Namazet tona janë rrëzuar qëkur prej fronit. Në vend të tyre tashmë qëndrojnë telenovelat, emisionet e debateve, ndeshjet e futbollit, muhabetet e kafeneve, etj. Ndërmjet reklamave falet namazi dhe kur ikin miqtë pas mesnate flihet gjumë. Ndërsa namazet e mbetura kaza, i hapin derën një zinxhiri tjetër kazashë. Ditën flemë në këmbë dhe përpiqemi të bëjmë punë gjysmë të dehur. Mossuksesin në provime ia atribuojmë intolerancës së mësuesve, ndërsa për mos mbarimin e punëve ia hedhim fajin mizorisë së pronarit apo drejtorit. Në mes të ditës na hapet goja për gjumë dhe përpiqemi të flemë në kohë të papërshtatshme.

Në këtë mënyrë na prishet edhe treguesi i kilometrazhit në rrugën për t'u bërë "njeri". Por ai që nuk ia di vlerën ditës dhe natës, nuk mund të bëhet "njeri". Nuk mund të bëhet as nxënës i mirë, as nënë, e as baba i mirë. Mbi të gjitha, ai nuk ka dobi as për veten e tij. Siç thotë edhe i ndjeri Musa Topbash, "*Kush nuk ka dobi as për veten, është i papranueshëm!*". Në fakt, i ndjeri ka qenë shumë i përpiktë në lidhje me kohën. Kur ishim në shkollë të mesme, mësuesi na tregoi se njëherë kishte shkuar të vizitonte Musa efendiun. Mirëpo kishin shkuar dy minuta me vonesë dhe ishin qortuar edhe për ato dy minuta. Por nuk janë vetëm dy minuta ama!.. Janë dy minuta të stërmëdha. Për shembull, çfarë do të bënit nëse do të mbeteshit dy minuta pa ajër?

Për njeriun që ka synime duhet të mbarojë koha e fjetjes në këmbë. Ne nuk duhet të ngremë krye ndaj Zotit tonë që e bëri natën mbulojë mbi ne, duke e ndriçuar gjithë natën me llamba elektrike. Ta ndriçosh me televizor, kompjuter apo llambë kohën kur duhet fjetur dhe duhet falur namaz, në fakt do të thotë ta errësosh atë shpirtërisht.

Ju uroj të gjithëve gjumë të ëmbël, cilësor dhe të rregullt!..



Pas çdo burri të suksesshëm, fshihet një grua e mirë

— Kybra Çoban —

“O Zot, na e jep riskun hallall dhe nga duart e burrave tanë!”

Për mendimin tim kjo është një lutje që duhet ta bëjë me patjetër çdo zonjë... Sepse në ditët e sotme mendimi: “Gruaja dhe burri janë të barabartë” i ka drejtuar gratë të maten në çdo fushë me burrat ose të bëjnë çdo punë që bëjnë ata.

Jo! Gratë dhe burrat nuk janë të barabartë në shumë anë dhe është normale që të mos jenë të barabartë. Edhe struktura fizike e grave, edhe psikologjia e tyre është e ndryshme nga ajo e burrave. Kjo nuk i bën ato më superiore ose më të dobëta, sepse qoftë grua apo burrë sipas Islamit superioriteti i tyre është te “takva”, pra adhurimi ndaj



Allahut. Kush ka më shumë devotshmëri, ai është më superior.

Edhe rolet që ndërmarrin në jetën e kësaj bote, janë të ndryshme për gruan dhe për burrin. Një burrë, edhe nëse do, në kushte normale nuk mund të lindë apo të ushqejë një bebe... Ky është një diversitet, madje një virtyt që Allahu Teala ia ka dhënë gruas, sepse brezat lindin nga gratë dhe në sajë të tyre rriten dhe formohen. Që njerëzimi të ekzistojë dhe ta vazhdojë ekzistencën e tij në mënyrë të ndershme, ka nevojë për gruan. Roli më sublim që Allahu (xh.xh.), i ka dhënë gruas, është mëmësia. Mëmësia kërkon durim, tolerancë dhe sakrificë.

Nëna, që është krijuar me një strukturë shumë të ndjeshme, e rrit fëmijën duke e mbështjellë me mëshirën e saj... Të mendosh që duart delikate të cilat duhet të ledhatojnë beben, të punojnë në miniera apo të përdorin kazmë, në fakt kjo është pika kyçe e mbrojtjes së mendimit “gruaja dhe burri janë të barabartë”.

Feja jonë i ka dhënë gruas pjesën më të rëndësishme të një detyre të vështirë dhe të shtrenjtë siç është edukimi i njeriut. Nënata ia kushtojnë veten me gjithë shpirt plotësisht të nevojave të brezave që do të vijnë. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selam, si shpërblim ndaj kësaj sakrifice të grave në këtë detyrë sublimë ka thënë:

“Xhenneti është nën këmbët e nënës” (Ahmed bin Hanbel, III, 429; Nesai, Xhihad, 6; Dejlemi, Musned, 2611.)

Po, gratë janë të shtrenjta dhe delikate si lule. Ashtu si lulja që vyshket nga mungesa e përkujdesjes, edhe gratë shkatërrohen nëse, vetëm për të fituar disa para lihen në duart e ashpra të rrugëve. Në këtë mënyrë ato fillojnë të humbin vlerat dhe identitetin e tyre.

Krijuesi ynë, ngaqë na njeh më mirë nga ç’ë njohim ne veten, na ka dhënë detyra të përshtatshme me natyrshmërinë tonë. Burrit i ka dhënë detyrën e fitimit të riskut të familjes, kryerjen e punëve jashtë shtëpisë dhe të qenit kryetar i familjes. Ndërsa gruaja ka për detyrë të pastrojë dhe rregullojë shtëpinë, të kujdeset dhe të edukojë fëmijët. Nëse secili i kryen në mënyrën më të mirë detyrat e tij, formohet një vatrë e lumtur familjare, sepse pas çdo burri të suksesshëm, fshihet një grua e mirë.

Nëse gruaja neglizhon detyrat e saj dhe tenton të bëjë punët e burrit, nuk ngel as një burrë i suksesshëm dhe as pas tij një grua. Madje nuk mund të bëhet fjalë për ekzistencën e një familjeje.

Për fat të keq te gratë e ditëve të sotme ekziston

një ambicie serioze për të punuar duke u mbështetur te logjika “Mos t’ia shoh dorën burrit, por t’i fitoj vetë të ardhurat e mia”... Për shkakun e kësaj ambicieje, nganjëherë familja kalon peripeci shumë të mëdha. Por burri ose gruaja duhet të dije se lumturinë e njeriut nuk e realizon posedimi i shumë gjërave, por të mjaftuarit me atë që kanë. Njeriu më i pasur është poseduesi i mjaftueshmërisë.

Atëherë gratë nuk duhet të marrin pjesë në asnjë mënyrë në tregun e punës? Jo, sigurisht që gruaja gjatë rrugës së vështirë të jetës mund të bëjë punë të përshtatshme me natyrshmërinë e saj, madje edhe punë që janë kusht për t’u bërë. Për shembull mund të punojë në fusha ku ndihet sidomos nevoja e grave si: shëndetësia, edukimi etj... Madje edhe në tregti... Por ka edhe disa gjëra që gratë të cilat punojnë, duhet të bëjnë kujdes në të gjitha këto punë: Së pari nijeti (qëllimi) nuk duhet të jetë vetëm fitimi i parave...

Një njeri me ndërgjegjen e tij, në çdo punë që bën, së pari duhet të mendojë kënaqësinë e Allahut dhe përmasat e shërbimit në fenë hyjnore të Tij (xh.xh.)... Në të njëjtën kohë nuk duhet të neglizhojë shtëpinë dhe fëmijët... Nuk duhet ta lodhë veten më shumë se ç’duhet dhe duhet të bëjë kujdes ndaj kufijve të intimitetit që ka vënë feja. Nëse njeriu dëshiron t’i shërbejë fesë së Allahut brenda kufijve të hallallit, mund të gjejë shumë mundësi pune për veten. Ashtu siç është hyzmet kryerja e punëve të shtëpisë, është edhe puna me ose pa pagesë në institucione të ndryshme bamirësie.

Por nuk i ka hije një femre, nëse ajo punon jashtë shtëpisë për hir të Allahut, të neglizhojë bashkëshortin dhe fëmijët të cilët kanë nevojë për të. Prandaj ajo nuk duhet ta humbë maturinë dhe ekuilibrin.

Ndërkohë që Allahu njofton se është qefil për riskun e njerëzve dhe se askush nuk do të vdesë pa e mbaruar atë, nuk është e drejtë që gratë ose burrat t’i nëpërkëmbin rregullat haram-hallall duke u shqetësuar për riskun e tyre!... Jeta nganjëherë u tregon njerëzve fytyrën e vështirë të saj, prandaj atëherë duhet të dimë të bëjmë durim. Ndërsa nganjëherë moti hapet, dita bëhet me diell dhe punët marrin rrjedhën e tyre. Atëherë duhet të dimë të falënderojmë...

Allahu na bëftë të mundur që jetën ta jetojmë në rrugën e Tij, të pasurohemi duke u mjaftuar me atë që kemi, të lumturohemi duke dhënë për hir të Tij dhe të durojmë dhe falënderojmë në kuptimin e plotë të fjalës.

Amin!

Fëmijët superinteligjentë

— Betyl Balltaxhë —

Kohët e fundit, prindërit u japin fëmijëve të tyre teste të ndryshme për të matur nivelin e tyre të inteligjencës dhe faktorin e suksesit. Gjithash-tu, edhe shumë shkolla private dhe organizata edukative, aplikojnë për ndihmë në vende të specializuara.

Përpara se të flasim në lidhje me metodat e matjes së inteligjencës, le të bëjmë përcaktimin e zgjuarsisë dhe të tregojmë ndryshimin mes inteligjencës dhe mendjes. Sipas psikologjisë, inteligjenca është talenti për të mësuar, për të përfituar nga ato që mëson dhe për të kthyer në praktikë ato që mëson. Ndërkohë mendja është aftësia për të kontrolluar veprimet dhe për të dalluar se çfarë është e mirë e çfarë është e keqe. Nisur nga kjo mund të themi se prej dikujt tjetër mund të marrësh një mendim, por nuk merr dot inteligjencë sepse ajo është një talent i veçantë për çdo individ.

Sipas specialistëve të fushës, inteligjenca zhvillohet me shpejtësi deri në moshën 12 vjeçare, ndërkohë ajo vazhdon të zhvillohet por më ngadalë, deri në moshën 20 vjeçare; ndërsa pas kësaj moshe qëndron konstante. Sipas studimeve të bëra në shtetet perëndimore, nëse truri nuk vihet në funksionim inteligjenca mund të bëj hapa pas. Nga ana tjetër, mendja piqet me kalimin e kohës dhe me ndihmën e eksperiencave të bëra, arrin në nivele më të larta.

IQ (Intelligence Quotient) janë testet e mirënjohura që përdoren për të mësuar nivelin e inteligjencës. Por këto janë vetëm një prej mjeteve të ndryshme për të bërë një gjë të tillë. Për fëmijët e moshës 3-6 vjeç mund të aplikohet testi Stanford-Binet, për fëmijët mbi moshën 6 vjeçare mund të zhvillohet testi WISC-R. Në fund të këtij testi do të merrni një përfundim që komentohet në këtë mënyrë: fëmijët që marrin 85-115 kanë inteligjencë normale, ato që marrin 130-140 janë inteligjentë ndërsa ato që marrin mbi 140 janë gjeni.

Nëse prindërit shikojnë tek fëmijët disa prej shenjave të super- inteligjencës, mos të harrojnë se moshë 3-8 vjeçare është moshë ideale për

të bërë “diagnozën”. Nëse kjo gjë zbulohet vonë ose nuk zbulohet fare, fëmija mund të ketë probleme si: gjendje shpirtërore të rënduar, demotivim në shkollë ose probleme në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë. Duke qenë se mësimet e shkollës janë më poshtë se niveli i tyre i inteligjencës ato mërziten shpejt, lëvizin shumë në klasë, shkojnë me përtesë në shkollë dhe tregojnë mungesë të theksuar interesi. Në rastet kur prindërit dhe mësuesit e keqinterpretojnë këtë situatë, fëmija cilësohet si nxënës i dobët në shkollë. Nëse fëmija nuk ka dëshirë që të shkojë në shkollë dhe nxjerr justifikime si dhimbja e kokës ose e stomakut, nuk dëgjon që t’i bëjë detyrat, humb vëmendjen shumë shpejt dhe harxhon shumë kohë për t’iu përgjigjur një pyetjeje; do të ishte shumë mirë sikur të konsultoheni me një specialist për të kuptuar nëse fëmija juaj është shumë inteligjent.

Fëmija gjeni duhet të edukohet ndryshe prej fëmijëve normal. Për shembull ai mund ta fillojë shkollën para moshës së zakonshme, mund t’i kalojë vitet më shpejt dhe mund të marrë mësimet prej klasave më të larta. Mos të harrojmë se edhe fëmijët gjeni kanë shumë nevojë që të kalojnë kohë me bashkëmoshatarët e vet. Nga ana tjetër, prindërit mund të organizojnë aktivitete shtesë për fëmijët e tyre me super- inteligjencë. Për shembull, në fundjavë mund të vizitohen muzetë, teatri ose biblioteka. Gjith-

ashtu duhet të zgjidhen edhe programe televizive dhe aplikime të veçanta për inteligjencën e tyre.

Shenjat e inteligjencës së lartë tek fëmijët mbi 3 vjeç:

- Ndenja e lartë e vetëbesimit
- Të qenit vëzhgues të mirë
- Të pasurit njohuri në shumë tema
- Zotërimi i aftësisë për të qenë lider
- Të qenit perfeksionist
- Të pasurit një kujtesë të mrekullueshme
- Aftësia për të mësuar shpejt
- Të qenit kureshtar
- Imagjinata e fuqishme
- Dhënia e përgjigjeve logjike
- Aftësia për të marrë përgjegjësi
- Aftësia për të shprehur atë që mendojnë
- Suksesi në shkenca, matematikë dhe në gjuhë

Shenjat e inteligjencës së lartë tek fëmijët mbi 0-3 vjeç:

- Aftësia për ta mbajtur mendjen për një kohë të gjatë
- Krijimi i kontaktit pamor dhe njohja e hershme e prindërve
- Të qenit shumë të lëvizshëm
- Të ecurit para periudhës normale
- Zhvillimi i shpejtë i gjuhës
- Aftësia për të krijuar fjali të sakta që në mos-hën 1,5 vjeçare
- Imagjinatë e gjallë
- Të qenit lider në mesin e bashkëmoshatarëve

Këshilla për mësuesit e fëmijëve super- inteligjentë:

- Tregojini fëmijës me fjalë dhe me vepra që ju e dini veçantinë e tyre.
- Krijoni atij një zonë të lirë dhe kur t'i shpjegoni diçka evitoni shpjegimet e përsëritura dhe të detajuara.
- Krijojani mundësinë për të ndihmuar nxënësit e tjerë të klasës.
- Lejojeni që të ndjek disa mësimet e klasave më të larta.
- Nëse është e nevojshme, flisni me drejtuesit e shkollës për t'i lejuar kapërcimin e klasave.

Këshilla për prindërit e fëmijëve super- inteligjentë:

- Mos e frenoni dëshirën e fëmijëve për të mësuar.
- Aq sa keni mundësi, jepni përgjigje të gjitha pyetjeve të tyre.
- Bëni oferta dhe sugjerime për të folur në tema të ndryshme.
- Zbuloni anët e fuqishme të fëmijës tuaj.
- Flisni haptas në lidhje me anët pozitive dhe negative të një inteligjence të lartë.
- Krijoni mundësi për të kaluar kohë me fëmijë të tjerë që janë po aq inteligjentë.
- Ndihmoheni fëmijën që të ketë edhe fusha të tjera interesi, jashtë shkollës.



Çfarë duhet të konsumojmë për të ulur TENSIONIN?

Një nga këshillat më të vyera që mund të japë një mjek kundër uljes së tensionit është zbatimi i një regjimi më të shëndetshëm ushqimor.

Ky i fundit përbëhet nga fruta dhe perime, drithëra të plota, peshk, shpendë, legume, arrorë dhe produkte bulmeti me pak yndyrë.

BARISHTET

Konsumi i kripës rrit etjen dhe bashkë me të edhe tensionin e gjakut.

Hani më shumë barishte si spinaq, brokoli apo lakra për të marrë më shumë kalium.

Ky mineral largon kripën e tepërt nga organizmi dhe qetëson enët e gjakut.

FRUTAT E PYLLIT

Frutat e pyllit janë të pasura me përbërës natyralë që lehtësojnë punën e enëve të gjakut.

Këto përbërës i zgjerojnë ato dhe qarkullimi i gjakut është më i lehtë.

KOSI

Kosi me pak yndyrë ofron shumë kalçium për organizmin.

Ai qetëson enët e gjakut dhe i qetëson ato kur nevojitet.

PESHKU

Salmoni, sardelet dhe skumbria janë të pasura me acide yndyrore omega-3.

Këto acide përmirësojnë shëndetin e zemrës dhe ulin tensionin e gjakut.

FARAT

Farat e linit, të kungullit apo lulediellit mund të përfshihen në sallata, kos apo tërshërë.

Ato janë shumë të mira për tensionin e gjakut sepse përmbajnë magnez.

TËRSHËRA

Ky drith është i pasur me fibër që mban tensionin e gjakut nën kontroll.

Për më tepër, tërshëra rekomandohet edhe kundër mbipeshës.

PANXHARI

Pirja e dy gotave me lëng panxhari dhe molle e ul tensionin sistolik të gjakut në pak orë.

Panxhari dhe gjethet e tij janë shumë të pasur me kalium, një mineral i dobishëm për zemrën.

Rekomandohet të përfshihet në sallata të ndryshme.

HUDHRA

Përbërësit natyralë të hudhrës zgjerojnë enët e gjakut dhe e ndihmojnë zemrën të kryejë detyrën e saj.

Hudhra është shumë e mirë për uljen e tensionit të gjakut.

FISTIKËT

Këto arrorë janë plot me yndyrna të shëndetshme që i bëjnë mirë zemrës.

Fistikët janë shumë efikasë në uljen e tensionit të gjakut.

SHEGA

Lëngu i shegës është i pasur me fibër dhe shumë minerale që mbajnë nën fre tensionin e gjakut.

Ky frut i bën shumë mirë zemrës por edhe sistemit tretës.

VAJI I ULLIRIT

Ky vaj është plot e për plot me antioksidantë që ruajnë elasticitetin e enëve të gjakut.

Përdorimi i përditshëm i vajit të ullirit është një zgjedhje e mençur në dobi të shëndetit.

LEGUMET

Qiqrat, thjerëzat, fasulet ndihmojnë në uljen e tensionit të gjakut.

Për më tepër, ato janë të pasura me fibër dhe shmangin sëmundjet koronare.

ÇOKOLLATA E ZEZË

Çokollata e zezë përmban antioksidantë që zgjerojnë enët e gjakut.

Në këtë mënyrë ato ulin tensionin e gjakut.

MASA SHITESË KUNDËR TENSIONIT TË GJAKUT

Përpos regjimit të shëndetshëm, njeriu duhet të humbasë në peshë, të kryejë aktivitet fizik dhe të marrë medikamentet që rekomandohen nga mjeku.

Çfarë i ndodh organizmit kur hani GËSHTENJA TË PJEKURA

Gështenjat janë ndër më të mirat e sezonit. Të pjekura apo të ziera, aroma e tyre është e pazezistueshme, posaçërisht në këto ditë vjeshte.

Për të mësuar më shumë mbi vlerat e gështenjave dhe se çfarë i ndodh organizmit tuaj nëse konsumoni gështenja, lexoni më poshtë vlerat e listuara.

Një grusht gështenjash në ditë sjell shumë vlera për shëndetin, pasi ato janë të pasura me vitamina e minerale.

Gështenjat janë burim i pasur i vitaminës C, kalçiumit dhe fosforit. Ato janë idelae kur ndiheni të lodhur dhe të plogësht.

Gështenjat kanë më pak yndyrë në krahasim me arrorët e tjerë me lëvore të fortë. Gjithashtu edhe më shumë niseshte, që i bëjnë të tretshme.

Konsumimi i gështenjave është fantastik për personat që ndihen të lodhur dhe pa vullnet. Po ashtu gështenjat duhet të konsumohen nga ata që dëshirojnë ta forcojnë muskulaturën, nga, personat anemik si edhe nga sportistët.

Gështenja e pjekur ka vlerë më të madhe energjike, sasi më të madhe të proteinave, yndyrave, vitaminave E dhe dy herë më shumë sasi të karbohidrateve.

GËSHTENJAT SHQIPTARE

Gështenjat shqiptare në pjesën më të madhe gjenden në anë të maleve dhe kodrave në Kolgecaj dhe Lekbibaj në Tropojë, Malësitë e Pukës, në Shënmëri në Kukës.


Po ashtu në Mes, Reç dhe Shllak në Shkodër, Kashnjet në Lezhë, Shupal në Tiranë, në Pogradec, në Muzinë në Delvinë, Dhrovjan dhe Leshnicë në Sarandë.

Ndërkohë që edhe zona të tjera si Berati, Skrapari, Përmeti, Gramshi dhe Tepelena e kultivojnë gështenjën, por në sasi më të vogla.

VLERA USHQYESE E GËSHTENJËS

Në 100 gramë gështenja do të gjeni, 67 mg vitaminë B, 27 mg kalçium, 2,38 mg hekur, 175 mg fosfor, 6.4 mg proteina dhe 374 mg kalori.

Gështenjat e pjekura janë popullore sidomos në periudhën vjeshtë -dimër. Në shumicën e rasteve konsumohen të ziera, për edhe të gatuar, si dhe mund t'i shtoni në supa të ndryshme.



STUDIUESIT ZBULOJNË MIKROPLASTIKË NË 100% TË NJERËZVE TË MARRË NË STUDIM

Në studimin e parë të këtij lloji, studiuesit austriakë kanë ndjekur lëvizjen e mikroplastikës në sistemin e qenieve njerëzore. Rezultatet tregojnë se plastika që është një element i gjithëpranishëm në jetën tonë, është tani gjithashtu një element konstant në trupin e njeriut.

Hulumtimi u prezantua në në Vjenë të Austrisë, në takimin më të madh gastroenterologjik në Evropë, UEG Week.

NË GJURMËT E PLASTIKËS

Dy studiues austriakë, Dr. Philipp Schwabl me Universitetin Mjekësor të Vjenës dhe Dr. Bettina Liebmann me Agjencinë e Mjedisit në Austri studuan pjesëmarrës nga vende të ndryshme, përfshirë Finlandën, Italinë, Japoninë, Holandën, Poloninë, Rusinë, Britaninë dhe Austrinë.

Mikroplastikat janë grimca plastike me një madhësi më pak se 5 mm. Ato janë shpesh rruaza të vogla plastike që gjenden në shumë prodhime kozmetike. Disa vende, përfshi Shtetet e Bashkuara, Britaninë dhe Korenë e Jugut, kanë ndaluar produktet me këta përbërës. Por mikroplastika krijohet gjithashtu kur copa të mëdha të plastikës shpërbëhen me kalimin e kohës. Plastika në përgjithësi është kudo. Kombet e Bashkuara vlerësojnë se rreth 8 milion metra tonë plastike përfundon çdo vit në oqeanet e botës. Forumi Ekonomik Botëror vlerësoi se amerikanët hodhën mbi 33 milionë metra tonë plastike në vitin 2014.

Por ky studim i vogël, sugjeron se plastika, qoftë e keqe apo jo për shëndetin tonë, është tashmë e pranishme tek të gjithë ne.

Pjesëmarrësve në studim iu kërkua të mbanin një ditar ushqimor për shtatë ditë para se të merrnin pjesë në studim. Më pas ata dorëzuan mostra të jashtëqitjes tek studiuesit të cilët i analizuan për

përmbajtjen e mikroplastikës.


Çdo mostër testoi positive duke provuar presencën e mikroplastikës. Hulumtuesit identifikuan deri në nëntë lloje të ndryshme plastike.

Si hyn plastika në sistemin tonë? Në rastet e këtij studimi, plastika që u gjet tek njerëzit është e lidhur me ngrënien e ushqimeve të mbështjella me plastike apo pirja e lëngjeve nga shishet plastike. Por shumica e pjesëmarrësve gjithashtu kishin ngrënë peshk në dietën e tyre, kështu që Dr.Schwabl thotë se tani, "nuk mund të arrihet në një përfundim të saktë mbi origjinën e plastikës" në sistemin tonë. Nevojiten më shumë studime në të ardhshmen për ta përcaktuar saktësisht sesi hyn plastika në sistemin tonë.

SI NDIKON PLASTIKA NË SISTEMIN TONË?

A na bën keq prania e gjithë kësaj plastike në trup? Dr. Schwabl thotë se, tani për tani, nuk ka studime përfundimtare që sugjerojnë se plastika përbën rrezik për njerëzit. Por, ai thotë se "studimet e kafshëve kanë treguar se mikroplastika mund të shkaktojë dëmtim të zorrëve, pakësimin e aftësisë së absorbimit të hekurit dhe stresit hepatic".

Shqetësimi është se "çfarë do të thotë kjo për ne, dhe sidomos për pacientët me sëmundje gastrointestinale", thotë Dr. Schwabl. "Ndërsa përqendrimet më të larta të plastikës në studimet me kafshët janë gjetur në zorrë, grimcat më të vogla mikroplastike janë të afta të hyjnë në qarkullimin e gjakut, sistemin limfatik dhe madje mund të arrijnë deri në mëlçi". Studiuesit janë befasuar, që plastika duket të jetë e pranishme tek të gjithë ne dhe pret që sasia e mbledhur në trupin tonë të vazhdojë të rritet, nëse bota nuk ndryshon në mënyrë drastike përdorimin e plastikës.



UNIVERSI ËSHTË NJË HOLOGRAM

Gjatë ekzistencës së tij në këtë planet, fizikanti teorik, kozmologu dhe autori Stephen Hawking, dha shpjegime për disa nga fushat më të mëdha dhe më të mrekullueshme të shkencës, dhe jo vetëm.

Por duket se kontributi i tij vazhdon të na pasurojë edhe pas vdekjes së tij, në sajë të botimit të fundit të një dokumenti të ri në „Journal of High Energy Physics“.

Në veprën e tij të fundit Hawking ka sfiduar teoritë e mëparshme të inflacionit kozmik dhe multiversit, diçka për të cilën ai ka qenë gjithmonë i dyshues.

Mendimi i përgjithshëm i kozmologëve është se, një sekond pas Big Bang-ut, universi u zgjerua jashtëzakonisht shpejt para se të vendoset në gjendjen e tanishme, që përfshin yjet dhe galaktikat. Kjo teori njihet si inflacion, ose inflacion kozmik.

Disa shkencëtarë kanë propozuar që inflacioni në të vërtetë do të vazhdojë përgjithmonë, duke krijuar një “multiverse” në të cilën ka një larmi të universëve të ndryshme, secili me ligjet e veta fizike. Por Hawking nuk ishte fans i madh i „multiuniversit“. Këtë e deklaroi në një intervistë të mbajtur vitin e kaluar.

“Teoria e zakonshme e inflacionit të përgjithshëm parashikon që globalisht universi ynë është si një dimension gjeometrik i pafund, me një mozaik universesh të ndryshme”, tha Hawking vjeshën e kaluar.

“Ligjet e fizikës dhe të kimisë mund të ndryshojnë

nga një univers në tjetrin, të cilat së bashku do të formonin një multiverse, por unë kurrë nuk kam qenë një tifoz i multiversit. Teoria nuk mund të testohet.”


Në teorinë e tij të re, të cilën ai e punoi me kolegun belg Profesor Thomas Hertog, Hawking ka arritur të kapërcejë problemin e kombinimit të objekteve të Relativitetit të Përgjithshëm dhe inflacionit të vazhdueshëm. Del që ky është në thelb një variant i teorisë së holografisë.

Hawking dhe Hertog mendojnë se gjithësia është në të vërtetë e madhe dhe komplekse, ashtu si një hologram – dhe se realiteti 3D është një iluzion, pasi bota dhe dimensionet e kohës janë të projektuar nga informacioni i renditur në një sipërfaqe të sheshtë 2D.

Hertog tha: “Ekziston një ide shumë e saktë matematikore e holografisë që ka dalë nga teoria e vargut në vitet e fundit, e cila nuk është plotësisht e kuptueshme, por është e mrekullueshme”.

Duke u bazuar mbi inflacionin, teoria e sapo publikuar sugjeron se koha dhe ‘fillimi’ i universit u ngritën holografikisht nga një shtet i panjohur jashtë Big Bang-ut.

Ai tha: “Çështja kyçe është se ne nuk jemi duke projektuar një dimension hapësinor. Ne po e projektojmë dimensionin e kohës nga ‘para’ Big Bang-ut.”



Shikimet
njerëzore
nuk mund
ta arrijnë Atë,
ndërkohë që Ai
i arrin shikimet
e të gjithëve.
Ai është Bamirës
i pakufi dhe di
çdo gjë.

(En'am, 103)